

**FAKTORËT QË NDIKOJNË PROCESIN
E VENDIMMARRJES ETIKE:
RASTI I KONTABILISTËVE SHQIPTARË**

Loreta BEBI

Dorëzuar:

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
“Shkenca Ekonomike”, me profil “Financë”,
për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Lindita LATI

Numri i fjalëve: 50.967

Tiranë, shtator, 2015

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj, se ky punim me titull *“Faktorët që ndikojnë procesin e vendimmarrjes etike: Rasti i kontabilistëve shqiptarë”*, për marrjen e gradës “Doktor”, është punimi im origjinal.

Deklaroj gjithashtu, se burimet ku jam mbështetur për të realizuar këtë punim, janë identifikuar dhe paraqitur në mënyrë të hollësishme.

Abstrakti

Gjatë dekadës së fundit asnjëri prej nesh nuk mund të ketë shpëtuar pa dëgjuar rreth skandaleve financiare të WorldCom, Enron, Parmalat apo OneTel. Të gjendur përballë këtyre rasteve tronditëse pa dyshim që secilit prej nesh natyrshëm do t'i lindte pyetja: Pse këto kompani gjigande arritën të falimentonin? Cilat ishin shkaqet? Ashtu sikurse të gjithë ne, edhe studiuesit e etikës së biznesit morën shkas nga këto bume financiare dhe bënë studime të shumta për të eksploruar më në thellësi situatën e krijuar. Pas një sërë studimesh të kryera u arrit në përfundimin se shkak kryesor i falimentimit të këtyre kompanive me famë botërore është mungesa e theksuar e etikës nga kontabilistët e këtyre kompanive. Padyshim, që një klimë e tillë bëri që figura e profesionistëve të kontabilitetit të humbte respektin e publikut dhe besimin e tij.

Duke marrë shkas nga kjo situatë e krijuar, shumë studiues, veçanërisht nga vendet e zhvilluara, ndërmorën një sërë studimesh me qëllim që të kuptonin më në thellësi shkaqet e mungesës së etikës gjatë ushtrimit të profesionit të kontabilistit.

Prej këtyre studimeve u arrit në përfundimin se procesi i vendimmarrjes etike të kontabilistëve ndikohej nga tri grupe faktorësh: individualë, organizativë dhe dimensionet e intensitetit moral të vetë çështjes etike.

Konstatohet se ka një mungesë të thellë të studimeve në lidhje me këtë çështje në vendet në zhvillim, siç është edhe Shqipëria. Analizimi dhe eksplorimi i faktorëve që ndikojnë në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve shqiptarë është shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit.

Bazuar në sa më sipër dhe duke patur parasysh se në vendin tonë nuk është bërë asnjë studim në lidhje me këtë çështje më parë, u ndërmor ky punim shkencor. Qëllimi i studimit është së pari, përcaktimi i ndikimit të disa faktorëve (individualë, organizativë dhe dimensionet e intensitetit moral) në çështjet etike në procesin e vendimmarrjes së kontabilistëve dhe së dyti, përcaktimi i çështjeve etike më të rëndësishme me të cilat hasen më shpesh kontabilistët shqiptarë.

Për të arritur qëllimin e këtij punimi u përdor informacioni i mbledhur nga 230 kontabilistë, të cilët punojnë në kompanitë VIP të vendit tonë. Për të mbledhur informacionin e nevojshëm u ndërtua një pyetësor në të cilin u integruan edhe katër skenarë, të cilët lidheshin me katër çështje etike të ndryshme. Të dhënat e mbledhura u përpunuan në SPSS me ndihmën e teknikave të ndryshme statistikore, si: Independent Samples t-test, ANOVA apo regresioni linear. Përfundimet e punimit dëshmojnë se kontabilistët shqiptarë gjatë ushtrimit të profesionit të tyre ndikoheshin mjaftueshëm nga faktorët organizativë dhe karakteristikat e çështjes etike. Faktorët individualë pothuajse nuk kanë ndikim në procesin e vendimmarrjes etike.

Abstract

During the last decade every one of us has heard about the financial scandals of WorldCom, Enron, Parmalat or OneTel. Facing these shocking cases it is natural that a question arises on every one's mind. Why did these gigantic companies go bankrupt? What were the reasons?

The business ethics scholars the same as all of us were inspired by these financial booms and they made numerous studies to explore this situation in depth. After a series of conducted studies it was concluded that the main cause of the bankruptcy of these world famous companies is a clear lack of ethics in these companies' accountants. It is obvious that such a climate made the figure of the accounting professionals to lose public respect and its confidence.

In order to avoid such situations many scholars especially from developed countries undertook a series of studies. This was in order to understand in depth the causes of the lack of ethics in the exercise of accounting profession.

These studies concluded that the accountants' ethical decision making process was influenced by three sets of factors: the individual, the organizational and the moral intensity dimensions of the ethical issue itself.

It was found that there is a lack of intense studies about this issue in the developing countries and it is the same even for Albania. Analyzing and exploring the factors that influence the ethical decision-making process of Albanian accountants is very important for the economic development of the country.

Taking into consideration what is said above and given the fact that there has not been made any study about this issue in our country we decided to undertake this scientific paper. The purpose of this study is to firstly define the impact of several factors (such as the individual one, the organizational one and the moral intensity dimensions) in the

accountants' ethical decision-making process and secondly to determine the most important ethical issues that Albanian accountants face.

In order to achieve the goal of this paper and to see if the raised hypothesis would be verified or not, we have used information collected from accountants working in VIP companies. We built a questionnaire which integrated four scenarios connected with four different ethical issues in order to collect the necessary information. The collected data was processed in SPSS with the help of various statistical techniques such as Independent Samples t-test, ANOVA or linear regression. The findings of this paper prove that the Albanian accountants are sufficiently influenced by organizational factors and characteristics of ethical issues while exercising their profession. The individual factors have almost no impact on ethical decision-making.

AJSLIT, DIONIT, BRIANIT

FALENDERIME

Përfundimi i studimeve doktorale ishte për mua me të vërtetë një sfidë e vështirë, por jo e pamundur. Shumë gjëra kanë ndodhur dhe kanë ndryshuar në jetën time gjatë kohës që unë kam qenë e angazhuar me këtë projekt. Shpeshherë një hije dyshimi më bënte të mendoja se nuk do mundesha ta përfundoja siç duhej këtë punim. Por, mbështetja dhe kuraja e disa personave të veçantë, të cilët gjej rastin t'i falenderoj, bëri që kjo nismë të përfundonte me sukses.

Së pari, një falenderim i veçantë shkon për udhëheqësen time Prof. Dr. Lindita Lati, e cila me ndihmën e saj të pakursyer më bëri të kuptoj se çdo gjë është e mundur të realizohet, pavarësisht vështirësive që has përgjatë rrugës, mjafton të kesh dëshirë, vullnet dhe mbështetjen e duhur.

Dua gjithashtu të falenderoj Prof. As. Dr. Arbi Agalliu për përkrahjen dhe ndihmën për çdo problem dhe vështirësi që unë kam hasur gjatë kësaj periudhe. Nuk mund të lë pa përmendur edhe pedagogen Dr. Teuta Xhindi, e cila më ka ndihmuar në analizën statistikore të punimit.

Së fundi, dëshiroj t'u shpreh mirënjohjen bashkëshortit Ilirit dhe fëmijëve të mi Ajslit, Dionit dhe Brianit për mbështetjen pa kushte, durimin, sakrificën dhe dashurinë, pa të cilat do të ishte shumë e vështirë të përfundoja temën time.

PERMBAJTJA E LENDES

KAPITULLI I: HYRJE.....	1
1.1. Parathënie.....	1
1.2. Qëllimi dhe objektivat.....	5
1.3. Pyetjet kërkimore.....	6
1.4. Rëndësia e punimit.....	6
1.5. Struktura e punimit.....	8
KAPITULLI II: TRAJTIMET TEORIKE DHE EMPIRIKE TË PROCESIT TË VENDIMMARRJES ETIKE.....	10
2.1. Etika koncept apo praktikë?.....	11
2.2. Etika përballë moralit.....	16
2.3. Teoritë e vendimmarrjes etike.....	18
<i>Modeli Rest</i>	23
2.4. Studimet empirike mbi matjen e fazave të vendimmarrjes etike.....	32
2.5. Konkluzione.....	36
KAPITULLI III: ASPEKTE TË MATJES SË FAKTORËVE QË NDIKOJNË PROCESIN E VENDIMMARRJES ETIKE.....	36
3.1. Faktorët që ndikojnë vendimmarrjen etike.....	37
3.2. Faktorët individualë dhe vendimmarrja etike.....	40
3.4. Dimensionet e intensitetit moral të çështjes etike dhe procesi i vendimmarrjes etike.....	77
3.5. Skeleti teorik i punimit.....	86
3.6. Kufizimet e studimeve të mëparshme.....	87
3.7. Konkluzione.....	90
KAPITULLI IV: ETIKA NË PROFESIONIN KONTABËL DHE PROCESIN E VENDIMMARRJES NË SHQIPËRI.....	91
4.1. Evoluimi i etikës në kontabilitet.....	91
4.2. Etika dhe praktika profesionale.....	96
4.3. Rëndësia e etikës në profesionin kontabël dhe procesin e vendimmarrjes.....	98
4.4. Rregullimi i etikës së kontabilitetit në Shqipëri.....	101
4.5. Roli i kontabilistëve në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.....	104
4.6. Konkluzione.....	108
KAPITULLI V: METODOLOGJIA.....	109

5.1. Qëllimi i punimit dhe pyetjet kërkimore të tij.....	110
5.2. Boshti teorik.....	113
5.3. Teknika e grumbullimit të të dhënave.....	115
<i>Popullata e marrë në studim dhe zgjedhja e kampionit</i>	115
<i>Metoda e mbledhjes së të dhënave</i>	118
<i>Pyetësi dhe përmbajtja e tij</i>	119
<i>Skenarët</i>	131
5.4. Mënyra e shpërndarjes së pyetësit.....	134
5.5. Përpunimi i të dhënave.....	137
5.6. Konkluzione.....	138
KAPITULLI VI: ANALIZA EMPIRIKE E TË DHËNAVE.....	138
6.1. Analiza deskriptive e faktorëve.....	139
6.2. Çështjet etike me të cilat përballen kontabilistët shqiptarë.....	141
6.3. Analiza empirike e të dhënave.....	142
6.4. Konkluzione.....	154
KAPITULLI VII: KONKLuzionET.....	155
7.1. Gjetjet kryesore.....	156
7.2. Konkluzione kryesore.....	158
7.3. Rekomandime.....	170
7.4. Kufizimet.....	180
BIBLIOGRAFIA.....	183
SHTOJCA.....	204

1.5. Struktura e punimit

Ky punim përbëhet nga shtatë kapituj.

- Kapitulli i parë (Hyrje) përmban një sqarim të shkurtër të temës së kërkimit, motivet për zgjedhjen e kësaj teme dhe përcakton në mënyrë të qartë, si qëllimin, ashtu edhe objektivin e saj. Gjithashtu në këtë kapitull evidentohen edhe pyetjet kërkimore të punimit dhe rëndësia e tij.
- Kapitulli i dytë (Trajtimet teorike dhe empirike të procesit të vendimmarrjes) evidenton përpjekjen për të përshkruar sa më qartësisht idetë kryesore të bazuara shkencërisht, që përbëjnë një bazë mbi të cilën do të zhvillohet ky punim. Në këtë kapitull në seksionin e parë bëhet një diskutim rreth etikës në përpjekje për të qartësuar klasifikimin e saj si shkencë apo praktikë. Në seksionin e dytë bëhet një krahasim i etikës me moralin që ka një individ, ku paraqiten të përbashkëtat dhe të veçantat e secilit koncept. Në pjesën e tretë sqarohen fillimisht teoritë më të rëndësishme të procesit të vendimmarrjes etike dhe më pas në seksionin e katërt vazhdohet me evidencat empirike në lidhje me procesin dhe fazat nëpër të cilat ai kalon. Në fund jepen edhe konkluzionet e kapitullit.
- Në kapitullin e tretë (Aspekte të matjes së faktorëve që ndikojnë procesin e vendimmarrjes etike) bëhet një shtjellim i hollësishëm teorik dhe empirik i secilit prej faktorëve të marrë në konsideratë. Në seksionin e parë të këtij kapitulli bëhet një analizë e të gjithë faktorëve, të cilët ndikojnë në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve duke paraqitur fillimisht teoritë, ku mbështeten ato për të vazhduar më pas në seksionin e dytë me rezultatet e arritura nga kërkimet e mëparshme empirike. Në seksionin e tretë paraqiten kufizimet e studimeve të mëparshme mbi procesin e vendimmarrjes etike dhe faktorëve që e ndikojnë atë. Në seksionin e katërt të kapitullit jepet skeleti teorik mbi të cilin do të ndërtohet ky punim.
- Kapitulli i katërt (Etika në profesionin kontabël dhe procesin e vendimmarrjes në Shqipëri) fillon me një diskutim në seksionin e parë në lidhje me evoluimin e etikës në kontabilitet për të kaluar më pas në seksionin e dytë me një diskutim në lidhje me etikën dhe praktikën profesionale. Gjithashtu në vijim të kapitullit, në seksionin e tretë të tij

paraqitet një material në lidhje me rëndësinë e etikës në profesionin kontabël dhe procesin e vendimmarrjes. Në seksionin e katërt paraqiten kushtet e hyrjes në profesion dhe kualifikimi i vijueshëm profesional. Në seksionin e pestë diskutohet roli që luajnë kontabilistët në zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe në fund jepen konkluzionet e kapitullit.

- Kapitulli i pestë (Metodologjia) Fillimisht në seksionin e parë paraqitet edhe një herë qëllimi dhe objektivat e tij dhe shtrohen hipotezat e punimit. Në seksionin e dytë analizohet boshti teorik i punimit dhe më pas në seksionin e tretë vazhdohet me teknikën e grumbullimit të të dhënave. Gjithashtu në këtë kapitull diskutohen edhe kufizimet e të dhënave dhe mënyra e përpunimit të tyre e më pas vazhdohet me konkluzionet e kapitullit.
- Kapitulli i gjashtë (Analiza empirike e evidencave) fillon me analizën përshkruese të të dhënave në seksionin e parë, ku paraqiten hollësisht të gjitha karakteristikat demografike të kampionit të marrë në studim për të vazhduar më pas me seksionin e dytë, ku diskutohen çështjet etike më të rëndësishme me të cilat hasen më shpesh kontabilistët tanë. Në seksionin e katërt paraqitet analiza ekonometrike e procesit të vendimmarrjes dhe faktorëve që e ndikojnë atë. Në këtë seksion diskutohen dhe analizohen rezultatet e marra në lidhje me ndikimin e secilit faktor të marrë në konsideratë dhe ndikimit të tyre në procesin e vendimmarrjes etike.
- Kapitulli i shtatë (Konkluzione) paraqet gjetjet kryesore në seksionin e parë dhe konkluzionet kryesore në seksionin e dytë. Në seksionin e fundit paraqiten kufizimet e punimit dhe rekomandimet për kërkimet e ardhshme.

LISTA E TABELAVE DHE E FIGURAVE

TABELA 3.1. PËRMBLEDHJE E MARRËDHËNIES SË GJINISË ME PROCESIN E VENDIMMARRJES ETIKE.....	44
TABELA 3.2 PËRMBLEDHJE E MARRËDHËNIES SË MOSHËS ME PROCESIN E VENDIMMARRJES ETIKE.....	47
TABELA 3.3. PËRMBLEDHJE E MARRËDHËNIES SË NIVELIT TË EDUKIMIT ME PROCESIN E VENDIMMARRJES ETIKE.....	50
TABELA 3.4. PËRMBLEDHJE E MARRËDHËNIES SË KODIT TË ETIKËS ME PROCESIN E VENDIMMARRJES ETIKE.....	68
FIGURA 3.1 SKELETI TEORIK I PUNIMIT.....	87
FIGURA 5.1. DALLIMET MIDIS QASJES POZITIVSTE DHE QASJES POSTPOZITIVISTE.....	114
FIGURA 5.2 HAPAT E NDËRTIMIT TË PYETËSORIT.....	121
TABELA 5.1. TË DHËNA MBI KAMPIONIN E MARRË NË STUDIM.....	135
FIGURA 6.1. GRAFIKU I RENDITJES SË ÇËSHTJEVE ETIKE SIPAS RËNDËSISË SË TY.....	209
FIGURA 6.2 GRAFIKU I RENDITJES SË ÇËSHTJEVE ETIKE SIPAS SHPESHTËSISË SË HASJES SË TYRE.....	210
TABELA 6.12. REZULTATET E TESTEVE MBI NORMALITETIN PËR FAKTORIN GJINI.....	210
TABELA 6.13 REZULTATET E TESTEVE MBI NORMALITETIN PËR FAKTORIN GJINI.....	211
TABELA 6.14 REZULTATET E TESTEVE MBI NORMALITETIN PER FAKTORIN GJINI.....	211
TABELA 6.15. REZULTATET E TESTEVE MBI NORMALITETIN PER FAKTORIN GJINI.....	211
TABELA 6.16. TË DHËNA MBI GJININË E PJESËMARRËSVE NË STUDIM.....	212
TABELA 6.17. REZULTATET E INDEPENDENT SAMPLES TEST PËR GJININË.....	212
FIGURA 6.3. GRAFIKU I VARËSISË SË VENDIMMARRJES ETIKE NGA MOSHA E PJESËMARRËSVE.....	213
TABELA 6.18. TË DHËNA MBI MOSHËN E PJESËMARRËSVE NË STUDIM.....	213
TABELA 6.19. REZULTATET E TESTEVE MBI HOMOGENITETIN E VARIANCË NË LIDHJE ME MOSHËN.....	213
TABELA 6.20. REZULTATET E ANOVA NË LIDHJE ME MOSHËN.....	214
TABELA 6.21 KRAHASIMET E SHUMËFISHTA MIDIS KATEGORIVE TË MOSHËS SË PJESËMARRËSVE.....	214
TABELA 6.22 TË DHËNA MBI NIVELIN E EDUKIMIT TË PJESËMARRËSVE NË STUDIM.....	214
TABELA 6.23 REZULTATET MBI TESTIN E HOMOGENITETIT TË VARIANCË PËR FAKTORIN NIVEL EDUKIMI.....	215
TABELA 6.24 REZULTATET E ANOVA PËR NIVELIN E EDUKIMIT.....	215
TABELA 6.25. KRAHASIMET E SHUMËFISHTA PËR KATEGORITË E NIVELIT TË EDUKIMIT.....	215
FIGURA 6.4. GRAFIKU I VARËSISË SË VENDIMMARRJES ETIKE NGA NIVELI I EDUKIMIT.....	217
TABELA 6.26. TË DHËNA MBI EKSPERIENCËN E PJESËMARRËSVE NË STUDIM.....	217
TABELA 6.27. REZULTATET E TESTIT TË HOMOGENITETIT TË VARIANCË PËR EKSPERIENCËN.....	218
TABELA 6.28. REZULTATET E ANOVA PËR EKSPERIENCËN.....	218
TABELA 6.29. KRAHASIMET E SHUMËFISHTA MIDIS KATEGORIVE TË EKSPERIENCËS.....	218
FIGURA 6.5. GRAFIKU I VARËSISË SË VENDIMMARRJES ETIKE NGA EKSPERIENCA.....	219

TABELA 6.30. TË DHËNA MBI FILOZOFINË PERSONALE TË MORALIT TË PJESËMARRËSVE NË STUDIM.....	219
TABELA 6.31. REZULTATET E INDEPENDENT SAMPLES TEST PËR FILOZOFINË PERSONALE TË MORALIT.....	219
TABELA 6.32. TË DHËNA MBI LLOJIN E INDUSTRISE NË TË CILËN OPERON KOMPANIA KU JANË TË PUNËSUAR PJESËMARRËSIT NË STUDIM.....	220
TABELA 6.33. REZULTATET E TESTIT TË HOMOGENITETIT TË VARIANCE MBI LLOJIN E INDUSTRISE.....	220
TABELA 6.34. REZULTATET E ANOVA PËR LLOJIN E INDUSTRISE.....	221
TABELA 6.35. KRAHASIMET E SHUMËFISHTA MIDIS LLOJEVE TË INDUSTRISE KU JANË TË PUNËSUAR PJESËMARRËSIT NË STUDIM.....	221
TABELA 6.37. REZULTATET E TESTIT TË HOMOGENITETIT TË VARIANCE TË MADHËSISË SË KOMPANISË.....	224
TABELA 6.38. REZULTATET E ANOVA PËR MADHËSINË E KOMPANISË.....	224
FIGURA 6.7. GRAFIKU I VARËSISË SË VENDIMARRJES ETIKE NGA MADHËSIA E KOMPANISË.....	225
TABELA 6.39. TË DHËNA MBI EKZISTENCËN E KODIT TË ETIKËS NË KOMPANITË KU PUNOJNË PJESËMARRËSIT NË STUDIM.....	225
TABELA 6.40. REZULTATET E INDEPENDENT SAMPLES TEST PËR EKZISTENCËN E KODIT TË ETIKËS.....	225
TABELA 6.41. TË DHËNA MBI LLOJIN E KLIMËS ETIKE TË KOMPANIVE KU PUNOJNË PJESËMARRËSIT NË STUDIM.....	226
TABELA 6.42. REZULTATET E TESTIT TË HOMOGENITETIT TË VARIANCE PËR KLIMËN ETIKE.....	226
TABELA 6.43. REZULTATET E ANOVA PËR KLIMËN ETIKE.....	227
TABELA 6.44. TË DHËNA MBI DIMENSIONET E INTENSITETIT MORAL TË MARRA NË STUDIM.....	228
TABELA 6.45. REZULTATET MBI KORRELACIONIN E DIMENSIONEVE TË INTENSITETIT MORAL ME VENDIMARRJEN ETIKE.....	228
TABELA 6.46. TË DHËNA MBI ANALIZËN REGRESIVE TË DIMENSIONEVE TË INTENSITETIT MORAL.....	228
TABELA 6.47. REZULTATET E ANOVA PËR DIMENSIONET E INTENSITETIT MORAL.....	229
TABELA 6.48. REZULTATET MBI KOEFICIENTIN E KORRELACIONIT TË DIMENSIONEVE TË INTENSITETIT MORAL.....	229
TABELA 6.49. RESIDUAL STATISTICS.....	229
FIGURA 6.9. HISTOGRAMA E MBETJEVE.....	230
FIGURA 6.10. NORMAL P-P PLOT.....	231
FIGURA 6.11. SCATTERPLOT.....	232

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

PVE-Proçesi i Vendimmarrjes Etike

PPE-Pyetëtori i Pozicionit të Etikës

PKE-Pyetëtori i Klimës Etike

TZHMNJ-Teoria e Zhvillimit të Moralit Njohës

TVA-Teoria e Veprimit të Arsytuar

TSP- Teoria e Sjelljes së Planifikuar

IEKA- Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

IKM-Instituti i Kontabilistëve të Miratuar

SHKFSH- Shoqata e Kontabilistëve dhe e Financierëve të Shqipërisë

IFAC - Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve

SNA- Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit

KAPITULLI I: HYRJE

1.1. Parathënie

Kompleksiteti në rritje i problemeve bashkëkohore të shkencës financiare kërkon jo vetëm thellimin teorik në natyrën dhe kuptimin e këtyre problemeve, por më shumë zhvillimin e metodologjive të veçanta për trajtimin e tyre në një kontekst realist, racional dhe shkencor.

Në realitetin ekonomik të shekullit në të cilin po jetojmë sjellja individuale e çdo punonjësi duke nisur nga manaxherët e deri te punonjësit e thjeshtë është themeli mbi të cilin mbështetet reputacioni i një njësie biznesi. Sjellja e çdo punonjësi ka një ndikim thelbësor dhe të drejtpërdrejtë në vlerën e tregut, aftësinë për të tërhequr dhe mbajtur klientët, investitorët, punonjësit ose konsumatorët.

Profesioni kontabël është i rëndësishëm në jetën e një vendi, ai jep kontribut në zhvillimin ekonomik dhe në stabilitetin financiar, në funksionimin eficient të tregjeve të kapitalit dhe të sektorit publik. Profesioni i kontabilistit nxit dhe mbështet rritjen dhe zhvillimin e biznesit në përgjithësi dhe sidomos të biznesit të vogël e të mesëm, duke iu dhënë atyre ndihmë në drejtimin strategjik e financiar dhe ka si objektiv mbrojtjen e interesave të aksionerëve dhe të publikut që investon kapitalin në to. Kontabilistët përfaqësojnë personat në duart e të cilëve është suksesi i një njësie biznesi, performanca e lartë dhe vijueshmëria e biznesit. Sa më e mirë performanca e një njësie biznesi aq më e madhe rritja ekonomike e vendit në

të cilin kjo kompani operon. Pra, në mënyrë të tërthortë kontabilistët janë individët, të cilët kanë pushtetin e nevojshëm për të ndikuar në rritjen ekonomike të një vendi.

Sipas Zengin, Erdener & Var (2009) në botën e sotme të biznesit kontabilistët luajnë një rol të rëndësishëm. Informacioni që ata përgatisin është vendimtar dhe shumë i rëndësishëm duke qenë se ndihmon menaxherët, investitorët dhe palët e tjera të interesit në marrjen e vendimeve ekonomike kritike. Në të njëjtën kohë duhet theksuar se çdo parregullsi në sjellje nga pikëpamja etike e kontabilistëve mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme për shoqërinë (Williams & Elson, 2010). Një shembull për të gjitha këto janë rastet e skandaleve financiare të disa kompanive të fuqishme si Enron, WorldCom, Parmalat etj. Këto skandale vënë në dyshim moralin e biznesmenëve në përgjithësi dhe të kontabilistëve në veçanti. Është rënë dakord se kontabilistët kanë qenë kontribuesit kryesorë në rënien e standardeve etike të një biznesi.

Disa studime të bëra në fushën e kontabilitetit mbështesin faktin se një kontabilist i suksesshëm përveç aftësive të përgjithshme të biznesit, aftësive njerëzore dhe atyre teknike duhet domosdoshmërisht t'u përmbahet rigorozisht standardeve etike të ushtrimit të profesionit (Taicu, 2007; Amat, Blake & Dowds, 1991). Kontabilistët shpeshherë janë të detyruar të bëjnë zgjedhje etike në lidhje me situata të ndryshme, disa prej të cilave janë transparente dhe të qarta për to dhe një pjesë tjetër janë më pak të qarta (Shaub, 2005).

Organizata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) në raportin hulumtues të saj të titulluar "Rindërtimi i besimit të publikut në raportimin financiar-Një këndvështrim ndërkombëtar", i botuar në vitin 2003, duke marrë shkas nga pasojat e kolapseve të Enronit dhe

WorldCom në vitin 2002, konkludon se skandalet finanicare të asaj kohe ishin simptoma të problemeve më të thella dhe theksojnë se përmirësimi i standardeve etike, përshtatshmëria e mekanizmave të raportimit financiar, cilësia e auditimit dhe forcimi i kontrollit qeveritar janë faktorët kyç që luajnë rol në përmirësimin e besimit të publikut.

Si rezultat i këtyre skandaleve, rëndësia e etikës së biznesit është rritur dhe si pasojë është arritur në përfundimin që profesionistët e biznesit nuk zotërojnë vlerat e duhura etike (Waddock, 2005). Sipas Jones (1991) shumë nga këto skandale mund të ishin parandaluar nëse profesionistët do të merrnin vendime etike. Për të përmirësuar sjelljen etike është jetësore që të kuptohen mirë komponentët që përfshihen në procesin e vendimarrjes etike dhe ndikimi që ka secili prej tyre në të dhe sipas Jackling, Cooper, Leung, & Dellaportas, (2007) edukimi në etikën e kontabilitetit ndihmon për të kuruar kolapsin etik të profesionit.

Pa dyshim që etika është një element shumë i rëndësishëm dhe vital veçanërisht në profesionin e kontabilistit. Shumica e studimeve në lidhje me këtë çështje arrijnë në një përfundim konsistent se etika është një domosdoshmëri e rëndësishme në profesionin e kontabilistit. Por, vetëm të mësuarit e etikës nuk garanton sukses në shfaqjen e sjelljes etike. Nga ana tjetër, është provuar se të mësuarit e etikës është i domosdoshëm për të marrë vendime etike, por jo i mjaftueshëm (Hajjawi, 2008; Armstrong, Ketz, & Owsen, 2003; Zengin et al., 2009).

Sigurimi i një informacioni financiar cilësor dhe të besueshëm në procesin e marrjes së vendimeve është i një rëndësie vendimtare në zhvillimin ekonomik, social dhe financiar të një vendi. Kontabilistët dhe audituesit në pozicionin e tyre si hartues dhe vërtetues të këtij

informacioni financiar ndodhen midis interesave të prodhuesve të informacionit financiar dhe të përdoruesve të tyre, investitorët, bankat, kreditorët, etj. Pra në këtë pozicion kontabilistët dhe audituesit kanë një rol publik shumë të rëndësishëm.

Modelet e procesit të vendimmarrjes etike paraqesin disa faktorë që kanë ndikim në vendimmarrjen etike dhe krijojnë një themel për mënyrën e marrjes së vendimeve etike brenda kompanisë Rest (1986). Ai ndërtoi një model, i cili konsiston në katër faza nëpër të cilat kalon një individ kur merr një vendim etik. Procesi fillon me identifikimin e dilemës etike nga individi, bërjen e gjykimit etik, qëllimin për të vepruar ose jo në mënyrë etike dhe në fund kryerjen e veprimit etik.

Secila prej këtyre fazave ndikohet nga faktorë të ndryshëm siç janë, faktorët individualë, ku bëjnë pjesë gjinia, mosha, niveli i edukimit, përvoja në punë, vlerat personale, faktorët organizativë ku bëjnë pjesë klima etike, kodi i etikës, madhësia e organizatës, lloji i industrisë dhe presioni i manaxhimit të lartë dhe dimensionet e intensitetit moral të çështjes etike ku bëjnë pjesë madhësia e pasojave, konsensusi social, përqëndrimi i efektit dhe shpejtësia e shfaqjes së pasojave. Këta faktorë janë studiuar në fusha të ndryshme, si: marketingu, sistemet e informacionit, manaxhimi dhe kontabiliteti.

Ndër kërkimet e bëra në fushën e kontabilitetit mund të përmendim Buchan (2005); Doty, Tomkiewicz, & Bass (2005) ; Radtke (2004); Schneider (2004); Shafer, (2007). Këto studime kanë arritur në rezultate të ndryshme. Disa prej tyre sugjerojnë se femrat ushtrojnë sjellje etike më të lartë se meshkujt ndërkohë që të tjerët nuk kanë gjetur

ndryshime midis dy gjinive. Vetëm një studim i kryer nga Marques & Azevedo-Pereira (2008) ka arritur në përfundimin se meshkujt janë pak më shumë etike se femrat.

Megjithëse ka një numër të konsiderueshëm studimesh të bëra në fushën e kontabilitetit, një pjesë shumë e vogël e tyre janë bërë në vendet me ekonomi në zhvillim.

Ky punim do të sjellë të dhëna empirike në lidhje me ndikimin e faktorëve të ndryshëm në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve të një vendi në zhvillim siç është Shqipëria.

1.2. Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të përcaktojë se cilat janë çështjet etike me të cilat hasen me shpesh kontabilistët në vendin tonë dhe të përcaktojë faktorët që ndikojnë procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve duke qenë se ato ndërmarrin pjesën më të rëndësishme të vendimeve brenda kompanisë. Për të përmbushur këtë qëllim do të ndiqen objektivat e mëposhtme:

- Identifikimi i çështjeve etike më të rëndësishme me të cilat përballen kontabilistët në Shqipëri.
- Përcaktimi i lidhjes midis faktorëve individualë dhe procesit të vendimmarrjes së kontabilistëve në Shqipëri.
- Përcaktimi i lidhjes midis faktorëve organizativë dhe procesit të vendimmarrjes së kontabilistëve në Shqipëri.
- Përcaktimi i lidhjes midis dimensioneve të intensitetit moral të çështjes etike dhe procesit të vendimmarrjes së kontabilistëve në Shqipëri.

1.3. Pyetjet kërkimore

Duke qenë se procesi i vendimmarrjes etike sipas modelit të Rest (1986) është një proces që kalon në katër etapa, të cilat janë: **a) njohja etike, b) gjykimi etik, c) qëllimi etik, d) sjellja etike.** Duke qenë se në qendër të studimit do të jenë vetëm tri fazat e para të tij duke përjashtuar fazën e fundit që përkon me sjelljen etike pyetjet kërkimore të punimit lidhen pikërisht me ndikimin e secilit grup faktorësh në procesin e vendimmarrjes etike.

Pyetjet kërkimore që do të shoqërojnë punimin janë si më poshtë:

- 1) Cilat janë çështjet etike me të cilat hasen kontabilistët në Shqipëri?
- 2) Çfarë ndikimi kanë faktorët individualë në procesin e vendimmarrjes etike?
- 3) Çfarë ndikimi kanë faktorët organizativë në procesin e vendimmarrjes etike?
- 4) Çfarë ndikimi kanë dimensionet e intensitetit moral të çështjes etike në procesin e vendimmarrjes etike?

Duke u mbështetur në këto pyetje kërkimore do të ngrihen edhe hipotezat e punimit.

1.4. Rëndësia e punimit

Ashtu sikurse u diskutua edhe më parë etika në kontabilitet kohët e fundit ka përfaqësuar një ndër çështjet më të nxehta dhe më të debatuar. Në lidhje me këtë çështje janë ndërmarrë kërkime të shumta gjatë dy dekadave të fundit. Shumica e këtyre kërkimeve janë bërë në vende të zhvilluara dhe veçanërisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në vendet në zhvillim ku bën pjesë edhe vendi ynë etika në kontabilitet nuk ka përfaqësuar dhe nuk

përfaqëson ende një ndër çështjet më të studiuara pavarësisht faktit se për të tilla vende rëndësia e saj është shumë e madhe.

Studime të ngjashme me studimin që kam vendosur të bëj, të cilat janë bërë në vende të tjera në zhvillim, kanë qenë të rëndësishme për të kuptuar më në thellësi procesin e vendimmarrjes dhe faktorët që e ndikojnë këtë proces.

Duke qenë se si rezultat i kërkimeve të mia të deritanishme në faqe të ndryshme në internet, në arkivën e Bibliotekës së Shqipërisë dhe në revista të ndryshme në fushën e biznesit të botuara brenda dhe jashtë vendit nuk kam hasur asnjë punim të mëparshëm të këtij lloji të bërë në vendin tonë, ky punim do të japë një kontribut të rëndësishëm në fushën e kontabilitetit dhe veçanërisht në etikën e kontabilitetit, e cila aktualisht përbën një disiplinë pak të njohur dhe së cilës nuk i është kushtuar vëmendja e duhur. Në përfundim të këtij punimi do të arrihet në konkluzione më të rëndësishme në lidhje me faktorët që ndikojnë kontabilistët në procesin e vendimmarrjes etike dhe njëkohësisht do të përcaktohen çështjet etike më të rëndësishme, me të cilat hasen çdo ditë kontabilistët shqiptarë. Duke u bazuar në rezultatet e arritura mund të merren disa masa për të ndikuar te faktorët që e ndikojnë procesin e vendimmarrjes etike me qëllim që vendimmarrja etike e kontabilistëve të përmirësohet. Krijimi i kushteve për të marrë vendime etike në lidhje me çështje të ndryshme krijon mundësi që bizneset të arrijnë një performancë të kënaqshme, e cila përkthehet sukses dhe vijimësi për një njësi biznesi.

Nga ana tjetër, ky punim përveç rëndësisë që ka përsa i përket çështjes, e cila do të analizohet është shumë i vlefshëm, sepse ai përbën studimin e parë në lidhje me këtë

problematikë shumë të rëndësishme për vendin tonë. Pra, ai do të shërbejë për të inkurajuar studime të mëtejshme në lidhje me etikën në kontabilitet, të cilat duke u mbështetur në këtë studim, që padyshim do të ketë anët e tij pozitive dhe negative, do të jenë shumë të vlefshme për biznesin në veçanti dhe për shoqërinë në të cilën jetojmë në përgjithësi.

1.5. Struktura e punimit

Ky punim përbëhet nga shtatë kapituj.

- Kapitulli i parë (Hyrje) përmban një sqarim të shkurtër të temës së kërkimit, motivet për zgjedhjen e kësaj teme dhe përcakton në mënyrë të qartë, si qëllimin, ashtu edhe objektivin e saj. Gjithashtu në këtë kapitull evidentohen edhe pyetjet kërkimore të punimit dhe rëndësia e tij.

- Kapitulli i dytë (Trajtimet teorike dhe empirike të procesit të vendimmarrjes) evidenton përpjekjen për të përshkruar sa më qartësisht idetë kryesore të bazuara shkencërisht, që përbëjnë një bazë mbi të cilën do të zhvillohet ky punim. Në këtë kapitull në seksionin e parë bëhet një diskutim rreth etikës në përpjekje për të qartësuar klasifikimin e saj si shkencë apo praktikë. Në seksionin e dytë bëhet një krahasim i etikës me moralin që ka një individ, ku paraqiten të përbashkëtat dhe të veçantat e secilit koncept. Në pjesën e tretë sqarohen fillimisht teoritë më të rëndësishme të procesit të vendimmarrjes etike dhe më pas në seksionin e katërt vazhdohet me evidencat empirike në lidhje me procesin dhe fazat nëpër të cilat ai kalon. Në fund jepen edhe konkluzionet e kapitullit.

- Në kapitullin e tretë (Aspekte të matjes së faktorëve që ndikojnë procesin e vendimmarrjes etike) bëhet një shtjellim i hollësishëm teorik dhe empirik i secilit prej faktorëve të marrë në konsideratë. Në seksionin e parë të këtij kapitulli bëhet një analizë

e të gjithë faktorëve, të cilët ndikojnë në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve duke paraqitur fillimisht teoritë, ku mbështeten ato për të vazhduar më pas në seksionin e dytë me rezultatet e arritura nga kërkimet e mëparshme empirike. Në seksionin e tretë paraqiten kufizimet e studimeve të mëparshme mbi procesin e vendimmarrjes etike dhe faktorëve që e ndikojnë atë. Në seksionin e katërt të kapitullit jepet skeleti teorik mbi të cilin do të ndërtohet ky punim.

- Kapitulli i katërt (**Etika në profesionin kontabël dhe procesin e vendimmarrjes në Shqipëri**) fillon me një diskutim në seksionin e parë në lidhje me evoluimin e etikës në kontabilitet për të kaluar më pas në seksionin e dytë me një diskutim në lidhje me etikën dhe praktikën profesionale. Gjithashtu në vijim të kapitullit, në seksionin e tretë të tij paraqitet një material në lidhje me rëndësinë e etikës në profesionin kontabël dhe procesin e vendimmarrjes. Në seksionin e katërt paraqiten kushtet e hyrjes në profesion dhe kualifikimi i vijueshëm profesional. Në seksionin e pestë diskutohet roli që luajnë kontabilistët në zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe në fund jepen konkluzionet e kapitullit.

- Kapitulli i pestë (**Metodologjia**) Fillimisht në seksionin e parë paraqitet edhe një herë qëllimi dhe objektivat e tij dhe shtrohen hipotezat e punimit. Në seksionin e dytë analizohet boshti teorik i punimit dhe më pas në seksionin e tretë vazhdohet me teknikën e grumbullimit të të dhënave. Gjithashtu në këtë kapitull diskutohen edhe kufizimet e të dhënave dhe mënyra e përpunimit të tyre e më pas vazhdohet me konkluzionet e kapitullit.

- Kapitulli i gjashtë (**Analiza empirike e evidencave**) fillon me analizën përshkuese të të dhënave në seksionin e parë, ku paraqiten hollësisht të gjitha karakteristikat demografike të kampionit të marrë në studim për të vazhduar më pas me seksionin e dytë,

ku diskutohen çështjet etike më të rëndësishme me të cilat hasen më shpesh kontabilistët tanë. Në seksionin e katërt paraqitet analiza ekonometrike e procesit të vendimmarrjes dhe faktorëve që e ndikojnë atë. Në këtë seksion diskutohen dhe analizohen rezultatet e marra në lidhje me ndikimin e secilit faktor të marrë në konsideratë dhe ndikimit të tyre në procesin e vendimmarrjes etike.

- Kapitulli i shtatë (Konkluzione) paraqet gjetjet kryesore në seksionin e parë dhe konkluzionet kryesore në seksionin e dytë. Në seksionin e fundit paraqiten kufizimet e punimit dhe rekomandimet për kërkimet e ardhshme.

KAPITULLI II: TRAJTIMET TEORIKE DHE EMPIRIKE TË PROCESIT TË VENDIMMARRJES ETIKE

Ky kapitull ka për qëllim që të paraqesë hollësisht sfondin teorik dhe empirik që lidhet me procesin e vendimmarrjes etike. Ai është menduar të ndahet në pesë seksione. Në seksionin e parë paraqitet një diskutim në lidhje me etikën me qëllim që të jepet një shpjegim i qartë i këtij nocioni për të vazhduar më pas me teoritë e vendimmarrjes etike. Në seksionin e dytë analizohen hollësisht koncepti i etikës dhe koncepti i moralit duke paraqitur të veçantat dhe të përbashkëtat e tyre. Në seksionin e tretë analizohen teoritë më të rëndësishme të procesit të vendimmarrjes etike. Në këtë seksion një vëmendje e veçantë i kushtohet shqyrtimit të modelit të Rest (1986) mbi procesin e vendimmarrjes etike. Në seksionin e katërt paraqiten studimet empirike në lidhje me matjen e fazave të procesit të vendimmarrjes etike. Në seksionin e pestë jepen konkluzionet e kapitullit.

2.1 Etika koncept apo praktikë?

Etika është një term. Shumë prej nesh mendojnë se etika ka të bëjë me një set rregullash sociale apo një dekret fetar. Në filozofinë profesionale ky nocion nuk pranohet si një përkufizim për etikën. Etika filozofike ka të bëjë me studimin e së mirës përballë së keqes. Zakonisht etika filozofike merret me zbulimin e një sistemi, i cili mund të përdoret për të dalluar kush apo çfarë është e mirë, ose me vlerësimin e një sistemi të propozuar nga të tjerët.

Me prejardhje nga fjala greke “*ethos*”, e cila do të thotë mënyrë të jetuari, etika është një degë e filozofisë, e cila merret me sjelljen njerëzore dhe veçanërisht me sjelljen e individëve në shoqëri. Në një kuptim më të gjerë etika reflekton mbi qeniet njerëzore dhe ndërveprimin e tyre me natyrën dhe qeniet e tjera, mbi lirinë, përgjegjësinë dhe drejtësinë. Mund të themi që në përgjithësi etika merret me pavarësinë njerëzore kur ajo fokusohet në marrëdhënien që ekziston midis njeriut dhe botës. Kjo pavarësi është kushti primar për vendimmarrjen etike dhe gjithashtu në çdo analizë objektive të fakteve. Individët demonstrojnë pavarësi kur, në një proces vendimmarrjeje, ata zgjedhin të çlirojnë veten sa më shumë të jetë e mundur prej kushtëzimeve të tyre.

Një pikënisje e mirë për të nisur diskutimin mbi atë se çfarë është etika është përkufizimi i fjalës. Collins (1999), në fjalorin e tij konçiz, paraqet tri pikëpamje të ndryshme: studimi filozofik i vlerave morale të sjelljes njerëzore dhe rregullat e parimet që duhet ta udhëheqin atë, një kod sjelljeje i konsideruar korrekt, ose përshtatshmëria morale e një vendimi, mënyre veprimi etj.

Pikëpamja e parë dhe e fundit lidhet në thelb me atë që etika duhet të jetë dhe ka të bëjë me fushën e filozofisë. Pikëpamja e dytë është një pikëpamje empirike, përshkruese dhe merr në konsideratë pyetje të tilla, si: “Si veprojnë aktualisht kontabilistët?”, pra në vetvete ka të bëjë me mënyrën se si operon etika në praktikë.

Sipas Kaler (1999) etika mund të shihet si një degë e filozofisë, e cila përpiket të adresojë pyetje të moralit, pra ajo ka të bëjë me një ekzaminim normativ të praktikave përshkruese të moralit. Etika mund t’i adresojë këto çështje nga pikëpamje të ndryshme, por ajo ka një qëllim praktik thelbësor, i cili ka të bëjë me sjelljen e jetës sonë si në nivel individual ashtu edhe në nivel kolektiv.

Në të vërtetë kuptimi i etikës është i vështirë të përkufizohet dhe pikëpamjet që kanë njerëz të ndryshëm për etikën janë të lëkundshme. Sociologu Raymond Baumhart përpara shumë kohësh i paraqiti pyetjen e mëposhtme një grupi profesionistësh të biznesit: ”Çfarë kuptimi ka etika për ju?” Midis përgjigjeve të tyre ai dalloi: “Etika ka të bëjë me atë se çfarë më thonë ndjenjat e mia, cila është e drejtë apo e gabuar.” ; “Etika ka të bëjë me atë që feja ime beson.” ; “Të jesh etik do të thotë që të bësh atë që ligji kërkon.” ; “Etika ka të bëjë me standardet e sjelljes që shoqëria jonë pranon.” ; “Nuk e di kuptimin e kësaj fjale.”

Përgjigjet janë të kuptueshme dhe nxjerrin në pah atë çka etika e aplikuar nuk është. Ashtu sikurse i intervistuari i parë, shumë njerëz tentojnë ta barazojnë etikën me ndjenjat e tyre. Por, të qenit etik nuk është qartësisht çështje e ndjekjes së ndjenjave të personit. Një person, i cili ndjek ndjenjat e tij mund të shmanget nga bërja e asaj që është e drejtë. Në fakt, ndjenjat vazhdimisht devijojnë nga ajo që është etike.

Në të njëjtën kohë etika nuk duhet identifikuar nëpërmjet besimit fetar. Shumë besime fetare pa dyshim që përkrahin standarde të larta etike. Nga ana tjetër, në qoftë se etika do të kufizohej me besimin fetar atëherë ajo do të aplikohet vetëm nga njerëzit fetarë. Ndërkohë që ajo zbatohet më tepër nga njerëzit jo fetarë. Të jesh etik nuk mjafton vetëm të ndjekësh ligjin apo të bësh diçka që pranohet nga e gjithë shoqëria. Për më tepër, nëse të jesh etik do të thotë të bësh diçka të pranuar nga e gjithë shoqëria, atëherë për të gjetur se çfarë konsiderohet etike duhet më parë të gjejmë atë që shoqëria pranon. Duhet pasur parasysh se mungesa e konsensusit social lidhur me një numër të madh çështjesh e bën të pamundur të barazosh etikën me atë çka pranohet nga e gjithë shoqëria.

Edhe pse Baumhart e bëri këtë pyetje afërsisht katër dekada më parë, i intervistuari i parë përfaqëson atë që unë realisht gjej sot në përvojën time dhe që në përgjithësi mendohet se është një çështje e së drejtës përballë së gabuarës ose e së keqes përballë së mirës. Shumë prej nesh mund ta kundërshtojnë instiktivisht këtë, duke qenë se ne jemi mësuar të dallojmë çka është e mirë dhe e keqe që në fëmijëri.

Atëherë lind natyrshëm pyetja: Çfarë është në të vërtetë etika? Edhe pse koncepti i etikës është një koncept i diskutuar gati dy mijë e pesëqind vjet më parë ende nuk është arritur në një përkufizim konkret dhe të saktë. Në formën e tij më të thjeshtë ky koncept ka të bëjë me të mësuarin e asaj që është e drejtë ose e gabuar dhe më pas me bërjen e asaj që është e drejtë. Duhet theksuar fakti që në këtë këndvështrim paraqitet problematik fakti i rënies në ujdi në lidhje me atë që është e vërtetë.

Për shumë akademikë ka gjithmonë një mënyrë të drejtë veprimi bazuar në parimet morale të pranuar nga shoqëria. Për disa të tjerë veprimi i drejtë realisht bazohet në një

kombinim të situatës specifike, kulturës kombëtare dhe moralit personal të individit që e kryen këtë veprim. Pra, përgjithësisht ajo që është e drejtë varet nga ajo që individi mendon se është e tillë.

Kant (1975) shkroi rreth faktit se disa gjëra edhe pse mund të jenë të mira teorikisht nuk mund të funksionojnë në praktikë, duke marrë shkas nga disa kritika që iu bënë teorive të tij. Sipas tij një fenomen i tillë ishte gjithmonë i pranishëm si rezultat i ekzistencës së një hendeku midis teorisë dhe praktikës. Teoria ofron rregulla të përgjithshme, por ajo nuk mund të na tregojë se si t'i përdorim ato dhe kjo është arsyeja pse gjithmonë janë të nevojshme gjykimet praktike. Sipas Kantit çdo rregull i përgjithshëm duhet të shoqërohet nga një akt gjykimi, i cili do t'i shërbejë praktikuesit për të dalluar rastet për të cilat mundet ose jo që ky rregull të aplikohet. Pra, çdo individ, të cilit i mungon gjykimi mund të jetë i paaftë edhe pse ky individ mund të zotërojë shumë teori.

Secilit prej nesh mund t'i lindë pyetja, se cila e mirë është ideale nëse ajo nuk mund të realizohet në praktikë? Ideale të tilla duhet të kuptohen si qëllime drejt të cilave duhet të përpiqemi, edhe pse asnjëherë nuk do të kemi mundësinë t'i realizojmë totalisht. Fakti që ne nuk mund t'i arrijmë këto ideale mund të konsiderohet si një kufizim moral në kushtet apo jetët tona.

Për teoritë e përgjithshme të etikës, të tilla si: utilitarizmi, hendeku midis teorisë dhe praktikës paraqet një problem të mprehtë. Utilitarizmi, teoria etike më e rëndësishme në dyqind vitet e shkuara, thotë se ne duhet të bëjmë gjithçka që ka pasojat më të mira për këdo që ndikohet nga veprimet tona. Kjo mund të tingëllojë këndshëm në teori, por kritikët vënë në dukje që asnjë nuk mund të adoptojë një etikë të tillë në praktikë. Ka edhe diçka

tjetër pse etika utilitariste është shumë e kërkuar. Ajo kërkon që ne të përdorim të gjitha burimet tona për të ndihmuar të tjerët. Në këtë këndvështrim nuk është e arsyeshme që ne të shpenzojmë para për veshje të reja, bileta koncerti e të tjera si këto kur 1/3 e fëmijëve në mbarë globin nuk kanë ushqimin e mjaftueshëm.

Nga ana tjetër ka disa filozofë utilitaristë, të cilët mbështesin një qasje më fleksibël. Ato mendojnë se mënyra e drejtë e të vepruarit është gjithçka që maksimizon dobishmërinë, por nga ana tjetër pranojnë faktin se do të ishte shkatërruese nëse njerëzit do të merreshin me kalkulimin e dobishmërisë gjatë gjithë kohës. Prandaj, nuk është më vendi t'u kërkohej njerëzve të drejtojnë sjelljen e tyre duke iu referuar drejtpërsëdrejti parimit të dobishmërisë. Për qëllime praktike, njerëzit kanë nevojë për rregulla të thjeshta dhe të lehta për t'u zbatuar.

Ndërkohë që utilitarizmi duket sikur kërkon shumë, teoritë e tjera duket sikur kërkojnë shumë pak. Duke marrë në konsideratë këto vështirësi, nuk është e habitshme që ashtu sikurse Kant të ketë edhe shumë të tjerë që vazhdojnë të besojnë që teoritë etike janë të padobishme në praktikë. Filozofët bashkëkohorë, të cilët merren me etikën e aplikuar shpeshherë e pohojnë diçka të tillë. Pjesë e problemit është gjithashtu fakti që çdo teori e përgjithshme etike ka të meta, për arsyt e lartpërmendura. Por, edhe sikur ky fakt të anashkalohet, perceptimet e teorisë etike janë shumë abstrakte për t'u përdorur në raste konkrete, të cilat janë të çrregullta dhe të veçanta.

Pra në përfundim mund të themi se edhe pse shumë të dobishme teoritë e etikës janë të vështira për t'u praktikuar. Në këtë këndvështrim del e nevojshme që për t'i bërë teoritë e etikës të dobishme për t'u zbatuar në praktikë, secila prej këtyre teorive të shoqërohet me

raste praktike me qëllim që ato të bëhen të lehta për t'u aplikuar. Në vazhdim do të trajtohen ndryshimet dhe ngjashmëritë midis konceptit të etikës dhe konceptit të moralit.

2.2. Etika përballë moralit

Në pamje të parë secilit prej nesh termat etikë dhe moral mund t'i duken si sinonime të njëra-tjetrës. Në fakt një perceptim i tillë do të ishte i gabuar nëse do t'i analizonim këto dy terma. Etika përcakton një kod të caktuar sjelljeje që një shoqëri apo një grup i caktuar njerëzish vendosin të ndjekin, ndërsa morali lidhet me konceptet e së drejtës dhe së gabuarës në një nivel më të thellë, sa shpirtëror aq edhe personal. Etika që një person shfaq ndikohet nga një sërë faktorësh të jashtëm, si kombësia, shoqëria, grupi i referencës, besimi fetar dhe profesioni, kështu që mund të ndryshojë sa herë që ndryshon njëri prej këtyre faktorëve që e ndikojnë atë. Në ndryshim nga etika, morali zakonisht është i pandryshueshëm. Por, morali pretendohet të jetë i një natyre më sublime dhe për të vendosur se si formohet ai nuk është e lehtë. Në këtë këndvështrim të jesh etik është relativisht më e lehtë, sepse duhet vetëm të ndjekësh një set rregullash shoqërore, të cilat pranohen nga shoqëria dhe prej të cilave përfitojnë të gjithë individët. Pra, pavarësisht se duket sikur etika dhe morali janë të njëjtë, ato janë dy koncepte të ndryshme nga njëri-tjetri. Etika ka të bëjë me shoqërinë, ndërsa morali është një koncept individual. Etika lidhet më tepër me jetën profesionale, kurse morali ka të bëjë me parimet që një individ ndjek individualisht.

Edhe pse secili prej nesh mund të ketë lexuar mjaftueshëm rreth bazave të etikës, lidhshimit, moralit apo përgjegjësisë sociale dhe për secilin nga këta terma mund të ketë një pikëpamje të caktuar të bazuar në përvojën dhe mendimet e tij, ka një pjesë të

konsiderueshme individësh të cilët ende nuk e dinë kuptimin thelbësor të vlerave, etikës dhe moralit. Etika është një degë e filozofisë, e cila në mënyrë teorike, logjike dhe racionale përcakton të drejtën përkundrejt së gabuarës, të mirën përkundrejt së keqes dhe moralin përkundrejt veprimeve jo të moralshme. Disa njerëz e përkufizojnë etikën thjesht si të bërit e asaj që është thënë më parë se do të bëhet.

Në përgjithësi etika vendos rregullat dhe standardet që udhëheqin sjelljen e moralshme të individëve dhe grupeve. Ajo gjithashtu ndan sjelljen e drejtë nga sjellja e gabuar. Etika përfshin konsiderata të ndershme ndaj një motivi të caktuar, ndaj dëmit potencial të mundshëm dhe ndaj vlerave dhe rregullave të vendosura.

Etika e aplikuar u referohet konkluzioneve morale të bazuara në rregulla, standarde, kode etike dhe modele që ndihmojnë për të marrë vendime. Ka disa ndarje të fushës së etikës, ku ndër më të zakonshmet mund të përmendim etikën deskriptive, etikën normative dhe etikën krahasuese. Etika e biznesit, në mënyrë më specifike, ka të bëjë me krijimin dhe aplikimin e standardeve morale në mjedisin e biznesit.

Morali ka të bëjë me gjykimet, standardet dhe rregullat e sjelljes së mirë në një shoqëri të caktuar. Të gjitha këto sëbashku udhëheqin individët drejt sjelljeve të lejuara duke u mbështetur në rregullat themelore.

Të kuptuarit e saktë të vlerave, etikës dhe moralit gjatë përdorimit të standardeve etike, në mënyrë të veçantë një biznesmen mund të formojë një kuadër të vlefshëm për të arritur një vendimmarrje efektive nëpërmjet strategjive të formalizuara. Vullneti për të ndërthurur parimet etike në strukturën e vendimmarrjes shpalos një dëshirë për të promovuar drejtësinë dhe njëkohësisht edhe për të parandaluar probleme të rëndësishme etike që mund të ndodhin.

Programet e etikës së kompanive janë pjesë e jetës organizative dhe organizatat mund t'i përdorin ato për të diskutuar më tej kuptimin e vlerave, etikës dhe moralit nga këndvështrimi i biznesit të tyre. Kodet e etikës së kompanive duhet t'i mbrojnë individët dhe të përcaktojnë vlerat morale të kompanisë në proceset e vendimmarrjes. Kodet e etikës së kompanive nuk janë thjesht manuale për të zgjidhur problemet. Ato janë mjete që mund t'i japin fuqi çdo punonjësi të kompanisë së tyre të jetë i ndërgjegjshëm për politikën e kompanisë dhe kodin e saj të etikës. Të vepruarit në mënyrë të tillë do të rrisë përgjegjshmërinë personale të individëve, të cilët punojnë në kompani, sepse këta individë do të krenohen me ndershmërinë dhe integritetin e kompanisë së tyre.

2.3. Teoritë e vendimmarrjes etike

Procesi i vendimmarrjes së çdo individi lidhur me një çështje të caktuar është një proces i vështirë dhe i komplikuar, duke qenë se secili prej nesh duhet të marrë parasysh disa faktorë dhe rrethana specifike në momentin kur e merr këtë vendim. Akoma edhe më i vështirë dhe kompleks është ky proces në rastin e kontabilistëve, të cilët marrin vendime mjaft të rëndësishme në lidhje me njësinë që ato drejtojnë, vendime këto nga të cilat varet performanca dhe vijimësia e saj.

Secili prej nesh mund të imagjinojë me lehtësi se vlerat etike personale dhe proceset e vendimmarrjes që një individ përdor në jetën e tij të përditshme influencohen nga një sërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm. Janë këta faktorë që ndërthuren për të formuar opinionin individual ndaj një situatë të caktuar, duke filluar nga çështjet e rëndësishme personale deri tek ato që kanë të bëjnë thjesht me të bërin e asaj që një individ i kërkohet të bëjë çdo ditë në vendin e tij të punës, (Caldwell, Bischoff, & Karri, 2002; Polkinghorne,

2005) Etika individuale derivon nga eksperiencat e individit dhe mund të influencohet nga një sërë faktorësh të tjerë të rëndësishëm. (Burns,2004; Weston,2001)

Teori të ndryshme kombinohen me njëra-tjetrën për të ndërtuar një tablo të qartë përsa i përket mënyrës sesi merren vendimet etike. Teoritë lidhur me vendimmarrjen etike janë të ndryshme. Kërkuesit mbështeten te teoritë etike, qasjet filozofike dhe psikologjike për të kuptuar procesin e vendimmarrjes etike. Dy qasjet më shpesh të përdorura në fushën e etikës së biznesit janë: qasja normative dhe qasja përshkruese ose deskriptive. (O’Fallon & Butterfield, 2005)

Qasja normative, e cila bazohet në fushën e filozofisë së moralit dhe teleologjisë, ka të bëjë me atë çfarë është e drejtë dhe e gabuar dhe çfarë duhet të bëhet. Nga ana tjetër qasja përshkruese, e cila bazohet kryesisht në fushën e biznesit dhe të psikologjisë, ka të bëjë me atë se si individët bëjnë vendimmarrje etike aktualisht, çfarë hapash ndërmarrin, cilat parime përdorin dhe çfarë faktorësh të tjerë influencojnë vendimet e tyre (Miner & Petocz, 2003).

Ka një numër shumë të madh teorish normative, të cilat nuk janë të përdorshme në fushën e manaxhimit dhe etikës së biznesit. Në fakt pjesa më e madhe e studimeve në fushën e etikës së biznesit dhe kryesisht ato të bëra në lidhje me procesin e vendimmarrjes etike janë më tepër me natyrë përshkruese sesa me natyrë normative. Këtu mund të përmendim punimet e McMahon & Harvey (2007); Nill, Schibrowsky, & Peltier (2004).

Modelet më të mirënjohura të vendimmarrjes etike (Jones, 1991; Rest, 1986; Trevino, 1986) janë të bazuara në teori deskriptive dhe supozojnë se procesi i

vendimmarrjes etike ndikohet nga një numër i madh faktorësh individualë, organizativë dhe nga karakteristikat e çështjeve etike. (Nill et al., 2004)

Sipas Carlson, Kacmar, & Wadsworth, 2002 vendimmarrja etike përkufizohet si “një proces në të cilin individët përdorin bazën e tyre morale për të vendosur, nëse një çështje e caktuar është e drejtë ose e gabuar.”

Jones (1991) shton që vendimi etik është një vendim jo vetëm i ligjshëm, por edhe moralisht i pranueshëm nga të tjerët. (Nill et al., 2004)

Guy (1990) argumenton se vendimmarrja etike në vendin e punës imponon moralin individual dhe gjykimin në lidhje me punën. Ai del në konkluzionin se karakteristikat e vendimmarrjes etike janë: vendimi influencon dy ose më shumë vlera; individi haset me një dilemë; procesi është i mbushur me paqartësi dhe rezultate të panjohura në pritje.

Këto karakteristika faktojnë vështirësinë dhe kompleksitetin në natyrën e procesit të vendimmarrjes etike (Miao-Ling, 2006).

Kuadri teorik i hartuar nga Rest (1986) cilësohet si një nga shkrimet më të rëndësishme lidhur me procesin e vendimmarrjes së individit brenda organizatës. Në modelin fillestar të vendimmarrjes etike ai përcakton katër faza nëpër të cilat kalon procesi. Më pas ky model u përmirësua dhe u shndërrua në një model që mbështeste faktin se faktorët psikologjikë ndikojnë çdo veprim moral (Rest et al., 1986, 1999). Ai propozon një proces, i cili kalon në katër etapa të cilat janë: ***njohja etike*** (aftësia për të dalluar nëse kemi të bëjmë me një situatë etike ose jo) ***gjykimi etik*** (aftësia për të vendosur se cila mënyrë veprimi është e

drejtë) **qëllimi etik** (aftësia për t'i dhënë prioritet alternativave etike kundrejt alternativave të tjera) **sjellja etike** (aftësia për të ndërmarrë sjellje etike).

Rest argumenton që secila fazë apo etapë është konceptualisht e ndryshme dhe se suksesi në njëren fazë nuk do të thotë domosdoshmërisht sukses edhe në fazën tjetër. Që prej vitit 1990 pjesa më e madhe e studimeve dhe e modeleve mbi vendimmarrjen në fushën e biznesit janë bazuar fuqimisht mbi strukturën e Rest. Kërkues të fushave të ndryshme si marketing, auditim, dhe menaxhim nga vende të ndryshme e kanë adaptuar këtë strukturë në kërkimet e tyre. Ndonëse disa prej tyre kanë analizuar vetëm një fazë të këtij procesi, disa të tjerë janë marrë me studimin e dy ose më shumë fazave.

Trevino (1986) ofroi një model bashkëveprues të vendimmarrjes etike, i cili ishte kryesisht i ndërtuar mbi Teorinë e Zhvillimit të Njohjes së Moralit të Kohlberg (1969). Ajo përfshiu në modelin e saj tri pjesë të modelit të Rest mbi procesin e vendimmarrjes etike. Në këtë model kompleks ajo e përshkruan procesin e vendimmarrjes etike në tri faza, proces ky që sipas saj fillon me njohjen e çështjes etike, vazhdon me përpunimin e njohjes dhe përfundon me angazhimin në një veprim konkret. Si faktorët individualë ashtu edhe ato organizativë janë inkorporuar në këtë proces. Sipas Trevinos vendimmarrja etike është produkt i një ndërveprimi midis faktorëve individualë dhe atyre organizativë në lidhje me mënyrën individuale të menduarit lidhur me dilemat etike. Përfshirja e këtyre faktorëve në strukturat teorike të vendimmarrjes etike konsiderohet si një nga zhvillimet më të mëdha në fushën kërkimore të etikës së biznesit.

Më pas vjen rradha e modelit të Jones (1991), i cili bazohet në modelin e Rest (1986). Ai argumenton që shumica e modeleve të vendimmarrjes etike në fushën e etikës së biznesit janë ndërtuar mbi bazën e modelit katër fazësh të Rest (1986). Megjithatë asnjëri prej këtyre modeleve nuk ka marrë në konsideratë karakteristikat e çështjeve etike në vetvete si një faktor të pavarur (Jones, 1991).

Bazuar në modelin e Rest, Jones (1991) solli për herë të parë konceptin e dimensioneve të intensitetit moral, i cili përbëhet nga gjashtë komponentë:

- ***madhësia e pasojave***, e cila përfaqëson shumën e dëmit apo përfitimit që shkakton një veprim i moralshëm ndaj personave të përfshirë në të.
- ***konsensusi social***, i cili përfaqëson shkallën me të cilën shoqëria e pranon një veprim të caktuar si të mirë ose të keq.
- ***probabiliteti i efektit***, ka të bëjë me mundësinë që një veprim i caktuar të ndërmerret dhe të dëmtojë / shpërblejë personat e përfshirë në të.
- ***shpejtësia e shfaqjes së pasojave***, e cila ka të bëjë me kohën midis momentit të ekzekutimit të veprimit dhe shfaqjes së pasojave të tij.
- ***afërsia***, e cila ka të bëjë me ndjenjën e menjëhershme të personave të përfshirë.
- ***përqëndrimi i efektit***, i cili lidhet me fortësinë e pasojave ndaj personave të përfshirë.

Një model për t'u marrë në konsideratë është edhe ai i ndërtuar nga Hunt & Vitell (1986). Ata hartuan një teori pozitive të etikës në marketing duke integruar në të filozofinë e moralit. Ata argumentojnë që teoritë normative të filozofisë së moralit të tilla, si:

teleologjia dhe deontologjia mund të përfshihen në teoritë e vendimmarrjes etike. Hunt & Vitell propozojnë që vendimmarrja etike të fillojë me njohjen e dilemës etike në një situatë të dhënë. Më pas mund të përdoren si vlerësimet deontologjike, ashtu edhe ato teleologjike për të gjykuar mënyrat e ndryshme të veprimit për të përfituar gjykime etike të lidhura me to. Qëllimet për të vepruar do të jenë pasojë e këtyre gjykimeve etike të bëra. Së fundi, sipas Hunt & Vitell sjellja etike është rezultat i këtyre fazave të njëpasnjëshme. Hunt & Vitell (1986) argumentojnë që gjykimi etik jo gjithmonë pajtohet me qëllimin e veprimit dhe gjithashtu sjellja etike nuk është gjithmonë konsistente me qëllimin etik. Edhe pse Hunt & Vitell shtuan etapën e vlerësimit teleologjik, në të cilën vlerësohen pasojat e vendimit etik, ato nuk sugjerojnë një lidhje sistematike midis pasojave dhe komponentëve të njëpasnjëshëm të modelit të qëllimit dhe sjelljes (Jones, 1991).

Në përgjithësi, të gjitha këto modele janë kryesisht të bazuara në modelin e ndërtuar nga Rest (1986) dhe secili prej tyre ka shtuar disa faktorë, të cilët janë vërtetuar empirikisht se mund të influencojnë fazat e procesit të vendimmarrjes etike.

Duke qenë se ky punim ka për qëllim të hetojë lidhjen që ekziston midis procesit të vendimmarrjes etike dhe faktorëve individualë, organizativë dhe dimensionet e intensitetit moral të çështjes etike, këto modele me në krye modelin e ndërtuar nga Rest (1986) do të përdoren në këtë studim në mënyrë që të arrihet qëllimi i tij.

Modeli Rest

Studimet deskriptive në etikën e biznesit janë ndërtuar mbi bazën e modeleve teorike që derivojnë nga modeli i Rest (1986) mbi procesin e vendimmarrjes etike. Më poshtë do të trajtohen katër fazat e procesit të vendimmarrjes.

a) Njohja etike

Njohja etike është faza e parë e modelit të ndërtuar nga Rest (1986) dhe sipas studiuesve të ndryshëm është faza më kryesore dhe vendimtare e këtij procesi duke qenë se ajo ndihmon në fillimin e vendimmarrjes etike. Butterfield, Trevino & Weaver (2000) e përkufizon njohjen etike si “ndërgjegjësimi i një individi që vendimi ose veprimi potencial i tij/saj mund të influencojë interesin, mirëqënien ose pritshmëritë e individit vendimmarrës edhe të tjerëve në një mënyrë që mund të jetë në konflikt me një ose më shumë parime etike”. Sikurse vihet re nga ky përkufizim tri janë pikat kyçe të kësaj etape: njohja e vendimmarrësit, vendimi ose veprimi dhe individët që do të ndikohen.

I rëndësishëm për t’u përmendur është edhe qëndrimi i Rest, i cili thotë se procesi i vendimmarrjes etike fillon në momentin kur një individ kupton se situata që i paraqitet ka të bëjë me një çështje etike ose një parim etik duhet të aplikohet për ta zgjidhur atë. Ai argumenton që aftësia për të identifikuar dhe vlerësuar çështjen etike në një situatë është një kusht paraprak i nevojshëm për vendime etike të drejta.

Hunt & Vitell (1986) e përshkruajnë këtë fazë si një katalizator që udhëheq tërësisht procesin e vendimmarrjes etike.

Trevino (2006) ka bërë një shqyrtim të sjelljes etike në organizata dhe pohon se shumica e kërkuësve që kanë studiuar njohjen etike kanë përdorur dy qasje kryesore. Qasja e parë fokusohet në ndjeshmërinë etike të individit që në vetvete ka të bëjë me aftësinë e individit për të evidentuar çështjet etike në një situatë të dhënë. Qasja e dytë e konsideron individin vetëm si një nga faktorët e shumtë që mund të

formojnë njohjen etike. Një shembull i kësaj qasjeje është modeli i Jones, i cili fokusohet në dimensionet e intensitetit moral që ka çështja etike në vetvete më tepër sesa në karakteristikat e individit.

Duhet theksuar se megjithëse individët ndërmarrin vendime etike jo domosdoshmërisht në të gjitha rastet ato i njohin elementët etikë të vendimeve të tyre.

Në studimin e bërë nga Hunt & Vitell (2006) pohohet se kur individët gjenden përballë një situatë vendimmarrjeje që përmban një komponent etik, ka raste kur individët asnjëherë nuk janë të përgjegjshëm që në të përfshihet një situatë etike.

Në të njëjtën kohë, Rest (1986) pretendon që ndryshimet midis individëve në prirjet e tyre për të identifikuar çështjet etike janë të habitshme.

Jackling et al., (2007) argumenton që problem për individët është fakti se çështjet etike zakonisht janë të fshehura dhe ato shpeshherë nuk kanë ndjeshmërinë etike për të njohur çështjet etike kur ato linden.

Sparks & Hunt (1998) pohojnë se ndjeshmëria etike jo domosdoshmërisht nënkupton etikshmëri, të qenit etikisht i ndjeshëm nuk nënkupton që individi është më etik, për aq kohë sa shumica e individëve, të cilët sillen në mënyrë imorale mund të jenë të vetëdijshëm për çështjet etike që përfshihen në vendimet e tyre. Sipas Jones (1991) njohja e çështjeve etike përfshin dy komponentë që janë të nevojshëm për t'i identifikuar ato: individi duhet të jetë i vetëdijshëm që veprimi i tij do të influencojë mirëqënien e të tjerëve dhe komponenti i dytë, individi ka vullnet në këtë çështje. Prandaj, nëse një individ dështon në identifikimin e çështjeve etike ai ose ajo nuk ka shans të kalojë në fazën tjetër të vendimmarrjes dhe

gjithashtu nuk ka mundësi që vendimi i marrë prej tyre të jetë bërë në përputhje me aspektet e tjera si motivimi ekonomik. Chia dhe Lim (2000) pohojnë që kur dimensionet etike të një çështjeje njihen nga individët, kjo njohje ka potencialin për të influencuar gjykimet, sjelljen dhe qëllimet e tyre.

b) Gjykimi etik

Gjykimi etik përbën fazën e dytë të procesit të vendimmarrjes dhe cilësohet si një ndër fazat më të rëndësishme të tij. Sipas Trevino (1986) gjykimi etik ka të bëjë me procesin, gjatë të cilit një individ përcakton se cili kurs veprimi është moralisht i drejtë ose i gabuar. Elementi më i rëndësishëm i kësaj etape konsiston në përdorimin e aftësive njohëse të vendimmarrësit në momentin që ai përballlet me një dilemë etike dhe i duhet të përcaktojë çfarë është e drejtë dhe e gabuar. Të vendosurit midis asaj që është e drejtë dhe asaj që është e gabuar është elementi më vital në fazën e gjykitimit etik pasi në rastet kur individit nuk bën zgjedhjen e duhur midis së drejtës dhe së gabuarës në momentin e duhur, atëherë gjykimi i tij individual nuk mund të shpjegohet si etik.

Procesi i gjykitimit etik teorikisht varet nga standardet morale të internalizuara, të cilat mund të ndikohen nga faktorët individualë, organizativë dhe karakteristikat e çështjeve etike në vetvete. Sipas Schminke, Arnaud, & Kuenzi (2007) individët i përdorin këto standarde për të peshuar alternativat dhe për të vendosur veprimet korrekte.

Në modelin e tyre të vendimmarrjes Hunt dhe Vitell (1986) pretendojnë se vlerësimet deontologjike dhe teleologjike luajnë një rol kyç në bërjen e gjykimeve etike rreth një çështjeje të caktuar etike, gjë që mund të influencojë qëllimin e individit për t'u sjellë në

një mënyrë të caktuar. Gjykimi etik është kryesisht një qasje për të perceptuar dhe gjetur zgjidhje për konfliktet etike në një situatë të dhënë (Ponemon,1990).

Kjo fazë e procesit të vendimmarrjes etike bazohet kryesisht në fazat njohëse të zhvillimit moral (CMD) të zbuluara nga Kohlberg (1969, 1981), në thelb të bazuara në punën e mëparshme të Piaget (1932,1965). Kjo teori ka shërbyer si baza teorike për një sërë teorish të mëpasme në lidhje me vendimmarrjen etike, ndër të cilat mund të përmendim Haines & Leonard (2007,a); Rest, Bebeau, &Volker (1986).

Trevino (1986) përdori modelin e zhvilluar nga Kohlberg për të ndërtuar teorinë e saj të vendimmarrjes etike, e cila vë në qendër karakteristikat e individit që bën vendimmarrjen. Modeli i saj lidh gjykimin etik me sjelljen etike dhe sugjeron që faktorët individualë ndikojnë procesin e vendimmarrjes në tërësi dhe jo vetëm gjykimin nëse sjellja është e pranueshme dhe etike apo jo (Haines & Leonard, 2007a). Edhe pse qëllimi i këtij punimi nuk është shpjegimi i hollësishëm i aspekteve teorike të CMD, mendoj se disa shpjegime të teorisë së Kohlberg janë të dobishme në mënyrë që të kuptohet sfondi teorik i studimit.

Teoria e CMD ka të bëjë me mënyrën sesi bëhen gjykimet, edhe pse individët formulojnë gjykimet. Kjo teori, e cila është bazuar në të dhënat e marra nga intervistat dhe nga të dhënat e marra nga vëzhgimet direkte, konsiston në tri nivele dhe secili prej tyre përbëhet nga dy faza të ndryshme. Në nivelin e parë, i cili njihet si niveli para-konvencional, individët e bazojnë gjykimin e tyre moral në interesat e tyre personale. Në nivelin e dytë, i cili njihet si niveli konvencional, individët i zhvillojnë gjykimet e tyre morale duke pasur parasysh që ato janë pjesë e një grupi anëtarët e të cilit ndajnë interesa të njëjta.

Në nivelin e tretë, i cili njihet si niveli pas-konvencional, individët veprojnë në mënyrë të arsyeshme dhe etike në përpjekje për të ruajtur standardet etike, mbi të cilat një shoqëri e caktuar është ndërtuar (Steven, Cooper & Leung, 2006)

Ponemon (1990) pohon për të kuptuar këto tri nivele është e nevojshme që secili prej tyre të mendohet i ndryshëm, përse i përket marrëdhënies midis rregullave dhe pritshmërive të vetes dhe shoqërisë.

Në fazën e parë, zbatimi i rregullave është i rëndësishëm, sepse është mënyrë për të ndaluar ndëshkimet. Individët në fazën e dytë i bazojnë gjykimet etike në një lloj analize kosto - përfitim, e cila në rradhë të parë reflekton interesin e tyre personal. Në fazën e tretë individët sillen në mënyrë etike për të kënaqur interesat e të tjerëve. Në fazën e katërt fokusi është ruajta e rendit duke ndjekur rregullat, duke bërë detyrën dhe duke respektuar autoritetet. Individët në fazën e pestë fillojnë të vlerësojnë ndryshimet në vlerat, opinionet dhe besimet e të tjerëve. Në fazën e gjashtë, sjellja etike bazohet në zbatimin e parimeve universale të drejtësisë dhe etikës. Sipas Jackling et al. (2007) zakonisht nivelet e larta të gjyimit moral indikojnë standarde të larta etike.

Edhe pse kjo teori ka dominuar fushën e kërkimeve etike si në psikologji ashtu edhe në biznes, ajo nuk është pa kritika.

Në një punim të tyre Rest, Narvaez, Thoma & Bebeau (1999) listojnë disa limitime të kësaj teorie. Së pari kritikohet fakti që kjo teori fokusohet vetëm në fazën e gjyimit etik si përcaktuesi kryesor i sjelljes etike duke injoruar pjesët e tjera të procesit etik, të tilla si: qëllimi etik, i cili mund të ndikojë në sjelljen e individëve. Së dyti kjo teori kritikohet për

faktin se bazohet në filozofinë dhe kulturën perëndimore duke mos marrë në konsideratë vendet e lindjes, të cilat duke qenë se kanë kultura dhe filozofi të ndryshme mund të kenë edhe pikëpamje të ndryshme etike, të cilat nuk merren në konsideratë nga teoria e Kohlberg. Megjithatë kjo teori është shumë e përgjithshme dhe abstrakte dhe mund të përdoret edhe në këto vende. Së fundi duhet theksuar se kjo teori është ndërtuar duke u bazuar në kërkimet empirike, të cilat kanë përdorur vetëm pjesëmarrës meshkuj, kështu që kjo teori nuk merr në konsideratë karakteristikat e femrave.

c) Qëllimi etik

Faza e tretë e procesit të vendimmarrjes etike në modelin e Rest (1986) është qëllimi etik. Nëse një individ ka bërë një gjykim etik, ai/ajo formulon një qëllim për t'u sjellë në mënyrë etike bazuar në vlerësimin e zgjidhjes së drejtë kundrejt zgjidhjeve të tjera (Sweeney & Costello, 2009).

Sipas Rest (1986) motivimi ose qëllimi etik është shkalla e angazhimit për të ndjekur kursin moral të veprimit, duke vënë vlerat morale mbi vlerat e tjera dhe duke marrë përsipër përgjegjësitë personale për rezultatet morale (Armstrong et al., 2003). Ai argumenton që qëllimi i individëve për t'u sjellë në mënyrë etike, madje edhe në kurriz të interesave të tyre, mund të rrjedhë nga gjëra të ndryshme, si: turpi, normat sociale, ndjeshmëria e lartë, kujdesi, afeksioni dhe vetë-integriteti. Kështu, në këtë fazë, individi duhet të peshojë vlerat etike kundrejt vlerave të tjera për të krijuar qëllimin etik (Jones, 1991; Rest, 1986). Për më tepër, mangësitë në qëllimet etike mund të çojnë në sjellje joetike. Ndër modelet më të zakonshme të vendimmarrjes etike (Hunt & Vitell, 1986; Jones, 1991; Rest, 1986) që janë

ndërtuar, vendosja e qëllimeve etike është vitale. (Sweeney & Costello, 2009) Në modelin e Hunt dhe Vitell (1986) qëllimi etik konsiderohet si faktori përfundimtar më i rëndësishëm i influencuar nga gjykimi etik dhe teleologjia e veprimit. Në mënyrë të ngjashme, në modelet e Rest (1986) dhe Jones (1991) qëllimi etik është rezultati përfundimtar, i ndikuar nga gjykimi etik.

Lidhur me qëllimin etik, dy janë teoritë më të rëndësishme dhe më të mirënjohura që e shpjegojnë atë, Teoria e Veprimit të Arsyetuar (TVA) nga Ajzen dhe Fishbein (1980) dhe Teoria e Sjelljes së Planifikuar (TSP) nga Ajzen (1991). Ato janë plotësisht të fokusuara në fazën e tretë dhe të katërt të modelit të vendimmarrjes etike të Rest, në qëllimin etik dhe në gjykimin etik. Të dyja teoritë së bashku sigurojnë një kuadër të mjaftueshëm për të zgjeruar të kuptuarin e faktorëve që lidhen me qëllimet etike të individëve (Buchan, 2005).

TVA bazohet në qëllimin e individit për t'u angazhuar në veprim. Ajo sugjeron se qëllimi i individit për të kryer ose jo një veprim është numëruar i menjëhershëm i veprimit aktual (Cruz, Shafer & Strawser, 2000). Sipas kësaj teorie, qëndrimet ndaj sjelljes dhe normave subjektive janë përcaktuesit kryesorë të qëllimit të individit për t'u përfshirë në një veprim të caktuar. Qëndrimet përfshijnë gjykimet nëse një veprim është i drejtë ose i gabuar dhe nëse individit ka ndërmend ta kryejë ose jo atë. Normat subjektive janë perceptim i asaj, sesi duhet të veprojë individit (Buchan, 2005).

Më vonë Ajzen e zgjeroi teorinë e veprimit të arsyetuar në teorinë e sjelljes së planifikuar. Kontrolli i perceptuar i sjelljes i është shtuar kësaj teorie për të reflektuar perceptimin sesa e vështirë apo e lehtë do të ishte për të kryer veprimin.

Madden, Ellen & Ajzen (1992) argumentojnë që kontrolli i perceptuar i sjelljes influencon qëllimet për t'u angazhuar në sjellje.

Edhe pse TSP (Ajzen, 1991) parashikon një lidhje midis qëllimit dhe sjelljes dhe ky parashikim është mbështetur në disa fusha, kërkimet e fundit të etikës kanë zbuluar që ajo që një individ ka ndërmend të bëjë mund të mos jetë ajo që ky individ aktualisht bën (Weber & Gillespie, 1998).

d) Sjellja etike

Faza finale e procesit të vendimmarrjes etike është sjellja etike. Ajo ka të bëjë me momentin kur një individ angazhohet në një veprim të caktuar si rezultat i qëllimit të tij. Sjellja etike përkufizohet si diçka që është moralisht dhe ligjërisht e pranueshme nga komuniteti i gjerë (Jones, 1991). Rest (1986) sugjeron që sjellja etike është rezultat i një procesi kompleks dhe të shumëfishtë.

Edhe pse shumë kërkues sugjerojnë që ka nevojë për më shumë kërkime empirike lidhur me sjelljen etike, disa prej tyre argumentojnë se sjellja etike nuk është e thjeshtë për t'u studiuar për shkak të natyrës së saj të ndjeshme dhe vështirësive në matjen dhe observimin e saj pa paragjykim (Ampofo, Mujtaba, Cavico & Tindall, 2004).

Kërkimet lidhur me teorinë e veprimit të arsyetuar dhe me teorinë e sjelljes së planifikuar, të cilat u përmendën më sipër, kanë gjetur se të dyja këto teori janë shumë të nevojshme në sjelljen e planifikuar (Madden et al., 1992; Shepard, Hartwick & Warshaw, 1988).

Për më tepër disa argumentojnë që kur një organizatë do të inkurajojë sjelljen etike, ajo duhet të fokusohet në faktorët që ndikojnë dhe kontrollojnë sjelljen etike të tillë, si: faktorët individualë, filozofia etike, faktorët e jashtëm dhe faktorët organizativë (Cleek & Leonard, 1998).

Mesa duket studimi i kësaj faze kërkon shumë kohë dhe një buxhet të konsiderueshëm dhe për më tepër duke qenë se shumica e kërkimeve empirike të mëparshme janë fokusuar vetëm në një ose dy faza të procesit të vendimmarrjes etike, punimi im do të merret me tri fazat e para të këtij procesi. Bazuar në ato që u sipërpërmendën, sjellja etike nuk do të ekzaminohet në këtë punim.

2.4. Studimet empirike mbi matjen e fazave të vendimmarrjes etike

Duke qenë se ky punim ka për qëllim analizimin e faktorëve që ndikojnë procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve, të cilët ushtrojnë detyrën e tyre në kompanitë shqiptare për të përmbledhur plotësisht literaturën e deritanishme në këtë fushë, është menduar që fillimisht të analizohet procesi i vendimmarrjes etike në lidhje me të cilin janë zhvilluar një numër i konsiderueshëm teorish dhe në të njëjtën kohë janë ndërmarrë një numër i konsiderueshëm studimesh kryesisht empirike dhe më pas të analizoj të gjithë faktorët që e ndikojnë këtë proces, të cilët do të përfshihen në studimin duke u ndalur te studimet e ndryshme të bëra në lidhje me to.

Katër shqyrtimet më të rëndësishme të literaturës të bëra deri tani janë: Ford & Richardson (1994) “Vendimmarrja etike: Një përmbledhje e literaturës empirike.” Loe, Ferrell & Mansfield (2000) “Një përmbledhje e studimeve empirike që vlerësojnë

vendimmarrjen etike në biznes.” O’Fallon & Butterfield (2003) “Një përmbledhje e literaturës empirike të vendimmarrjes etike 1996-2003” Craft (2013) “Një përmbledhje e literaturës empirike të vendimmarrjes etike.”. Të katra këto punime kanë një qëllim të përbashkët përmbledhjen e literaturës empirike në lidhje me procesin e vendimmarrjes etike. Në këto kushte janë vlerësuar si shumë të rëndësishme për t’u marrë në konsideratë në këtë punim për të shqyrtuar literaturën e deritanishme në lidhje me vendimmarrjen etike. Këto punime kanë arritur në përfundimin se ekzistojnë më shumë se dyzet faktorë individualë dhe organizativë, të cilët janë studiuar deri tani dhe për të cilët janë gjetur lidhje të ndryshme të këtyre me secilën nga fazat e vendimmarrjes etike.

Duke u mbështetur në këto punime përse i përket literaturës së deritanishme për procesin e vendimmarrjes etike mund të pohojmë se njohja etike është studiuar në fusha të ndryshme. Këtu mund të përmendim Seshardi & Broekemier (2009); Sparks & Hunt (1998) në fushën e marketingut; Geiger & O’Connell (1998); Shaub, Finn & Munter (1993); Yetmar & Eastman (2000) në fushën e kontabilitetit dhe Minett, Yaman & Denizci (2009) në fushën e manaxhimit. Përgjithësisht të gjitha këto studime kanë arritur në përfundimin se ka disa faktorë që e ndikojnë këtë fazë të tillë, si: gjinia dhe mosha dhe theksojnë se eksperiencia në punë dhe trajnimi e përmirësojnë njohjen etike të një individi.

Kërkimet empirike kanë sugjeruar dhe demonstruar që njohja etike varet nga faktorët individualë, organizativë dhe nga karakteristikat e çështjeve etike por, megjithatë studiuesit bëjnë thirrje për kërkime të mëtejshme për të qartësuar këta faktorë që ndikojnë mbi njohjen etike. Këtu mund të përmendim punimet e bëra nga Chan & Leung (2006), Ferrell & Gresham (1985), Jones (1991), Roxas & Stoneback (2004), Trevino (1986).

Përsa i përket fazës së gjykimit etik studimet e mëparshme demonstrojnë që gjykimet që lidhen me çështjet etike influencohen nga faktorët individualë, organizativë dhe karakteristikat e çështjeve etike (Eleonora & Niki, 2006; Leitsch, 2006). Njohja dhe gjykimi etik zakonisht konsiderohen si procese njohëse që shërbejnë si paraardhës të qëllimit dhe sjelljes etike (Trevino et al., 2006).

Një numër i madh studimesh kanë arritur në përfundimin se Teoria e Zhvillimit të Moralit Njohës influencon drejtpërsëdrejti procesin e vendimarrjes etike dhe ndër këto studime mund të përmendim Ashkanasy, Windsor & Trevino (2006), Reynolds (2006), Thorne (1999), Trevino (1986).

Në lidhje me fazën e qëllimit etik, disa studime të ndryshme të bëra më parë kanë arritur në rezultatin se ka një lidhje të rëndësishme midis gjykimit etik dhe qëllimit etik (Barnett, 2001; Marta, Singhapaki, Ashraf & Vitell, 2004), ndërsa disa studime të tjera nuk gjejnë lidhje të rëndësishme midis këtyre të dyjave (Shapeero, Koh & Killough, 2003)

Sipas shqyrtimit të literaturës së bërë nga O'Fallon & Butterfield në 2005 janë bërë shumë pak kërkime lidhur me fazën e sjelljes etike. Ndjeshmëria e kësaj faze dhe vështirësitë që lidhen me matjen e saj mund të jenë një nga shkaqet e këtij limitimi (Broekemier, Seshadri, & Nelson, 1998; Haines & Leonard, 2007 ; Trevino, 1992).

Sikurse vihet re modelet më të mirënjohura të vendimarrjes etike të themeluara në fushën e psikologjisë apo të biznesit, bien dakord që procesi i vendimarrjes etike të individëve konsiston në katër faza. Faza e parë është njohja etike, e cila ka të bëjë me ndërgjegjësimin e individit se ekziston një problem etik në një situatë të caktuar, disa persona dështojnë në

njohjen e çështjes etike të një situate të caktuar dhe këto persona nuk kanë shans të kalojnë në fazën tjetër të vendimmarrjes etike. Faza e dytë është gjykimi etik, i cili ka të bëjë me gjykimin e bërë nga individi lidhur me çështjen etike me të cilën ai përballet. Studime të ndryshme janë bërë në lidhje me këtë fazë, e cila është kryesisht e bazuar në Teorinë e Zhvillimit të Moralit Njohës të ndërtuar nga Kohlberg. Faza e tretë është qëllimi etik, i cili i referohet asaj që individi duhet të synojë të sillet në mënyrë të drejtë dhe etike, TVA dhe TSP janë përdorur nga kërkuesit për të studiuar qëllimin etik të individëve. Faza e fundit është sjellja etike, e cila ka të bëjë me angazhimin në veprim.

Këto katër faza mendohet se lidhen me njëra tjetrën dhe mund të ndikohen nga faktorë të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm. Një individ, i cili demonstroi mjaftueshmëri në një fazë jo domosdoshmërisht do të jetë i përshtatshëm në tjetrën dhe dështimi etik mund të ndodhë kur ka mangësi në njërin nga komponentët, për shembull një individ, i cili ka identifikuar një problem etik në një situatë mund të ketë gjykim moral të pamjaftueshëm për të përcaktuar veprimin moral ideal (Chan & Leung, 2006).

Megjithëse studimet kanë treguar se ka lidhje midis tri fazave të procesit të vendimmarrjes, këto lidhje nuk do të hetohen në këtë punim. Për më tepër ky punim do të merret vetëm me investigimin e ndikimit të disa faktorëve individualë dhe organizativë dhe të tri dimensioneve të intensitetit moral në secilën nga këto faza. Diskutimet teorike dhe empirike në lidhje me këta faktorë dhe ndikimin e tyre në secilën nga tri fazat e përmendura të procesit të vendimmarrjes etike do të diskutohen në kapitullin në vijim.

2.5. Konkluzione

Në këtë kapitull u paraqitën diskutimet në lidhje me klasifikimin e etikës si koncept apo praktikë dhe njëkohësisht u bë një krahasim i etikës me moralin, ku u nxorrën në pah të përbashkëtat dhe të veçantat e tyre. Përsa i përket etikës u arrit në përfudimin se pavarësisht dobishmërisë së madhe të teorive etike zbatimi praktik i tyre ka qenë dhe mbetet ende shumë i vështirë duke qenë se dilemat etike me të cilat përballen individët janë të ndryshme dhe të shumëllojshme. Nga ana tjetër u arrit në përfundimin se pavarësisht se në zhargonin e përditshëm etika dhe morali përdoren si sinonime të njëra-tjetrës, midis tyre qëndrojnë ndryshime të mjaftueshme për të mos lejuar përdorimin dhe konceptimin e këtyre dy termave si sinonime të njëra-tjetrës. Njëkohësisht në këtë kapitull u diskutuan dhe u analizuan modelet më të rëndësishme teorike të vendimmarrjes etike, të cilat janë të aplikueshme në fushën e biznesit në përgjithësi dhe ato që janë të vlefshme në fushën e kontabilitetit në veçanti. Modelet më të rëndësishme, të cilat kanë dominuar kërkimet në lidhje me vendimmarrjen etike, janë modeli i Rest (1986), modeli i Trevino (1986) dhe modeli i Jones (1991). Të trija këto modele do të merren në konsideratë në këtë punim dhe do të shërbejnë si bazë për skeletin teorik në të cilin ky punim do të mbështetet.

KAPITULLI III: ASPEKTE TË MATJES SË FAKTORËVE QË NDIKOJNË PROCESIN E VENDIMMARRJES ETIKE

Ashtu sikurse u përmend edhe në kapitullin e mëparshëm qëllimi i studimit është përcaktimi i ndikimit të disa faktorëve të përzgjedhur në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve shqiptar. Në këtë kapitull do të trajtohen me hollësi të gjithë faktorët, të cilët

do të merren parasysh në këtë studim. Në seksionin e parë bëhet një trajtim i përgjithshëm i këtyre faktorëve duke u mbështetur në rezultatet e studimeve të deritanishme. Në seksionin e dytë analizohen një e nga një të pestë faktorët individualë të marrë në konsideratë. Këta faktorë janë: mosha, gjinia, niveli i edukimit, eksperiencia dhe filozofia personale e moralit. Trajtimi i tyre bëhet fillimisht në aspektin teorik duke analizuar dhe komentuar teoritë, të cilat e mbështesin ndikimin e tyre tek individët gjatë vendimmarrjes etike. Më pas diskutohen rezultatet e arritura nga kërkimet empirike në lidhje me secilin prej tyre. Në seksionin e tretë vazhdohet me faktorët organizativë të marrë në konsideratë, të cilët janë: kodi i etikës, klima etike, madhësia e kompanisë dhe lloji i industrisë. Diskutimi i secilit faktor bëhet në të njëjtën logjikë si në seksionin e mëparshëm, pra fillimisht bëhet trajtimi teorik i tyre dhe më pas kalohet në rezultatet e arritura nga kërkimet empirike të deritanishme. Në seksionin e katërt analizohen dimensionet e intensitetit moral të çështjes etike dhe konkretisht: madhësia e pasojave, konsensusi social dhe shpejtësia e shfaqjes së pasojave. Në seksionin e pestë paraqiten kufizimet e studimeve të mëparshme, të cilat kanë pasur në fokus procesin e vendimmarrjes etike dhe përcaktimin e faktorëve të cilët ndikojnë në këtë proces. Në seksionin e gjashtë paraqitet skeleti teorik i këtij punimi, në bazë të të cilit do të ngrihen edhe hipotezat e punimit. Në seksionin e shtatë jepen konkluzionet e kapitullit.

3.1. Faktorët që ndikojnë vendimmarrjen etike

Sipas literaturës së deritanishme në lidhje me procesin e vendimmarrjes etike individi, i cili merr këtë vendim ndikohet nga një sërë faktorësh, të cilët mund t'i ndajmë në tri grupe: faktorët individualë, të cilët përfshijnë karakteristikat e vetë individit, faktorët organizativë,

të cilët lidhen me mjedisin e punës dhe me vetë organizatën në tërësi në të cilën ushtron profesionin e tij ky individ dhe faktorët që lidhen me çështjen etike me të cilën përballlet individi dhe në lidhje me të cilën duhet të marrë një vendim etik.

Sipas një numri të madh studimesh të kryera është arritur në përfundimin se ekzistojnë më shumë se dyzet faktorë që ndikojnë në këtë proces. Është vënë re që këta faktorë kanë lidhje dhe ndikojnë në katër fazat e procesit të vendimmarrjes.

Gama e faktorëve që ndikojnë vendimmarrjen etike është shumë e gjerë dhe në vijim do të trajtohen vetëm faktorët, të cilët do të jenë në fokus të këtij punimi.

Përsa i përket faktorëve individualë në konsideratë do të merren mosha, gjinia, niveli i edukimit, eksperiencia dhe filozofia e moralit. Në grupin e faktorëve organizativë janë përzgjedhur kodin e etikës, klimën etike, madhësinë e kompanisë dhe llojin e industrisë. Përsa u përket dimensioneve të intensitetit moral që lidhen me çështjen etike do të studiohen madhësia e pasojave, konsensusi social dhe shpejtësia e shfaqjes së pasojave.

Ka disa arsye pse janë zgjedhur për t'u studiuar vetëm këta faktorë nga gjithë ajo gamë e gjerë. Së pari, disa nga këta faktorë, si për shembull mosha, gjinia, kodi i etikës, klima etike, madhësia e pasojave dhe konsensusi social janë faktorët më të përdorur në kërkimet lidhur me etikën e biznesit, gjë që pohohet edhe nga studimi i O'Fallon & Butterfield (2005). Për më tepër pjesa më e madhe e këtyre studimeve lidhur me faktorët e mësipërm janë bërë në vende me ekonomi të zhvilluar ndërkohë që vihet re, të ketë shumë pak studime të këtyre faktorëve në vendet me ekonomi në zhvillim, siç është Shqipëria. Së dyti, pjesa më e madhe e të dhënave lidhur me këta faktorë, është lehtësisht e evidentueshme

nga pjesëmarrësit dhe për këtë arsye ato janë përfshirë në këtë studim. Së treti, janë disa faktorëve, si: lloji i industrisë, niveli i edukimit dhe disa dimensione të intensitetit moral, si shpejtësia e shfaqjes së pasojave, të cilave u është kushtuar shumë pak vëmendje nga kërkuesit e etikës së biznesit në vende të ndryshme. Për këtë arsye gjetjet lidhur me këta faktorë do të shtojnë evidenca të reja në literaturën e etikës së biznesit dhe veçanërisht në lidhje me çështjen e vendimmarrjes etike. Së katërti, besoj se nuk është me interes të studiohen faktorë të tillë, si: kombësia e pjesëmarrësve në studim duke qenë se studimi do të kryhet në Shqipëri, ose studimi i besimit fetar meqenëse pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare është myslimane. Së fundi, studimi i të gjithë faktorëve që lidhen me procesin e vendimmarrjes etike nuk është i lehtë duke qenë se koha dhe buxheti në dispozicion janë të limituar.

Në literaturën e etikës së biznesit janë bërë shumë përmbledhje të studimeve, si: përmbledhja e bërë nga Trevino (2006) apo ajo e bërë nga Wright (1995).

Në punimin tim do të merren në konsideratë vetëm rezultatet e katër përmbledhjeve krahasuese lidhur me vendimmarrjen etike të individëve në literaturën e etikës së biznesit. Këto përmbledhje janë : Ford & Richardson, 1994; Loe et al., 2000; O'Fallon & Butterfield, 2005; Craft, 2013. Këto përmbledhje, të cilat kanë shqyrtuar studime të publikuara në revista të shquara, si: Journal of Business Ethics, Business Ethics Quarterly, Journal Business Research, Business Ethics: A European Review and Journal of Marketing, përfshijnë katërqind e tridhjetë e pesë punime, të cilat kanë studiuar procesin e vendimmarrjes etike dhe faktorët që e ndikojnë atë. Ford & Richardson (1994) ka rishikuar gjashtëdhjetë e dy studime të kryera nga fillimi i vitit 1960 e deri më 1994, Loe et al., 1996

ka rishikuar njëqind e njëzet e katër studime empirike të bëra nga 1994 deri në 1996, O'Fallon & Butterfield (2003) ka rishikuar njëqind e shtatëdhjetë e katër studime empirike të publikuara nga 1997 deri në 2003, ndërsa Craft (2013) ka rishikuar tetëdhjetë e katër studime empirike të publikuara nga viti 2004 deri në 2011. Të katër këto përmbledhje ofrojnë gjetje shumë të dobishme lidhur me faktorët që influencojnë procesin e vendimmarrjes etike.

3.2. Faktorët individualë dhe vendimmarrja etike.

Faktorë të ndryshëm individualë përfshirë këtu karakteristikat demografike, tiparet e personalitetit, besimet, vlerat dhe masat e sjelljes ndaj tyre janë propozuar në literaturën e etikës së biznesit si faktorë, të cilët kanë ndikim në procesin e vendimmarrjes etike. Për më tepër faktorët individualë janë studiuar në fusha të ndryshme, si: marketingu, manaxhimi, kontabiliteti dhe sistemet e informacionit. Gjinia, filozofia personale e moralit, kombësia, edukimi, kultura dhe mosha kanë qenë faktorët më të studiuar, të cilët mund të ndikojnë procesin e vendimmarrjes etike. (O'Fallon & Butterfield, 2005).

Faktorët individualë kanë qenë faktorët më të studiuar në lidhje me vendimmarrjen etike dhe kjo vërtetohet nga fakti që në studimet e përmbledhura nga Craft (2013) gjetjet në lidhje me faktorët individualë përbëjnë 77 % të totalit të gjetjeve të të gjithë punimit (treqind e pesëdhjetë e shtatë në total). Një fakt i tillë vihet re edhe në tri përmbledhjet e mëparshme, konkretisht në përmbledhjen e O'Fallon & Butterfield (2005), gjetjet lidhur me faktorët individualë përbëjnë 75 % të totalit të gjetjeve të punimit, në përmbledhjen e Loe et al. (2000) dhe Ford & Richardson (1994) gjetjet lidhur me faktorët individualë përbëjnë 58 % të totalit të gjetjeve.

Gjithsesi, rezultatet në lidhje me ndikimin e pjesës më të madhe të këtyre faktorëve në procesin e vendimmarrjes etike nuk janë ende përfundimtare. Sipas Nill & Schibrowsky (2005) ndryshimet në dizenjimin e studimeve dhe ndryshimet midis secilës fazë të procesit të vendimmarrjes mund të jetë njëri nga faktorët që i bëjnë këto rezultate jo gjithmonë të sakta.

Trevino (1986) përdori Teorinë e Zhvillimit të Moralit Njohës të Kohlberg për të ndërtuar një teori mbi vendimmarrjen etike, e cila përqëndrohet në karakteristikat e individit që bën vendimmarrjen. Pesë faktorët individualë janë identifikuar të kenë një ndikim në procesin e vendimmarrjes etike: niveli i arsyetimit moral, edukimi, forca e egos, varësia e fushës dhe lokusi i kontrollit (Haines & Leonard, 2007).

Rest et al. (1986) gjithashtu sugjerojnë që faktorët individualë influencojnë marrëdhëniet në katër fazat e procesit të vendimmarrjes (Haines & Leonard, 2007).

Per më tepër, Hunt & Vitell (1986) argumenton që karakteristikat personale influencojnë vendimet etike të individëve.

Sikurse u shpjegua edhe më lart, vetëm pesë faktorë individualë do të jenë në fokus të këtij punimi. Baza teorike dhe empirike e tyre do të analizohet dhe diskutohet për të shqyrtuar dhe kuptuar natyrën e marrëdhënieve të këtyre faktorëve me fazat e procesit të vendimmarrjes etike dhe ndikimin e tyre në secilën nga këto faza. Faktorët individualë të përfshirë në këtë punim janë gjinia, mosha, niveli i edukimit dhe filozofia e moralit personal (idealizmi dhe relativizmi).

Gjinia

Gjinia është faktori individual më i studiuar dhe më i raportuar në studimet empirike të etikës së biznesit nga i gjithë grupi i faktorëve demografikë. Edhe pse është bërë një numër shumë i madh studimesh lidhur me ndikimin e gjinisë në procesin e vendimmarrjes etike përfundimet e tyre janë të ndryshme, shumica e këtyre studimeve kanë zbuluar se femrat janë më etike sesa meshkujt. Këtu mund të përmendim Keller, Smith & Smith (2007), Lund (2008), Oumlil & Balloun (2008), Stedham, Yamamura & Beekun (2007). Ndryshimet në gjini janë diskutuar mjaft edhe nga ana teorike. Qasje të ndryshme janë teorizuar në literaturën e etikës për të gjetur shpjegime racionale të këtyre ndryshimeve. Teoria e Socializimit Gjinor, themelet e së cilës u hodhën nga Teoria e Zhvillimit të Moralit Njohës nga Kohlberg, sugjeron që perspektivat e meshkujve dhe femrave lidhur me çështjet etike zakonisht i atribuohen socializimit të hershëm (Gilligan, 1982). Për më tepër ajo mbështet idenë që meshkujt dhe femrat sjellin grupe të ndryshme vlerash në vendin e punës. Meqenëse meshkujt janë të dhënë pas arritjes së suksesit, ato kanë më shumë gjasa të thyjnë rregullat dhe ligjet, pra të përfshihen në sjellje joetike (Guffey & McCartney, 2007). Nga ana tjetër femrat janë më shumë të shqetësuara për kryerjen mirë të detyrave të tyre dhe në ruajtjen e harmonisë në vendin e punës kështu që, ato kanë më pak gjasa të thyjnë rregullat dhe ligjet dhe si rezultat ka më pak të ngjarë të përfshihen në sjellje joetike. Për këtë arsye meshkujt dhe femrat do të reagojnë në mënyra të ndryshme kur ato përballen me një dilemë etike. Disa studiues argumentojnë që femrat tentojnë të vlerësojnë çështjet etike duke pasur parasysh kujdesin ndaj të tjerëve, duke kuptuar lidhjet dhe përgjegjësinë

ndaj të gjithë komunitetit ndërkohë që meshkujt kanë tendencë t'i perceptojnë çështjet etike nga pikëpamja e rregullave, e të drejtave dhe e drejtësisë.

Teoria Strukturore sugjeron që mjedisi profesional dhe struktura e kostove dhe shpërblimeve brenda vendit të punës do të kapërcejë ndikimin e ndryshimeve gjinore të shkaktuara nga socializimi i hershëm Betz, O'Connell & Shepard (1989). Kështu që si meshkujt ashtu edhe femrat do t'i përgjigjen në mënyrë të njëjtë çështjeve etike brenda vendit të punës Comunale, Sexton & Gara (2006) ; Derry & Green (1989); Reidenbach, Robin & Dawson (1991). Të kuptuarit e ndikimit të gjinisë në procesin e vendimmarrjes etike është shumë i rëndësishëm duke qenë se femrat jo vetëm që janë duke u futur gjithnjë e më shumë në botën e biznesit, por ato kanë arritur dhe po arrijnë gjithnjë e më shumë pozicione të niveleve të larta manaxheriale Nguyen, Basuray, Smith, Kopka & McCulloh (2008). Për këtë arsye mendohet se gjinia mund të ketë një ndikim praktik në vendimmarrjen etike brenda mjedisit të biznesit (Roxas & Stoneback, 2004).

Shumë kërkime janë ndërmarrë lidhur me efektin e gjinisë në procesin e vendimmarrjes etike dhe prej tyre janë marrë rezultate mjaft jokonsistente. Në përmbledhjen e Ford & Richardson (1994) janë raportuar katërmëdhjetë studime empirike në lidhje me marrëdhënien midis gjinisë dhe vendimmarrjes etike, shtatë prej të cilëve zbulojnë se gjinia ka një ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike dhe që femrat kanë gjasa të sillen në mënyrë më etike se meshkujt. Ndër këto studime mund të përmendim Betramini, Peterson & Kozmetsky (1984); Ferrell & Skinner (1988); Ruegger & King (1992) etj. Shtatë studimet e tjera kanë arritur në përfundimin se nuk ka ndryshim midis meshkujve dhe femrave në procesin e vendimmarrjes etike dhe këtu mund të përmendim Callan (1992);

McNichols & Zimmerer (1985) etj. Duhet të theksohet se studimet e bëra në këtë periudhë nuk përcaktojnë se cilën fazë të procesit të vendimmarrjes studiojnë ato.

Tabela 3.1. Përmbledhje e marrëdhënies së gjinisë me procesin e vendimmarrjes etike

Fazat dhe përmbledhjet	Njohja		Gjykimi		Qëllimi		PVE		Totali	
	F>M	JO,PAK	F>M	JO,PAK	F>M	JO,PAK	F>M	JO,PAK	F>M	JO,PAK
		NDR.		NDR.		NDR.		NDR.		NDR.
Craft (2004-2011)	3	3	8	8	9	5	1	1	21	17
O'Fallon & Butterfield (1997-2003)	1	2	13	20	2	2	-	-	16	24
Loe et al. 1994-1996	-	-	-	-	-	-	9	4	9	4
Ford&Richardson (1960-1996)	-	-	-	-	-	-	7	7	7	7
Totali	4	5	21	28	11	7	17	12	53	52

Në përmbledhjen e Loe et al., (2000) shikohet që gjatë periudhës janë bërë trembëdhjetë studime të reja lidhur me rolin e gjinisë në vendimmarrjen etike dhe pjesa më e madhe e rezultateve tregojnë që gjinia ka një lidhje të rëndësishme me procesin e vendimmarrjes etike ose që femrat janë më të ndjeshme ndaj çështjeve etike sesa meshkujt. Këtu mund të përmendim Brady & Wheeler (1996); Galbraith & Stephenson (1993); Serwinek (1992) etj. Gjithashtu studimet e kësaj periudhe nuk përcaktojnë se cilën fazë të procesit të vendimmarrjes marrin në konsideratë.

Në përmbledhjen e O'Fallon & Butterfield (2005) studimet e bëra përcaktojnë se cilën fazë të procesit të vendimmarrjes marrin në studim. Pjesa më e madhe e këtyre studimeve, tridhjetë e tre studime nga dyzet e nëntë në total, ekzaminojnë fazën e gjykimit etik, katër studime ekzaminojnë fazën e qëllimit etik dhe vetëm tri prej tyre ekzaminojnë njohjen etike. Pjesa më e madhe e këtyre studimeve njëzet e katër nga dyzet e nëntë në total kanë arritur në përfundimin se gjinia nuk ka ose ka shumë pak ndikim në procesin e vendimmarrjes etike (Deshpande, 1997 ; Roozen, De Pelsmacker & Bostyn, 2001; Smith & Oakley, 1997), ndërsa pjesa tjetër, pra gjashtëmbëdhjetë nga dyzet e nëntë në total kanë arritur në përfundimin se femrat janë më etike sesa meshkujt dhe këtu mund të përmendim Fleischman & Valentine (2003); Tse & Au (1997). Kjo përmbledhje ka arritur në përfundimin që zakonisht nuk ka ndryshime midis meshkujve dhe femrave, por edhe në ato raste kur ka ndryshim, femrat janë më etike sesa meshkujt.

Në përmbledhjen e Craft (2013) vihet re që pjesa më e madhe e studimeve të bëra gjatë kësaj periudhe janë përqëndruar në fazën e qëllimit etik dhe konkretisht katërmëdhjetë nga tridhjetë e tetë studime në total. Faza e gjykimit etik është ekzaminuar nga tremëdhjetë studime, faza e sjelljes etike nga gjashtë studime dhe faza e njohjes etike nga pesë studime. Femrat duken se sillen në mënyrë më etike sesa meshkujt në dhjetë nga tridhjetë e tetë studime në total, ku mund të përmendim Bampton & MacLagan (2009); Eweje & Brunton, 2010 etj. Gjithashtu është arritur në përfundimin se meshkujt janë më të qëndrueshëm në marrjen e vendimeve etike, janë më strikt kur bëjnë gjykime etike në studimin e bërë nga Marques & Azevedo-Pereira, 2010 dhe në përgjithësi kanë nevojë për më shumë trajnime etike në studimin e bërë nga Herington & Weaven, 2008. Pjesa tjetër e studimeve kanë

arritur në përfundimin se nuk ka ndryshime midis vendimmarrjes etike të meshkujve dhe femrave ku mund të përmendim Sweney & Costello (2009); Chang & Leung (2006) etj.

Sikurse vihet re, në përgjithësi studimet empirike të kryera në vende të ndryshme demonstrojnë se gjinia është një nga faktorët individualë më të studiuar. Edhe pse ka rezultate jo shumë konsistente lidhur me gjininë, studimet e mëparshme kanë arritur në përfundimin se gjinia nuk ka ose ka pak ndikim në procesin e vendimmarrjes etike ose që femrat në disa rrethana sillen në mënyrë më etike sesa meshkujt. Me fjalë të tjera, me përjashtim të studimit të Marques&Azevedo-Pereira (2008), nga të gjitha studimet e tjera del qartë përfundimi se meshkujt nuk janë më etikë sesa femrat.

Mosha

Lidhja e fuqishme midis moshës dhe procesit të vendimmarrjes është shqyrtuar nga shumë kërkues në literaturën e etikës së biznesit. Janë arritur rezultate të ndryshme, disa dëshmojnë se ka një lidhje pozitive dhe të rëndësishme midis moshës dhe procesit të vendimmarrjes etike, ndërsa të tjera nuk gjejnë lidhje të rëndësishme midis tyre. Teoria e Zhvillimit të Moralit Njohës nga Kohlberg sugjeron një ndikim pozitiv të moshës në zhvillimin e moralit dhe individët zakonisht lëvizin nga shkallët e ulëta të arsyetimit moral drejt shkallëve më të larta me rritjen e moshës (Borkowski & Urgas, 1998; Cagle & Baucus, 2006). Kështu individët më të mëdhenj në moshë pritet të ushtrojnë sjellje dhe vlera etike më të larta sesa individët e rinj në rastet kur përballen me situata etike. Çuditërisht kjo nuk është deri diku e vërtetë në literaturën e etikës së biznesit.

Tabela 3.2 Pëmbledhje e marrëdhënies së moshës me procesin e vendimmarrjes etike

Fazat	dhe	Njohja		Gjykimi		Qëllimi		PVE		Totali	
përmbledhjet		LIDH.	JO	LIDH	JO	LIDHJE	JO	LIDHJE	JO	LIDHJE	JO
		E	LIDH.	E	LIDHJE	E	LIDHJE	E	LIDHJE	E	LIDHJE
		RËND.	RËND	RËND.	RËND	RËND.	RËND	RËND.	RËND	RËND.	RËND
Craft (2004-2011)		1	2	3	6	4	3	1	-	9	11
O'Fallon &		1	1	6	4	-	1	-	-	7	6
Butterfield	(1997-										
2003)											
Loe et al. 1994-1996		-	-	-	-	-	-	5	3	5	3
Ford&Richardson		-	-	-	-	-	-	3	5	3	5
(1960-1996)											
Totali		2	3	9	10	4	4	9	8	24	25

Përmbledhja e Ford & Richardson paraqet tetë studime që hetojnë lidhjen midis moshës dhe vendimmarrjes etike. Pesë nga këto studime kanë arritur në përfundimin se mosha nuk ka ose ka pak ndikim në vendimmarrjen etike dhe këtu mund të përmendim Callan (1992) dhe Izraeli (1998), ndërkohë që tre studime paraqesin gjetje të rëndësishme dhe individët më të mëdhenj në moshë ishin më pak etikë vetëm në një studim (Browning & Zabriskie, 1983). Pra sikurse vihet re ekzistojnë rezultate të ndryshme përsa i përket lidhjes së moshës dhe vendimmarrjes etike.

Në përmbledhjen e Loe et al., 2000 paraqiten tetë studime në lidhje me marrëdhënien e moshës dhe moralitetit të individëve, pesë prej të cilave kanë arritur në përfundimin se individët më të mëdhenj në moshë janë më etikë në vendimmarrje sesa individët më të rinj në moshë, ndërsa në tri studimet e tjera nuk janë gjetur lidhje të rëndësishme.

O'Fallon&Butterfield pasqyrojnë trembëdhjetë studime në lidhje me ndikimin e moshës në vendimmarrjen etike. Nga këto studime shtatë prej tyre zbulojnë një lidhje të rëndësishme midis moshës dhe vendimmarrjes etike të individëve dhe këtu mund të përmendim Kim (2003), Singhapaki (1999), ndërsa gjashtë të tjerat kanë arritur në përfundimin se mosha ka pak ose aspak ndikim në vendimmarrjen etike. Këtu mund të përmendim Roozen et al. (2001); Singhapaki, Vitell & Franke (1999). Në këtë përmbledhje janë paraqitur të ndara studimet sipas fazave të procesit të vendimmarrjes etike që ato studiojnë. Lidhur me fazën e njohjes etike janë raportuar dy studime, njëri prej tyre paraqet ekzistencën e një lidhjeje të rëndësishme pozitive midis moshës dhe njohjes etike, ndërsa studimi tjetër nuk ofron ndonjë rezultat të rëndësishëm. Gjykimi etik ekzaminohet nga njëmbëdhjetë studime dhe vetëm në gjashtë prej tyre ofrohen rezultate të rëndësishme, ndërsa në katër studimet e tjera raportohen pak ose aspak rezultate të rëndësishme dhe vetëm një studim (Razzaque & Hwee, 2002) raporton rezultate mikse. Një studim, i cili lidhet me qëllimin etik nuk raporton asnjë marrëdhënie të rëndësishme.

Sipas përmbledhjes së Craft (2013), gjetjet në lidhje me moshën janë prezente në katër fazat e modelit të vendimmarrjes të Rest. Në total nga studimet e bëra gjatë periudhës 2004-2011 ekzistojnë katërmbëdhjetë gjetje, pjesa më e madhe e të cilave lidhen me fazën e gjykimit dhe më konkretisht shtatë prej tyre. Lidhur me fazën e njohjes ekzistojnë katër gjetje, dy gjetje i korrespondojnë fazës së qëllimit dhe vetëm një lidhet me fazën e sjelljes. Valentine dhe Rittenburg (2007) gjetën se gjykimi etik lidhet me rritjen e moshës dhe eksperiencës. Kjo gjetje bie në kundërshtim me studimin e Marques & Azevedo-Pereira (2008), të cilët gjetën se nuk kishte ndryshime të rëndësishme në fazën e gjykimit etik

midis individëve të rinj dhe të vjetër. Forte (2004) gjeti që nuk kishte lidhje të rëndësishme midis moshës së individit dhe aftësisë së gjykimit moral të manaxherit. Në lidhje me fazën e qëllimit Valentine & Rittenburg (2007) gjetën që mosha kishte lidhje me këtë fazë ndërsa Elango et al., 2010 vërejtë që manaxherët më të rinj në moshë kishin më shumë gjasa të influencoheshin nga etika e organizatës sesa manaxherët e vjetër. Gjithsesi manaxherët e vjetër ishin më të prirur për të bërë zgjedhje etike. Krambia-Kapardis & Zopiatis (2008) vërejtën se mosha ishte e lidhur me fazën e njohjes duke qenë se individët mbi tridhjetë vjeç ishin më etikë sesa individët nën tridhjetë vjeç në një studim të perceptimit etik. Chang & Leung (2006) e lidhën moshën me njohjen, ndjeshmërinë etike, ndërkohë që dy studime e përjashtojnë moshën si një faktor që ndikon mbi procesin e vendimmarrjes. Në ndryshim nga gjetjet e mëparshme në lidhje me moshën Eweje & Brunton (2010) nuk arritën në përfundimin se studentët më të mëdhenj në moshë ishin më të orientuar ndaj etikës sesa studentët e rinj dhe Cagle & Bacus (2006) gjetën se mosha dhe niveli i edukimit nuk janë të rëndësishëm në pranimin e sjelljes etike. Sikurse vihet re edhe në këtë përmbledhje edhe në ato të mëparshmet, kategoria e moshës do të vazhdojë të prodhojë rezultate mikse.

Niveli i edukimit

Niveli i edukimit dhe vendimmarrja etike janë studiuar mjaft në literaturën e etikës së biznesit. Në kërkimet e hershme disa studiues si Dubinsky & Ingram (1984); Kidwell, Stevens & Bethke (1987) argumentojnë se nuk vërehet ndonjë ndikim i nivelit të edukimit në vendimmarrjen etike, ndërsa disa të tjerë si Browning & Zabriskie (1983); Rest (1975), argumentojnë se midis këtyre dy faktorëve ekziston një lidhje e fortë. Më parë është gjetur se zhvillimi moral i individit, i cili teorikisht ka një lidhje mjaft të fortë me gjykimin etik,

ndikohet pozitivisht nga niveli i edukimit të individit (Kohlberg, 1981; Rest, 1975). Për më tepër është argumentuar se gjatësia e edukimit formal është një nga faktorët kryesorë të gjykimit etik të individit (Kohlberg, 1981).

Tabela 3.3. Përmbledhje e marrëdhënies së nivelit të edukimit me procesin e vendimmarrjes etike

Fazat dhe përmbledhjet	Njohja		Gjykimi		Qëllimi		PVE		Totali	
	LIDH. E RËND	JO	LIDH. E RËND	JO	LIDH. E RËND	JO	LIDH. E RËND	JO	LIDH. E RËND	JO
Craft (2004-2011)	-	1	2	2	1	1	1	1	4	5
O'Fallon & Butterfield (1997-2003)	1	2	5	2	2	1	-	-	8	5
Loe et al. 1994-1996	-	-	-	-	-	-	-	1	-	1
Ford&Richardson (1960-1996)	-	-	-	-	-	-	3	3	3	3
Totali	1	3	7	4	3	2	4	5	15	14

Përpara viteve '90, kërkimet ende nuk kishin arritur në rezultate të qarta lidhur me ndikimin e nivelit të edukimit në procesin e vendimmarrjes etike. Në përmbledhjen e Ford & Richardson (1994), gjashtë studime ekzaminojnë ndikimin e nivelit të edukimit në vendimmarrjen etike.

Tri studime paraqesin qartë faktin që niveli i edukimit nuk ka ndikim të rëndësishëm mbi procesin e vendimmarrjes dhe këtu mund të përmendim Dubinsky & Ingram (1984), Kidwell et al. (1987), ndërsa tri studimet e tjera paraqesin disa ndryshime statistikore në vendimet etike bazuar në nivelin e edukimit dhe këtu mund të përmendim Browning & Zabriskie (1983), Lane, Schaupp & Parsons (1988).

Pasi eliminoi studimet e përmbledhura më parë nga Ford & Richardson, Loe et al., 2000 në përmbledhjen e tij paraqet vetëm një studim lidhur me nivelin e edukimit sipas të cilit niveli i edukimit nuk e ndikon procesin e vendimmarrjes etike.

Hulumtimet më të fundit paraqesin deri në një farë mase një drejtim tjetër përse i përket ndikimit të nivelit të edukimit në perceptimet etike të vendimmarrësve. Në përmbledhjen e tyre O'Fallon & Butterfield, 2005 raportojnë trembëdhjetë studime që ekzaminojnë ndikimin e nivelit të edukimit në fazat e procesit të vendimmarrjes. Tri nga këto studime investigojnë marrëdhënien midis njohjes etike dhe nivelit të edukimit. Njohja etike nuk influencohet shumë nga niveli i edukimit në dy nga këto studime dhe këtu mund të përmendim studimin e Cohen, Pant & Sharp (2001), i cili ka arritur në përfundimin se nuk ka ndryshime të rëndësishme midis studentëve dhe profesionistëve të kontabilitetit, përse i përket ndjeshmërisë së tyre ndaj çështjeve etike dhe vetëm një studim ka arritur në përfundimin se niveli i edukimit ka ndikim në njohjen etike.

Në këtë përmbledhje raportohen shtatë studime në lidhje me gjykimin etik dhe ndikimin e nivelit të edukimit në të. Pesë nga këto studime demonstrojnë që niveli i edukimit ka një lidhje pozitive me gjykimin etik dhe këtu mund të përmendim Lane et al. (1988), ndërsa dy

studimet e tjera kanë arritur në përfundimin se nuk ekziston një lidhje e rëndësishme midis këtyre dy faktorëve. Qëllimi etik raportohet në tri studime, dy prej të cilave tregojnë që sjellja etike ndikohet pozitivisht nga niveli i edukimit. Studimi i Shafer, Morris & Ketchand (2001) nuk paraqet ndonjë ndikim të rëndësishëm të nivelit të edukimit ndaj qëllimeve. Pjesa më e madhe e studimeve të paraqitura në përmbledhjen e O'Fallon & Butterfield dhe konkretisht dhjetë prej tyre, konkludojnë që ka disa ndikime apo lidhje pozitive midis fazave të procesit të vendimmarrjes etike dhe nivelit të edukimit.

Në përmbledhjen e Craft (2013) sipas studimeve të kryera në këtë periudhë është gjetur se edukimi ka një ndikim pozitiv dhe neutral në vendimmarrjen etike. Gjatë kësaj periudhe shumica e studimeve masin efektin e ndjekjes së kurseve të etikës përsa i përket gjykitimit etik, njohjes ose qëllimit duke përdorur kampione të studentëve në ndjekje të studimeve apo të sapodiplomuar. Kështu, studimet lidhur me nivelin e edukimit nuk u referohen vetëm viteve të edukimit të manaxherëve, por gjithashtu edhe efektit të edukimit në vendimet morale. Në pak studime gjetjet nuk paraqesin ndonjë ndikim të rëndësishëm midis nivelit të edukimit, aftësisë së gjykitimit moral apo standardeve etike dhe këtu mund të përmendim studimin e bërë nga Forte (2004) apo Marques & Azevedo-Pereira (2009).

Awasthi (2008) në studimin e tij gjeti që ndjekja e një kursi etike ndikon drejtpërsëdrejti gjykimin manaxherial, por jo gjykimin moral. Për më tepër studentët që i nënshtroheshin një kursi etike ishin më të prirur të gjykonin një vendim joetik si të keq nga pikëpamja manaxheriale krahasuar me të tjerët. Në lidhje me të mësuarin e etikës, sipas Cagle & Baucus (2008) studimi i skandaleve etike ndikon pozitivisht mbi perceptimet e studentëve ndaj etikës së njerëzve të biznesit.

Megjithëse kërkuesit argumentojnë se niveli i edukimit luan një rol të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike, për fat të keq kërkimet e deritanishme vazhdojnë të prezantojnë rezultate të ndryshme. Gjithsesi mund të konkludohet që kërkimet e deritanishme nuk kanë paraqitur asnjë lidhje negative midis nivelit të edukimit dhe fazave të procesit të vendimmarrjes dhe ndoshta kampionët e studentëve mund të jenë arsyeja e rezultateve të tilla.

Eksperienca

Në mënyrë të ngjashme me faktorët e tjerë individualë, ka pasur disa kërkime në literaturën e etikës së biznesit në lidhje me ndikimin e viteve të eksperiencës së individëve në vendimmarrjen etike të tyre (Bernardi, 1994; Kamel, 2001; Nill & Schibrowsky, 2005). Disa të tjerë mendojnë se kërkimet në lidhje me ndikimin e gjatësisë së eksperiencës në vendimmarrjen etike janë ende të limituara (Bernard & Sweeney, 2010).

Teoria e Kohlberg ofron një strukturë, e cila supozon një lidhje midis viteve të eksperiencës dhe zhvillimit të moralit (Trevino, 1986). Trevino (1986) në studimin e tij pretendon që kjo marrëdhënie siguron mundësi për marrjen e përgjegjësisë për të zgjidhur çështjet etike brenda vendit të punës. Glover, Minnette, Glynda & George (2002) argumentojnë që eksperienca më e madhe mund të shoqërohet me njohje më të mirë të asaj që është e pranueshme nga ana etike. Dawson (1997) gjithashtu propozon që standardet etike ndryshojnë me kalimin e viteve, pra me rritjen e eksperiencës.

Studimet empirike në fushën e etikës së biznesit lidhur me ndikimin e viteve të eksperiencës dhe fazave të procesit të vendimmarrjes etike ofrojnë rezultate të ndryshme.

Në përmbledhjen e Ford & Richardson (1994) në të cilën raportohen katër studime të lidhura me vitet e punësimit arrijnë në përfundimin që studimet empirike ofrojnë rezultate të ndryshme. Dy studime kanë arritur në përfundimin se nuk ka ndonjë lidhje të rëndësishme midis viteve të eksperiencës dhe moralitetit të individit dhe këtu mund të përmendim Dubinsky & Ingram (1984) dhe Serweinek (1992), ndërsa një studim tjetër tregon që individët që kanë më shumë vite eksperiencë tentojnë të shfaqin më tepër pikëpamje etike dhe këtu mund të përmendim Kidwell et al. (1987). Studimi i Callan (1992) nuk zbulon asnjë marrëdhënie midis vlerave etike të individëve dhe viteve të punësimit.

Në përmbledhjen e Loe et al., 2000 raportohen gjithashtu katër studime në lidhje me marrëdhënien e eksperiencës në punë dhe vendimmarrjes etike. Në ngjashmëri me Ford & Richardson, ato arrijnë në rezultate të ndryshme. Në dy studime që ekzaminojnë ndikimin e eksperiencës së punës në vendimmarrjen etike midis drejtuesve dhe studentëve është arritur në përfundimin se drejtuesit janë më etikë sesa studentët, pra del në pah një lidhje pozitive e eksperiencës kundrejt procesit të vendimmarrjes. Ndërsa në dy studimet e tjera nuk gjendet ndonjë lidhje pozitive midis eksperiencës së punës dhe vendimeve etike të individëve.

Në përmbledhjen e O'Fallon & Butterfield (2005) thuhet se eksperiencia lidhet pozitivisht me vendimmarrjen etike. Në këtë përmbledhje raportohen gjithsej dhjetë studime të bëra gjatë kësaj periudhe, të cilat ekzaminojnë lidhjen midis vendimmarrjes etike dhe eksperiencës së individëve. Dy prej tyre, të cilat hetojnë efektin e eksperiencës në njohjen etike dhe konkretisht studimi i Cohen et al. (2001) pohon se individët me më shumë vite

eksperiencë janë më të ndjeshëm nga ana etike, sesa individët që kanë më pak vite eksperiencë, ndërsa studimi i Sparks & Hunt (1998) nuk zbulon ndonjë ndryshim të madh bazuar në vitet e eksperiencës. Gjykimi etik ekzaminohet në pesë studime, dy prej të cilave demonstrojnë një lidhje pozitive midis eksperiencës dhe pikëpamjeve të individëve dhe konkretisht Larkin (2000) dhe Weeks, Moore, McKinney & Longenecker (1999).

Në tre studimet e tjera nuk shikohet ndonjë lidhje e rëndësishme midis këtyre dy faktorëve dhe konkretisht në studimet e Cohen et al. (2001), Reiss & Mitra (1998), Roozen et al. (2001). Vetëm dy studime lidhen me sjelljen etike dhe kanë arritur në përfundimin se midis dy faktorëve ekziston një lidhje e qartë pozitive. Në përgjithësi O'Fallon & Butterfield konkludojnë se eksperiencia e punës është e lidhur pozitivisht me procesin e vendimmarrjes etike në përgjithësi.

Përmbledhja e Craft (2013) arrin në përfundimin se eksperiencia e ndikon procesin e vendimmarrjes etike në mënyra të ndryshme. Së pari, sipas McCullough & Faught (2005) eksperiencia lidhet me tendencën e individit për të qenë më tepër i kujdesshëm moralisht. Së dyti, sipas Valentine & Rittenburg (2007) eksperiencia lidhet me rritjen e gjykimit etik. Së treti, sipas Eweje & Brunton (2010) dhe Valentine & Rittenburg (2007) studentët me më tepër eksperiencë shfaqen më të orientuar nga etika dhe kanë njohje etike më të madhe. Në kundërshtim me sa më sipër, Pierce & Sweeney (2009) në studimin e tyre vënë re që lidhja midis gjatësisë së eksperiencës dhe të qenit etik është më komplekse.

Si përfundim nga të gjitha këto që përmendëm duket qartë se lidhja pozitive midis viteve të eksperiencës dhe vendimmarrjes etike është një gjë që është suportuar vazhdimisht nga

pjesa më e madhe e studimeve të bëra në fushën e etikës së biznesit, duke mbështetur vazhdimisht teorinë e zhvillimit të moralit të Kohlberg.

Filozofia personale e moralit

Filozofia personale e moralit është një faktor tjetër individual që është studiuar fuqimisht në literaturën e etikës së biznesit. Teoricienët e etikës së biznesit janë të një mendjeje që individët brenda organizatës do të implementojnë udhëzime apo rregulla etike bazuar në filozofitë e tyre personale të moralit kur përballen me situata, të cilat kanë përmbajtje etike. Filozofia personale e moralit, në kornizat teorike të literaturës së etikës së biznesit, përshkruhet si një nga faktorët më jetësorë që ndikon procesin e vendimmarrjes etike. Ferrell dhe Gresham (1985) pohon që është e pamundur të zhvillohet një strukturë e vendimmarrjes etike pa vlerësuar standardet etike normative që derivojnë nga filozofia e moralit. Për më tepër, Hunt & Vitell (1986) përfshijnë filozofitë e moralit, deontologjinë dhe teleologjinë, si thelbi i modelit të tyre të procesit të vendimmarrjes. Psikologët socialë gjithashtu kanë marrë në konsideratë filozofitë e moralit si një faktor i rëndësishëm që ndikon vendimet etike të individëve (Singhapaki, Salyachivin, Viarkul & Veerayangkur, 2000).

Filozofitë e moralit u referohen rregullave dhe parimeve të marra në konsideratë nga një individ gjatë marrjes së vendimeve për të ndarë atë që është e keqe nga ajo që është e mirë (Ferrell & Fraedich, 1997). Ky përkufizim përmban tri elemente të rëndësishme: rregullat dhe parimet morale në të cilat mbështetet individi, situata etike me të cilën ato përballen dhe përdorimi i këtyre rregullave dhe parimeve për të bërë dallimin midis së drejtës dhe së

gabuarës. Kërkuesit dhe teoricienët i kanë klasifikuar filozofitë e moralit në disa lloje të ndryshme, si: të drejtat, relativizmi, egoizmi, teoritë e drejtësisë, deontologjia dhe utilitarizmi në përpjekje për të zhvilluar struktura teorike, të cilat të mund të shpjegojnë lidhjen midis filozofive të moralit të individëve dhe vendimeve të tyre lidhur me çështjet etike me të cilat ato përballen.

Kategoria më e zakonshme e filozofive të moralit që është studiuar në fushën e etikës së biznesit është modeli dydimensional i filozofisë personale të moralit i ndërtuar nga Schlenker dhe Forsyth (1977), idealizmi dhe relativizmi. Schlenker dhe Forsyth pohojnë që vendimet etike të individëve mund të shpjegohen duke marrë në konsideratë këto dy dimensione (Marta, Singhapaki, & Kraft 2008; Oumlil & Balloun, 2008)

Marta et al. (2008) pretendon se këto dy dimensione pajtohen lehtësisht me formalizmin dhe utilitarizmin si shprehje personale të filozofive të moralit. Ato argumentojnë se kjo është e qartë nga përkufizimi i Forsyth për këto dimensione, relativizmit në veçanti. Fernando, Dharmage & Almeida (2008) shpjegon se secila nga katër llojet e filozofisë së moralit mund të lidhet me një shkollë të veçantë mendimi. Ato shtojnë që idealizmi i ulët dhe relativizmi i lartë suportojnë një ideologji që lidhet me skepticizmin etik, idealizmi i lartë dhe relativizmi i ulët tentojnë të pajtohen me deontologjinë, idealizmi i ulët dhe relativizmi i ulët janë të pajtueshëm me filozofinë teleologjike etike. Së fundi disa studiues të tjerë argumentojnë që paradigmat deontologjike / teleologjike janë të ngjashme me konceptet e idealizmit dhe relativizmit të teorizura nga Schlenker dhe Forsyth (1977). Në përgjithësi, kërkuesit në fushën e literaturës së etikës së biznesit bien dakord që këto dy dimensione të konceptuara nga Schlenker dhe Forsyth paraqesin llojet kryesore të

filozofive personale të moralit. Për më tepër, Pyetëtori i Pozicionit të Etikës (PPE) i ndërtuar nga Forsyth (1980, 1992) për të matur filozofinë personale të moralit është përdorur shpesh dhe në mënyrë të suksesshme dhe është vlerësuar vazhdimisht nga kërkimet në etikën e biznesit. Ky studim do të adaptojë këto dimensionet për të analizuar lidhjen midis filozofive personale të moralit të kontabilistëve në Shqipëri dhe procesit të tyre të vendimmarrjes.

Forsyth (1980) e përkufizon idealizmin moral si shkallën me të cilën një individ përqëndrohet në drejtësinë e natyrshme ose gabueshmërinë e veprimeve pa marrë parasysh rezultatet e këtyre veprimeve. Ai portretizon një ideologji të bazuar në altruizëm dhe optimizëm dhe përqafon mirëqenien e të tjerëve (Singhapaki et al., 1999). Në marrjen e vendimeve etike, idealistët moralë përdorin më tepër kriteret idealiste sesa ato praktike, individët të cilët kanë idealizëm të lartë besojnë se rezultatet e dëshiruara mund të arrihen dhe se dëmtimi i të tjerëve është universalisht dhe gjithmonë i keq dhe duhet të evitohet (Swaidan, Rawwas, & Al-Khatib, 2004). Ata që janë më pak idealistë besojnë se dëmtimi është ndonjëherë i nevojshëm për të siguruar pasojat më të mira të mundshme për numrin më të madh të mundshëm të individëve, edhe pse kjo mund të jetë e dëmshme për disa grupe të caktuara individësh (Barnett, Bass & Brown, 1994). Forsyth (1988) pohon se vendimet dhe veprimet e idealistëve moralë drejtohen nga parimet morale.

Relativizmi moral përkufizohet nga Forsyth (1988) si hapësira në të cilën individët hedhin poshtë ose nuk pranojnë rregullat ose standardet morale universale. Relativistët supozojnë se rregullat morale janë relative për shoqërinë dhe kulturën në të cilën ato ndodhin

(Schlenker & Forsyth, 1977). Kështu relativistët nuk i pranojnë rregullat dhe kodet universale të moralit në marrjen e vendimmarrjes etike. Individët tej mase relativistë besojnë se rrethanat situacionale përcaktojnë çfarë është e drejtë dhe e gabuar për të gjithë individët e përfshirë në këtë situatë. Kështu që ata mund të mbështeten më tepër në rrethanat sesa në rregullat etike. Përkundrazi, individët që janë pak relativistë besojnë që moraliteti kërkon që të veprohet në mënyra konsistente me parimet, rregullat dhe ligjet e moralit dhe ata respektojnë në mënyrë rigoroze parimet e përgjithshme të moralit (Forsyth, 1992).

Ai i grupon njerëzit në katër grupe në varësi të hapësirës në të cilën ato janë relativistë apo idealistë. Këto katër grupe janë: situacionistët, absolutistët, subjektivistët dhe përjashtuesit.

Situacionistët janë ata individë, të cilët kanë nivel të lartë të idealizmit dhe relativizmit dhe të cilët hedhin poshtë parimet morale universale dhe besojnë që sjelljet e tyre duhet të kryhen për të prodhuar apo siguruar pasoja pozitive.

Subjektivistët kanë nivel të lartë relativizmi dhe nivel të ulët idealizmi dhe kundërshtojnë parimet etike universale dhe besojnë se rezultatet negative jo domosdoshmërisht e klasifikojnë një veprim si jo të moralshëm.

Absolutistët janë ata individë që kanë nivel të lartë idealizmi dhe nivel të ulët relativizmi dhe që besojnë që veprimet e tyre duhet të respektojnë rregullat universale të moralit dhe të prodhojnë pasoja pozitive për të gjithë personat e përfshirë.

Përjashtuesit janë ata individë që kanë shkallë të ulët si të idealizmit ashtu edhe të relativizmit dhe respektojnë parimet universale morale, por nuk besojnë që rezultatet

negative mund të shmangen gjithmonë, çka do të thotë që dëmtimi i dikujt ndonjëherë është i nevojshëm për të siguruar rezultate të mira për të tjerët.

Forsyth (1980,1992) zhvilloi një instrument, Pyetësin e Pozicionit të Etikës, për të matur dimensionet e filozofisë personale të moralit, idealizmin dhe relativizmin. Studime të shumta, të cilat janë bërë për të analizuar filozofitë etike të individëve janë bazuar në modelin e Forsyth dhe këtu mund të përmendim Dubinsky et al., 2004; Lee & Sirgy,1999; Sivadas, Kleiser, Kellaris, & Dahlstrom, 2003 etj. Duke përdorur instrumentin e ndërtuar nga Forsyth, studiuesit kanë analizuar ndikimin e filozofisë morale të individit në fazat e procesit të vendimmarrjes dhe konkretisht njohjen etike (Chan & Leung, 2006), gjykimin etik (Davis et al., 2001, Marques & Azevedo-Pereira, 2008) qëllimin etik (Singh et al.,2007) dhe sjelljen etike (Glover,Bumpus, Logan & Ciesia, 1997).

Kërkuesit kanë demonstruar se filozofia personale e moralit (idealizmi dhe relativizmi) është shumë e rëndësishme në vlerësimin e ndryshimeve morale midis individëve dhe ndikon fort besimin etik dhe perceptimet mbi drejtësinë dhe gabueshmërinë e veprimit në fjalë (Singh et al.,2007).

Për më tepër ndryshimet midis individëve lidhur me idealizmin dhe relativizmin pretendohet të ndikojnë qëllimin e tyre (Forsyth & Pope, 1984). Literatura e etikës së biznesit sugjeron që idealizmi lidhet me etikshmëri më të madhe dhe relativizmi lidhet me etikshmëri të ulët (Swaidan et al.,2004).

Kërkimet e mëparshme të etikës i kanë analizuar filozofitë personale të moralit si një faktor që ka një ndikim të konsiderueshëm mbi vendimet etike dhe kanë paraqitur rezultate

konsistente deri në njëfarë mase. Në përmbledhjen e Ford & Richardson (1994) nuk raportohet asnjë studim që lidhet me ndikimin e idealizmit dhe relativizmit në fazat e procesit të vendimmarrjes. Në përmbledhjen e Loe et al., 2000 raportohet vetëm një studim, që lidhet me këto dimensione, i cili zbulon që filozofitë personale të moralit kanë një ndikim të rëndësishëm në gjykimet etike të pjesëmarrësve dhe në qëllimin e tyre. Gjithsesi Loe et al., 2000 raporton edhe katërmëdhjetë studime të tjera që lidhen me filozofinë personale të moralit dhe procesin e vendimmarrjes. Këto studime i kategorizojnë filozofitë personale të moralit ndryshe nga Forsyth dhe përdorin lloje të tjera instrumentesh siç është për shembull Shkalla Etike Multidimensionale e Reidenbach & Robin (1991). Këto studime tregojnë rezultate të rëndësishme përse i përket lidhjes së filozofive personale të moralit me vendimmarrjen etike. Në fusha të ndryshme, si marketingu, auditimi dhe manaxhimi, pjesa më e madhe e studimeve paraqet rezultate të rëndësishme në lidhje me ndikimin që kanë filozofitë personale të moralit mbi fazat e procesit të vendimmarrjes dhe këtu mund të përmendim: Faedrich & Ferrell, 1992; Mayo & Marks, 1990; Singhapakdi & Vitell, 1993.

Në përmbledhjen e O'Fallon & Butterfield (2005) raportohen tridhjetë e një gjetje lidhur me filozofitë personale të moralit dhe fazave të procesit të vendimmarrjes. Nga këto tetëmbëdhjetë studime përdorin Pyetësin e Pozicionit të Etikës për të analizuar, si idealizmin ashtu edhe relativizmin, ndërsa pjesa tjetër përdor lloje të tjera instrumentesh, si Shkallë Multidimensionale e Etikës. Vihet re që PPE është përdorur më tepër në studimet e etikës së biznesit për të analizuar filozofitë personale të moralit në krahasim me instrumentet e tjera. Sipas dy studimeve (Sparks & Hunt, 1998; Yetmar & Eastman, 2000)

është gjetur që relativizmi lidhet negativisht me njohjen etike. Studimet që marrin në shqytim fazën e gjykimit etik janë njëzet në total, trembëdhjetë prej të cilave përdorin PPE dhe kanë arritur në përfundimin se ka një lidhje të rëndësishme midis këtyre dy faktorëve. Përsa i përket idealizmit është gjetur se ai e ndikon pozitivisht fazën e gjykimit etik në katër studime, ndërsa relativizmi ka një ndikim negativ në fazën e gjykimit etik në pesë studime. Njohja etike ekzaminohet në nëntë studime, pesë prej të cilave përdorin PPE për të analizuar ndikimin e filozofive personale të moralit. Tri prej këtyre studimeve nuk paraqesin të dhëna të rëndësishme përse i përket ndikimit të filozofive personale të moralit në fazën e qëllimit etik dhe këtu mund të përmendim Eastman, Eastman & Tolson, 2001, ndërsa pjesa tjetër nuk raportojnë ndonjë ndikim të rëndësishëm. O'Fallon & Butterfield konkludojnë se idealizmi ndikon pozitivisht fazat e vendimmarrjes etike, ndërsa relativizmi është zakonisht me ndikim negativ në fazat e procesit të vendimmarrjes etike. Për më tepër ata pohojnë se individët idealisë tentojnë të jenë më etikë sesa individët relativist.

Në përmbledhjen e Craft (2013) vihet re se janë bërë gjithsej katërmëdhjetë studime dhe në total prej tyre janë marrë tridhjetë e dy gjetje, prej të cilave katër lidhen me fazën e njohjes etike, pesëmbëdhjetë lidhen me fazën e gjykimit etik, njëmbëdhjetë me fazën e qëllimit dhe vetëm dy në fazën e sjelljes etike. Nga katërmëdhjetë studime në total vetëm pesë prej tyre i kategorizojnë filozofitë e moralit sipas modelit të prezantuar nga Forsyth, rezultatet e të cilave do t'i paraqesim në vijim. Sipas Valentine & Bateman (2011) në lidhje me fazën e njohjes etike është arritur në përfundimin se individët me aspirata për karrierën e tyre në biznes ka më shumë të ngjarë të njohin një çështje etike në kontekstin e shitjeve kur ato përdorin një ideologji etike idealiste. Sipas Chan & Leung (2006) u gjet se orientimi

etik i studentëve të kontabilitetit, në termat e nivelit të tyre të idealizmit dhe relativizmit, duket sikur nuk lidhet shumë me aftësinë e tyre për të njohur çështjet etike në kontekstin profesional. Gjithsesi ata kanë arritur në përfundimin se idealizmi nuk ndikon fuqimisht në ndjeshmërinë etike, pra nuk ka ndonjë ndikim të rëndësishëm në fazën e njohjes etike. Sipas Valentine & Bateman (2011) në fazën e gjykimit etik ekziston një lidhje midis relativizmit etik dhe zgjedhjeve etike. Individët me një orientim më të lartë relativist kanë më shumë shanse të bëjnë zgjedhje joetike, sesa individët me një shkallë më të ulët relativizmi, ndërsa individët më shumë idealistë janë më të prirur të bëjnë zgjedhje etike krahasuar me individët më pak idealistë. Sipas Greenfeld (2008) në fazën e gjykimit etik ekziston një lidhje e rëndësishme midis orientimit etik të individit dhe vendimmarrjes së tij. Sipas Marques & Azevedo-Pereira (2008) në fazën e gjykimit etik: **a)** nuk vërehet ndonjë ndryshim midis kontabilistëve meshkuj dhe kontabilistëve femra në termat e idealizmit apo relativizmit; **b)** niveli i edukimit të të anketuarve nuk lidhet as me idealizmin dhe as me relativizmin; **c)** ndikimi i moshës në të qenit idealistë nuk është i rëndësishëm; **d)** pjesëmarrësit më të vjetër në moshë janë dukshëm më relativistë sesa ato më të rinj; **e)** kontabilistët e rinj besojnë më shumë në parimet morale universale gjatë bërjes së gjykimeve etike sesa ato të reja; **f)** relativizmi ka një efekt më të madh mbi gjykimin etik sesa idealizmi; **g)** kontabilistët me ideologji të ndryshme etike nuk ndryshojnë në termat e gjykimit etik; **h)** ideologjitë etike nuk ndryshojnë midis tyre në termat e gjykimit etik.

Pra, në përfundim mund të themi se kërkimet në lidhje me rolin e filozofive personale të moralit dhe procesit të vendimmarrjes etike vazhdojnë të prodhojnë evidenca pozitive në

lidhje me ndikimin e idealizmit në fazat e procesit të vendimmarrjes dhe evidenca negative në lidhje me ndikimin e relativizmit në fazat e këtij procesi.

3.3. Faktorët organizativë dhe vendimmarrja etike

Literatura e etikës së biznesit ka analizuar vazhdimisht ndikimin e faktorëve organizativë në procesin e vendimmarrjes etike (O'Fallon & Butterfield, 2005). Kërkuesit mbështesin faktin se faktorët organizativë kanë ndikim në vendimmarrjen e punonjësve lidhur me çështjet etike. Faktorët organizativë kanë të bëjnë me të gjithë faktorët që lidhen me vendimmarrësin si individ ose me alternativat e vendimit (Ross & Robertson, 2003). Faktorët organizativë përkufizohen si karakteristikat e sfondit të vendimit, të cilat ndikojnë procesin e vendimmarrjes etike dhe rezultatet e marra prej tij (Ross & Robertson, 2003). Këta faktorë përfshijnë për shembull kodin e etikës, klimën etike të kompanisë, madhësinë e organizatës, manaxhimin e lartë, strukturën organizative, kulturën e organizatës dhe shpërblimet dhe sanksionet. Trevino (1986) arriti në përfundimin se disa faktorë organizativë shpeshherë krijojnë pengesa ndaj vendimeve etike të individëve. Një pjesë e konsiderueshme e literaturës është fokusuar në efektshmërinë e faktorëve në procesin e vendimmarrjes etike, për shembull kodi i etikës (Ampofo et al., 2004; Pflugrath et al., 2007); klima etike (Flannery & May, 2000; Fritzsche, 2000; Vardi, 2001) dhe manaxhimin e lartë (Ferrell & Weaver, 1978; Hian Chye & El'Fred, 2004).

Kodi i etikës dhe klima etike janë kërkuar gjerësisht në fushën e etikës së biznesit për shkak të lidhjes së tyre mjaft të rëndësishme me vendimet etike brenda organizatës. Hulumtimet demonstrojnë rezultate të rëndësishme në lidhje me ndikimin e këtyre faktorëve në

vendimet etike të individëve në fusha të ndryshme, si marketingu, kontabiliteti dhe manaxhimi kryesisht në vendet e zhvilluara. Megjithatë kërkimet në lidhje me etikën kanë qenë shumë të limituara përse i përket fushës së kontabilitetit në përgjithësi dhe faktorëve organizativë në veçanti. Kështu që gjetjet lidhur me këta faktorë do të shtojnë disa evidenca empirike në literaturën e etikës së kontabilitetit në përgjithësi dhe vendimmarrjes etike. Për më tepër, një numër shumë i vogël kërkimesh janë bërë në lidhje me ndikimin e madhësisë së organizatës dhe llojin e industrisë në procesin e vendimmarrjes etike në literaturën e etikës së biznesit (Bernard & Sweeney, 2010; O’Fallon & Butterfield, 2005). Për këtë arsye në këtë studim do të analizohen vetëm këta katër faktorë, të cilët do të diskutohen më hollësisht më poshtë.

Kodi i etikës

Kodi i etikës konsiderohet si një nga mjetet e përdorura më gjerësisht nga organizatat në përpjekje për të drejtuar zgjedhjet e e punonjësve të tyre (Pater & Anita, 2003; Schwartz, 2002). Ai trajton disa çështje të përbashkëta etike me të cilat mund të përballen pjesëtarët e organizatës në vendin e tyre të punës. Kodi i etikës rrit reputacionin e organizatës dhe imazhin e markës (Singh, Carasco, Svensson, Wood & Callaghan, 2005).

Stevens (1994,p.64) e përkufizon kodin e etikës si një dokument të shkruar nëpërmjet të cilit korporatat shpresojnë të modelojnë sjelljet e punonjësve të tyre dhe të prodhojnë ndryshime nëpërmjet bërjes së deklaratave të qarta rreth sjelljeve të dëshiruara.

Gjithashtu, Langlois dhe Schlegelmilch (1990) e përshkruan kodin e etikës si një deklaratë që përcakton parimet e organizatës, etikën, rregullat e sjelljes, kodin e praktikës ose

filozofinë e kompanisë, duke përfshirë përgjegjësitë e punonjësve, aksionerëve, konsumatorëve, mjedisit dhe shoqërisë. Ky përkufizim përcakton qartësisht pjesët kryesore që duhet të përmbajë një kod etike. Arsye të ndryshme i kanë shtyrë organizatat të hartojnë kodet e tyre vetjake të etikës. Presionet e jashtme, si qeveria, publiku, shoqatat profesionale dhe konsumatorët kanë ngritur vazhdimisht shqetësimin ndaj përgjegjësisë së individëve për t'u sjellë në mënyrë etike brenda organizatës.

Përmbajtja e kodit të etikës është e ndryshme dhe ndryshon në varësi të organizatës. Gjithsesi disa çështje etike mund të gjenden përgjithësisht në kodet e etikës së çdo organizate. Hulumtimet tregojnë që zakonisht përmbajtja e kodit të etikës përfshin tri kategori etike, të cilat janë çështjet që lidhen me punonjësit, çështjet që lidhen me organizatën dhe çështjet që lidhen me shoqërinë në tërësi (O'Dwyer & Madden, 2006).

Megjithatë disa hulumtime pretendojnë që kodi i etikës më së shumti fokusohet me çështjet që kanë të bëjnë me sjelljen brenda organizatës (Rodriguez-Domingues, Gallego-Alvarez & Garcia-Sanchez, 2009). Disa studime kanë analizuar përmbajtjen e kodit të etikës, ndërsa disa të tjera kanë hetuar nëse organizata ka ose jo kod etike dhe deri në çfarë mase ato janë efektive. Edhe pse diskutimi dhe analizimi i përmbajtjes së kodit të etikës është frytdhënës, ky aspekt nuk përbën qëllimin e studimit tim. Në këtë punim unë synoj të analizoj ndikimin e prezencës së kodit të etikës në fazat e procesit të vendimmarrjes etike.

Shumë punime kanë analizuar rolin e kodit të etikës brenda organizatës në literaturën e etikës së biznesit dhe kanë arritur në rezultate interesante (Boo & Koh, 2001; Pater & Anita, 2003). Ekzistenca e kodeve të etikës sipas studimeve të bëra ndikon pozitivisht mbi

sjelljen etike brenda organizatës (Singh et al., 2005; Wotruba, Chonko, & Loe, 2001). Megjithatë argumentohet që kodi i etikës mund të mos jetë i mjaftueshëm në vetvete për të siguruar që individët brenda organizatës të marrin vendime etike gjatë ballafaqimit me shumë situata etike (Cleek & Leonardo, 1998).

Komunikimi i kodit të etikës të gjithë pjesëtarët e organizatës dhe zbatimi i tij brenda organizatës mund të jetë një arsye për ta bërë atë mjaftueshmërisht të efektshëm (Chia-Mei, Chin-Yuan, 2006; Cleek & Leonard, 1998; McClaren, 2000). Një arsye tjetër është që përmbajtja e kodit të etikës në vetvete nuk mund të jetë mjaftueshmërisht e kuptueshme në mënyrë që të ketë ndikimin e duhur në vendimet etike të individëve.

Në përmbledhjen e O'Fallon & Butterfield (1994) raportohen nëntë studime dhe më shumë se gjysma e tyre janë bërë në fushën e marketingut. Autorët kanë arritur në përfundimin se prezenca e kodit të etikës brenda organizatës lidhet pozitivisht dhe fuqimisht me vendimmarrjen etike.

Tabela 2.4. Përmbledhje e marrëdhënies së kodit të etikës me procesin e vendimmarrjes etike

Fazat dhe përmbledhjet	Njohja		Gjykimi		Qëllimi		PVE		Totali	
	LIDHJ	JO	LIDHJE	JO	LIDHJE	JO	LIDHJE	JO	LIDHJE	JO
E	LIDHJ		RËND	LIDHJ	RËND	LIDHJ	E	LIDHJ	RËND	LIDHJE
RËND	E			E		E	RËND	E		RËND
		RËND		RËND		RËND		RËND		
Craft (2004-2011)	-	-	1	1	1	1	-	-	2	2

O'Fallon & Butterfield (1997-2003)	1	-	2	3	1	1	-	-	4	4
Loe et al. 1994-1996	-	-	-	-	-	-	10	4	10	4
Ford&Richardson (1960-1996)	-	-	-	-	-	-	6	3	6	3
Totali	1	-	3	4	2	2	16	7	22	13

Në përmbledhjen e Loe et al., 2000 raportohen katërmëdhjetë studime, të cilat lidhen me rolin e kodit të etikës në vendimet etike të individëve. Në ngjashmëri me përmbledhjen e Ford dhe Richardson, pjesa më e madhe e këtyre studimeve dhe konkretisht dhjetë prej tyre kanë arritur në rezultatin se kodi i etikës ka një lidhje të rëndësishme pozitive me vendimmarrjen etike dhe këtu mund të përmendim Barnett, Cochran & Taylor, (1993); Kaye, (1992). Pjesa tjetër e studimeve nuk raportojnë ndonjë lidhje të rëndësishme midis kodit të etikës dhe procesit të vendimmarrjes etike dhe këtu mund të përmendim Ferrell & Weaver, (1978); Kohut & Corriher, (1994).

Në përmbledhjen e O'Fallon & Butterfield (2005) raportohen tetë studime që lidhen me ndikimin e kodit të etikës në fazat e procesit të vendimmarrjes etike. Një studim analizon fazën e njohjes etike dhe zbulon rezultate të rëndësishme pozitive dhe konkretisht ky është studimi i bërë nga Weaver, Trevino dhe Cochran (1999). Faza e gjykimit etik analizohet nga pesë studime dhe në tri prej tyre nuk gjenden lidhje të rëndësishme midis dy faktorëve, ndërsa në dy studimet e tjera të bëra nga Adams, Tashchian dhe Shore (2001) dhe Stohs & Brannick (1999). Gjatë kësaj periudhe dy studime kanë analizuar fazën e qëllimit etik dhe vetëm njëri prej tyre ka gjetur një lidhje pozitive midis dy faktorëve.

Në përmbledhjen e Craft (2013) vihet re se gjatë periudhës 2004-2011 numri i kërkimeve në lidhje me analizimin e ndikimit që ka kodi i etikës në procesin e vendimmarrjes etike ka rënë në mënyrë të ndjeshme. Përsa i përket fazës së njohjes etike gjatë kësaj përiudhe janë bërë vetëm tri kërkime dhe secili prej tyre ka rezultuar me një gjetje të vetme. Konkretisht studimi i Deshpande (2009) ka arritur në përfundimin se përveç kodit të etikës, është shumë e rëndësishme që organizata të ketë të implementuar një proces, i cili të sigurojë që punonjësit e organizatës gjatë procesit të vendimmarrjes etike të kenë parasysh edhe konsideratat etike të organizatës. Studimi tjetër lidhur me këtë fazë është bërë nga O’Leary & Stewart (2007) sipas të cilit ekzistenca e një kodi të fortë etike nuk i ndihmon audituesit e brendshëm të sillen në mënyrë më etike kur përballen me një dilemë etike. Studimi i tretë është bërë nga Rotting et al., 2011 dhe sipas këtij studimi fjalët, pra kodi i etikës dhe ai i sjelljes nuk janë të mjaftueshëm për të ndikuar vetëdijen morale të punonjësve. Faza e gjykitimit moral është analizuar në dy studime gjatë kësaj periudhe përsa i përket ndikimit të kodit të etikës në të. Studimi i parë është bërë nga Pflughrath et al., 2007 dhe në të është arritur në përfundimin se prezenca e etikës duket se ka një ndikim më të madh në gjykimet e kontabilistëve profesionistë, sesa te studentët e kontabilitetit. Studimi i dytë është ai i bërë nga McKinney et al., 2010 dhe në të është arritur në përfundimin se profesionistët e biznesit, të cilët punojnë në organizata të cilat kanë të implementuar një kod etike të shkruar, kanë tendencë t’i shikojnë situatat e diskutueshme etike si më pak të pranueshme sesa ata që punojnë në organizata që nuk kanë të implementuar një kod etike.

Sikurse vihet re, numri i studimeve që lidhen me marrëdhënien midis tri fazave të para të vendimmarrjes etike dhe ekzistencës së kodit të etikës ka qenë në rënie. Si përfundim mund të themi se në gamën e këtyre studimeve vihet re se është arritur në rezultate të ndryshme, por duhet theksuar se pjesa më e madhe e tyre përkrahin idenë se ekzistenca e kodit të etikës lidhet pozitivisht me vendimmarrjen etike.

Klima etike

Mjedisi i organizatës në fushën e etikës së biznesit është analizuar për më shumë se tri dekada. Ferrell & Weaver (1978) kanë analizuar marrëdhënien midis individëve, pjesëmarrësve dhe manaxhimit të lartë. Schneider (1975) raporton disa gjetje të rëndësishme në lidhje me klimën etike të organizatave. Ford, Gray & Landrum (1982) studiuuan efektin e kodit të sjelljes në sjelljen etike të punonjësve. DeConinck & Lewis (1997) analizuan sesi reagonin manaxherët e shitjes ndaj veprimeve etike dhe joetike të shitësve të tyre. David (2000) analizoi efektin e klimës etike në dimensionet e vendimeve etike. Këto studime dhe disa studime empirike të kohëve të fundit, të cilat janë përmbledhur nga disa studiues sugjerojnë se mjedisi i organizatës ndikon në vendimmarrjen etike të individëve.

Klima etike është një nga faktorët organizativë më të rëndësishëm, i cili duket se ka një ndikim të rëndësishëm në vendimet etike të punonjësve në vendin e tyre të punës. Victor & Cullen (1988) e përkufizon klimën etike si “perceptimin kryesor të praktikave dhe procedurave tipike të organizatës, të cilat kanë përmbajtje etike”. Ata argumentojnë se klima etike në mjedisin e punës është burimi kryesor për informimin e punonjësve mbi

veprimet e drejta ose etike në organizatë. Martin & Cullen (2006) shtojnë se klima etike mund të kuptohet si tërësia e procedurave, politikave dhe praktikave të përbashkëta, si formale ashtu edhe informale, brenda organizatës.

Duke përdorur teoritë e filozofisë së moralit dhe psikologjisë së moralit, Victor & Cullen (1987) hartuan Pyetësin e Klimës Etike për të identifikuar klimën etike të organizatës apo grupit. Pyetësi i Klimës Etike (PKE) analizon perceptimet e individëve brenda organizatës në lidhje me mënyrën si pjesëtarët e organizatës veprojnë në lidhje me çështjet etike me të cilat ato përballen. PKE specifikon disa ngjarje, praktika dhe procedura të nevojshme për vendosjen e kriterëve etike për vendimmarrje.

Victor & Cullen (1988) teorizojnë që klima etike brenda organizatës ndryshon në dy dimensione: tri klasave të teorisë etike dhe tri niveleve të grupeve të referencës. Nga kombinimi i këtyre dy dimensioneve rezultojnë nëntë lloje të klimës etike. Ky model është përdorur nga një numër mjaft i madh studimesh dhe deri më tani është vlerësuar si kuadri më i kompletuar. Victor & Cullen kanë ndërmarrë disa studime për të vlerësuar këtë konstrukt dhe kanë gjetur se të nëntë llojet e klimës etike ekzistojnë. Pas bërjes së një testi tjetër të rëndësishëm, ata i reduktuan nëntë llojet në pesë të tillë. Studimet e mëparshme i kanë mbështetur empirikisht disa nga këto dimensione (Trevino, Butterfield & McCabe, 1998). Edhe pse të gjitha dimensionet e klimës etike janë përdorur në shumë studime empirike, disa prej këtyre studimeve kanë përdorur vetëm disa prej këtyre dimensioneve për të identifikuar klimën etike brenda organizatës (Kincaid, 2003). Ndikimi i klimës etike brenda organizatës në procesin e vendimmarrjes etike është hetuar një numër i

konsiderueshëm studimesh, të cilat sigurojnë rezultate të rëndësishme (Martin & Cullen, 2006; VanSandt et al., 2006)

Trevino et al., 1998 argumenton se evidencat e kërkimeve të mëparshme propozojnë se duhet të përdoren një numër më i vogël i dimensioneve etike për të shpjeguar disa karakteristika të kontekstit etik brenda organizatës. Për më tepër Peterson (2002) argumenton se deri më tani nuk ka asnjë kërkim, i cili demonstroi se të nëntë llojet e klimës etike ekzistojnë nëpër organizata.

Në studimin tim mendoj të hetoj apo të analizoj tri lloje të klimës etike brenda organizatës dhe konkretisht interesin e organizatës, përgjegjësinë sociale, ligjet dhe kodin profesional. Arsyeja e zgjedhjes së këtyre tri dimensioneve është së pari fakti që këto lloje kanë qenë më të studiuarat në studimet e mëparshme empirike dhe nisur nga kjo mendoj se do të gjenden edhe në kompanitë shqiptare.

Edhe pse janë bërë një numër i madh studimesh në lidhje me klimën etike, ka akoma pak literaturë përsa i përket lidhjes së këtyre faktorëve me fazat e procesit të vendimmarrjes (Martin & Cullen, 2006). Përmbledhjet e bëra deri më tani na japin rezultate të rëndësishme në lidhje me marrëdhënien midis klimës etike dhe fazave të procesit të vendimmarrjes. Në përmbledhjen e Ford dhe Richardson nuk raportohet asnjë studim në lidhje me marrëdhënien e këtyre dy faktorëve. Në përmbledhjen e Loe et al., 2000 raportohen katër studime në lidhje me këtë çështje. Tri nga këto studime tregojnë që klima etike lidhet fuqishëm me vendimmarrjen etike dhe këtu mund të përmendim Schwepker, Ferrell &

Ingram, 1997; Verbeke, Ouwerkerk & Peelen, 1996. Një studim nga Elm & Nichols (1993) pohon se klima etike nuk ka asnjë lidhje me fazat e procesit të vendimmarrjes.

Në përmbledhjen e O'Fallon & Butterfield (2005) raportojnë pesëmbëdhjetë studime që lidhen me ndikimin e klimës etike në fazat e procesit të vendimmarrjes, për shembull rezultatet e Sparks & Hunt (1998) zbulon që dimensionet e klimës etike të dashamirësisë dhe parimeve lidhen me një nivel të lartë të njohjes, ndërsa kriteri etik i egoizmit lidhet me nivele më të ulëta të njohjes etike. Përsa i përket gjykimit etik, katër studime raportojnë disa lidhje të rëndësishme midis klimës etike dhe gjykimit etik. Klima etike ndikon pozitivisht (Verbeke et al., 1996) dhe fuqimisht (Singhapaki, Karande, Rao & Vitell, 2001) gjykimin etik. Klima etike dashamirëse dhe ajo instrumentale janë llojet e klimave dominuese në procesin e vendimmarrjes etike (Upchurch, 1998; Weber & Seger, 2002). Qëllimi etik raportohet nga katër studime dhe në njërin prej tyre nuk zbulohet ndonjë lidhje e rëndësishme, ndërsa në tri studimet e tjera del qartë ekzistenca e një lidhjeje të rëndësishme midis qëllimit etik dhe klimës etike të organizatës dhe këtu mund të përmendim studimin e bërë nga Barnett dhe Vaicys, 2000; Flannery & May, 2000 etj. O'Fallon dhe Butterfield konkludojnë se ka një rritje në mbështetjen e idesë se dimensionet e klimës etike kanë një ndikim të rëndësishëm në fazat e procesit të vendimmarrjes etike.

Në përmbledhjen e Craft (2013) vihet re që gjatë periudhës 2004-2011 janë bërë gjithsej dhjetë studime në lidhje me këtë çështje dhe konkretisht dy prej tyre lidhen me fazën e njohjes etike, katër me gjykimin etik dhe katër me qëllimin etik. Vlen të përmendet këtu kërkimi i bërë nga Forte et al., 2004, i cili arriti në përfundimin se ekziston një lidhje e rëndësishme statistikore midis niveleve të manaxhimit dhe klimës etike të organizatës.

Madhësia e organizatës dhe lloji i industrisë

Madhësia dhe lloji i organizatës janë një tjetër faktor nga grupi i karakteristikave të organizatës, i cili ndikon procesin e vendimmarrjes etike të punonjësve të saj. Disa kërkues (Weber, 1990; Weber & Seger, 2002) kanë arritur në përfundimin që madhësia e organizatës ka një influencë në vendimmarrjen e individëve brenda saj. Ndryshimet në mjedisin e punës midis organizatave të vogla dhe atyre të mëdha janë të pranishme sipas Appelbaum et al., 2005.

Appelbaum et al., 2005 vë në dukje që organizatat e mëdha kanë benefite nga përdorimi i mekanizmave suportues, të cilët nuk përdoren në organizatat e vogla në rastet kur është e nevojshme të merren vendime etike. Vitell & Festervand (1987) sugjerojnë se organizatat e vogla mund të jenë të detyruara për t'u përfshirë në sjellje joetike me qëllim që të konkurrojnë me organizatat e mëdha.

Lloji i industrisë mendohet të ketë një ndikim në sjelljen etike individuale (Oz, 2001). Individët, të cilët punojnë në një vend ku prodhohen produkte të rrezikshme, për shembull lëndë narkotike, mund të jenë më të ndjeshëm ndaj çështjeve etike sesa individët, të cilët punojnë për kompani, të cilat prodhojnë produkte të sigurta si mobiljet.

Gjithsesi kërkimet kanë dëshmuar një realitet ndryshe. Ford & Richardson (1994) raportojnë tri studime në lidhje me efektin e madhësisë së organizatës dhe vendimmarrjes etike dhe tri studime që analizojnë marrëdhënien midis llojit të organizatës dhe vendimmarrjes etike. Është interesant fakti se ato kanë arritur në përfundimin se madhësia e organizatës ndikon negativisht procesin e vendimmarrjes etike të individëve në tri prej

këtyre studimeve. Njëri prej tyre për shembull konkludon që individët, të cilët punojnë për organizata të mëdha ka më shumë gjasa të pranojnë rryshfete dhe favore prej klientëve të tyre. Ndërsa përsa i përket llojit të industrisë, tri studime arrijnë në përfundimin se nuk ka ndryshime midis pjesëmarrësve në studim përsa i përket vendimeve të tyre etike. Ford dhe Richardson pohojnë se ekziston një marrëdhënie midis madhësisë së organizatës dhe procesit të vendimmarrjes etike të individëve të saj dhe konkretisht me rritjen e madhësisë së organizatës ulet sjellja etike e punonjësve të saj.

Ndërkohë Loe et al., 2000 nuk raporton asnjë studim të bërë gjatë periudhës. O'Fallon & Butterfield (2005) raportojnë pesë studime në lidhje me madhësinë e organizatës dhe tetë studime në lidhje me llojin e industrisë. Madhësia e organizatës, sipas pesë studimeve, nuk ka një ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike. Nuk ka asnjë studim që dëshmon se madhësia e organizatës nuk ka ndikim të rëndësishëm në njohjen etike. Ndërsa në lidhje me gjykimin dhe qëllimin etik ka disa studime që dëshmojnë se ndikimi i tyre nuk është i rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike (Razzaque & Hwee, 2002; Roozen et al., 2001; Shafer et al., 2001; Paolillo & Vitell, 2002). Përsa i përket marrëdhënies midis llojit të industrisë dhe procesit të vendimmarrjes etike të individit, gjykimi etik ka një marrëdhënie të rëndësishme me llojin e industrisë në pesë studime (Ergeneli & Arikan, 2002; Latif, 2000; Roozen et al., 2001). Vetëm studimi i Shafer et al., 2001 nuk ka arritur në përfundime të rëndësishme lidhur me ndikimin e llojit të industrisë në gjykimin etik. Lloji i industrisë nuk ka ndikim të rëndësishëm në fazën e qëllimit etik (Shafer, 2007).

Craft (2013) raporton vetëm tri studime në lidhje me efektin e madhësisë së organizatës në procesin e vendimmarrjes etike. Të gjitha këto studime pohojnë se qëllimi etik ndikohet pozitivisht nga madhësia e organizatës (Bernard & Sweeney, 2010; Marta, Singhapaki et al., 2008; Schminke, 2001), ndërsa gjykimi etik merret në konsideratë vetëm nga një studim, i cili ka arritur në përfundimin se ekziston një lidhje pozitive midis këtyre dy komponentëve (Bernard & Sweeney, 2010). Gjithashtu janë bërë dy studime përse i përket ndikimit të llojit të industrisë dhe procesit të vendimmarrjes etike dhe sipas tyre ky komponent ndikon fuqimisht, individët gjatë marrjes së vendimeve etike (Krambia-Kapardis & Zopiatis, 2008; Shafer, 2007).

Sikurse vihet re literatura e etikës së biznesit vazhdon të prodhojë rezultate mikse dhe jo konsistente, përse i përket ndikimit të madhësisë së organizatës në vendimmarrjen etike. Ndërkohë që kërkimet e hershme empirike nuk dëshmojnë për rezultate të rëndësishme, kërkimet e kohëve të fundit dëshmojnë për lidhje të rëndësishme midis faktorëve.

3.4.Dimensionet e intensitetit moral të çështjes etike dhe procesi i vendimmarrjes etike

Përpara vitit 1991, kërkimet në etikën e biznesit ishin të fokusuara më së shumti në një sërë faktorësh individualë dhe organizativë, të cilët ndikonin në procesin e vendimmarrjes etike .

Në vitin 1991, Jones ishte i pari që vuri theksin te karakteristikat e çështjes etike në vetvete duke qenë se modele të ndryshme të procesit të vendimmarrjes etike (Trevino, 1986;

Rest,1986; Ferrell & Gresham,1985) kishin nxjerrë në pah vetëm faktorët individualë dhe ato organizativë si influences të këtij procesi. Ai argumenton se këto modele nuk marrin në konsideratë ndryshimet midis çështjeve apo dilemave etike, sipas tyre çështja e keqpërdorimit të një paisjeje të kompanisë është e njëjtë me çështjen e hedhjes në treg të një produkti të rrezikshëm (McMahon & Harvey, 2007). Jones (1991) përdori modelin e ndërtuar nga Rest (1986) në lidhje me procesin e vendimmarrjes etike për të ndërtuar modelin e tij, të cilin e quajti intensiteti moral. Jones (1991) pohon që themelet e këtij modeli gjenden në teorinë e filozofisë së moralit. Intensiteti moral është konceptuar si një model që ka disa dimensionet dhe që lidhet me çështjen etike në vetvete, por jo me cilësitë individuale apo me situatën në të cilën gjendet një individ kur i duhet të marrë një vendim etik (Barnett, 2001). Si i tillë, intensiteti moral ndryshon në funksion të çështjes etike. Çështjet me intensitet të lartë moral të bëjnë të mendosh së veprimi i marrë në lidhje me të do të jetë më tepër imoral, sesa ai që merret në lidhje me një çështje me intensitet të ulët moral (Guffey & McCartney, 2007).

Bazuar në modelin e Rest, Jones (1991) solli për herë të parë konceptin e intensitetit moral, i cili përbëhet nga gjashtë komponentë:

1. madhësia e pasojave: shuma e dëmit apo përfitimit që shkakton një veprim i moralshëm ndaj personave të përfshirë në të.
2. konsensusi social: shkalla e pranueshmërisë sociale nëse një veprim i caktuar është i mirë ose i keq.
3. probabiliteti i efektit: probabiliteti që një veprim i caktuar do të ndërmerret dhe do të dëmtojë/shpërblejë personat e përfshirë në të.

4. shpejtësia e shfaqjes së pasojave: kohëzgjatja midis të tashmes dhe shfaqjes së pasojave të vendimit të marrë.

5. afërsia: ndjenja e menjëhershme e personave të përfshirë.

6. përqëndrimi i efektit: fortësia e pasojave ndaj personave të përfshirë.

Këta komponentë konsiderohen nga Jones si faktorë të pavarur të cilët kanë një ndikim të rëndësishëm në secilën fazë të procesit të vendimmarrjes etike (Singh et al.,2007). Kërkimet dëshmojnë se ndikimi i këtyre komponentëve në njohjen, gjykimin dhe qëllimin etik është pozitiv dhe i rëndësishëm (Frey,2000; May & Pauli, 2002; Singhapaki et al.,1999; Singhapaki et al.,1996).

Secili nga komponentët e intensitetit moral është investiguar në lidhje me një ose më shumë faza të procesit të vendimmarrjes etike. Gjithashtu kërkuesit kanë ekzaminuar ose të gjitha dimensionet njëherësh ose janë fokusuar në një ose dy prej tyre (Ballantine,2002). Studimi im do të ketë në fokus vetëm ndikimin e tri dimensioneve të intensitetit moral, të madhësisë së pasojave, konsensusit social dhe shpejtësia e shfaqjes së pasojave, në procesin e vendimmarrjes etike. Madhësia e pasojave dhe konsensusi social janë hetuar nga një sërë kërkimesh empirike të etikës në fusha të ndryshme, si marketingu, manaxhimi dhe auditimi veçanërisht në vendet perëndimore. Besoj se studimi im do të sjellë evidenca të reja në lidhje me ndikimin e këtyre komponentëve në vendimmarrjen etike të kontabilistëve në një nga vendet në zhvillim, siç është edhe vendi ynë, Shqipëria. Për më tepër, kërkimet në lidhje me ndikimin e shpejtësisë së shfaqjes së pasojave në vendimmarrjen etike kanë qenë tepër të limituara. Kërkuesit vazhdimisht kanë bërë thirrje për më tepër kërkime në lidhje

me këtë dimension (O’Fallon & Butterfield, 2005). Për këtë arsye ky dimension do të jetë në fokus të punimit tim.

Madhësia e pasojave

Madhësia e pasojave, ashtu sikurse e përmenda edhe më sipër, ka të bëjë me shumën e dëmit apo përfitimet që rezulton nga një veprim i caktuar (Jones,1991). Pra, individët do të bëjnë vendimet e tyre etike duke marrë në konsideratë rezultatet e tij më tepër sesa moralitetin e sjelljes në vetvete. Për shembull, një sjellje që dëmton pesëqind persona paraqitet me intensitet moral më të madh, sesa një sjellje që dëmton vetëm pesë persona dhe një sjellje që shkakton vdekjen është me intensitet moral më të madh, sesa një sjellje që shkakton dëmtime të vogla (Jones,1991). Barnett & Valentine (2004) shpjegojnë se, në qoftë se një veprim perceptohet se shkakton më shumë pasoja serioze, ky veprim duhet të konsiderohet si një veprim me intensitet të lartë moral sesa një veprim me më pak pasoja serioze.

E parë kjo, në këndvështrimin e të bërit biznes, punonjësit e një kompanie mund të mos e marrin në konsideratë vjedhjen e një sasive të vogël parash nga kompania për përdorim vetjak si një veprim me intensitet të lartë moral.

Përsa i përket marrëdhënies së këtij dimensionit me fazat e procesit të vendimmarrjes etike mund të themi që kjo marrëdhënie ka qenë në mënyrë të vazhdueshme e rëndësishme nga ana statistikore (Mencl & May, 2009). Ata pohojnë gjithashtu se me rritjen e ashpërsisë së dëmit, individët ka më shumë gjasa që të njohin implikimet etike të situatës, të angazhohen në një masë më të madhe në vlerësime morale dhe të formojnë më tepër qëllime etike.

Konsensusi social

Jones (1991) e përkufizon konsensusin social si shkallën e pranueshmërisë sociale në lidhje me një veprim të caktuar si të mirë ose të keq. Ai argumenton se individët mbështeten te rregullat dhe normat sociale për të ulur dykuptimësinë e kur përballen me një çështje etike. Si pasojë, kjo do të ndikojë pikëpamjet e tyre në lidhje me të mirat e një sërë veprimeve. Chia & Lim (2000) pretendojnë se konsensusi social ul dykuptimësinë dhe rrit njohjen, gjykimin, qëllimin dhe sjelljen etike. Normat sociale, parimet dhe zakonet personale së bashku mund të krijojnë konventat e adaptuara nga individët në një shoqëri të caktuar. Këto konventa përfaqësojnë konsensusin social mbi veprimin e drejtë (Chia & Lim, 2000). Pra, intensiteti i moralit ullet, nëse shoqëria e pranon një veprim të caktuar si etik dhe anasjelltas, intensiteti i moralit rritet nëse shoqëria nuk e pranon një veprim të caktuar si etik. Kërkimet e mëparshme kanë gjetur se si madhësia e pasojave ashtu edhe konsensusi social janë kontribuesit më të rëndësishëm për të shpjeguar procesin e vendimmarrjes etike të një individi (Ng, White, Lee & Moneta, 2009)

Shpejtësia e shfaqjes së pasojave

Përkufizohet nga Jones (1991) si “gjatësia e kohës midis të tashmes dhe lindjes ose fillimit të pasojave të një veprimi etik të caktuar”. Ai beson se sa më e gjatë është koha deri në marrjen e pasojave, aq më i vogël perceptohet të jetë dëmi i ardhshëm nga sjellje joetike nga individët. Pra, nëse pasojat e një veprimi të caktuar do të ndjehen shumë kohë më pas, aq më i vogël do të konsiderohet intensiteti i moralit të këtij veprimi në të tashmen. Në të kundërt, nëse individët janë koshientë se pasojat e një veprimi do të ndjehen shumë shpejt

pas ndodhjes së tij atëherë aq më i madh do të jetë intensiteti moral i tij. Kërkimet e mëparshme kanë siguruar rezultate të limituara dhe jokonsistente në lidhje me këtë dimension (O'Fallon & Butterfield, 2005).

Kërkimet e mëparshme në lidhje me ndikimin e dimensioneve të intensitetit të moralit në procesin e vendimmarrjes etike kanë nxjerrë rezultate jokonsistente. Ndërsa Ford & Richardson (1994) nuk raportojnë asnjë studim në lidhje me intensitetin e moralit, Loe et al., 2000 raportojnë vetëm dy studime, të cilat mbështesin faktin se dimensionet e intensitetit moral e ndikojnë procesin e vendimmarrjes etike (Robin, Reidenbach & Forrest, 1996; Singhapakdi et al., 1996).

Që prej vitit 1990, intensiteti moral i është kushtuar një rëndësi e madhe nga ana e kërkuesve. Njëzet e tetë studime në lidhje me tri fazat e para të procesit të vendimmarrjes etike raportohen në përmbledhjen e O'Fallon & Butterfield (2005). Prej tyre gjashtë studime hetojnë marrëdhënien midis njohjes etike dhe intensitetit moral. Katër prej këtyre studimeve kanë arritur në përfundimin se intensiteti i moralit ka një ndikim të rëndësishëm në njohjen etike. Studimet e kësaj periudhe pjesërisht saktësojnë se cilin komponent të intensitetit moral kanë marrë në shqyrtim. Përsa i përket madhësisë së pasojave, në tri studime (Barnett & Schubert, 2002; Butterfield et al., 2000; May & Pauli, 2002), është arritur në përfundimin se ky komponent ka një ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv në fazën e njohjes etike. Konsensusi social është marrë në shqyrtim nga tri studime dhe në dy prej tyre është zbuluar një lidhje pozitive e këtij dimensionit me njohjen etike (Barnett & Valentine, 2004; Butterfield et al., 2000), ndërsa studimi tjetër (May & Pauli, 2002) ka arritur në përfundimin se ky komponent nuk ka ndikim te faza e njohjes etike. Nga studimet

empirike të kryera gjatë kësaj periudhe komponenti i tretë i dimensioneve të intensitetit moral, i cili do të merret në konsideratë në punimin tim, është marrë në shqyrtim nga një studim i vetëm prej të cilit është arritur në përfundimin se ky komponent nuk ndikon në fazën e njohjes etike (Barnett & Valentine, 2004).

Sa i përket fazës së gjykimit etik, janë bërë në total katërmëdhjetë studime, të cilat dëshmojnë për ekzistencën e një ndikimi të fortë të dimensioneve të intensitetit moral në këtë fazë të procesit të vendimmarrjes etike. Me përjashtim të studimit të Davis et al., 1998, në tetë prej këtyre studimeve është vërtetuar një lidhje e rëndësishme dhe pozitive e madhësisë së pasojave me fazën e gjykimit etik (Shaw, 2003; Singer, Mitchell & Turner, 1998). Gjithashtu në tetë studime është shqyrtuar efekti i konsensusit social në fazën e gjykimit etik dhe është arritur në përfundimin se ky dimension ka një ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv në këtë fazë (Shaw, 2003; Singer et al., 1998). Shpejtësia e shfaqjes së pasojave është marrë në konsideratë vetëm në dy studime dhe vetëm njëri prej tyre ka arritur në përfundimin se ky dimension ka ndikim të rëndësishëm në këtë fazë (Singer et al., 1998).

Faza e qëllimit etik ka qenë në fokus të tetë studimeve, të cilat pohojnë ekzistencën e lidhjeve të rëndësishme të kësaj faze dhe të dimensioneve të intensitetit moral dhe dëshmojnë se të paktën njëri prej dimensioneve të intensitetit moral ka ndikim në këtë fazë. Madhësia e pasojave, sipas tri studimeve (May & Pauli, 2002 etj), ka ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv në fazën e qëllimit etik, ndërsa vetëm një studim (Barnett & Valentine, 2004) dëshmon për ekzistencën e një ndikimi negativ të këtij komponenti në këtë fazë. Konsensusi social e ndikon pozitivisht dhe fuqimisht fazën e qëllimit etik sipas tri

studimeve (Barnett, 2001; Harrington, 1997; May & Pauli, 2002), ndërsa një studim (Barnett & Valentine, 2004) rezulton në gjetje jo të rëndësishme. Shpejtësia e shfaqjes së pasojave sipas studimeve të kryera duket se ka ndikim negativ me qëllimin etik (Barnett & Schubert, 2002).

Sipas Craft (2013) gjatë kësaj periudhe janë kryer rreth njëzet punime që kanë marrë në shqyrtim ndikimin e dimensioneve të intensitetit moral në fazat e procesit të vendimmarrjes etike. Disa prej këtyre studimeve i kanë marrë në shqyrtim dimensionet e intensitetit moral si një grup në tërësi dhe disa të tjera janë marrë me ndikimin që ka një apo më tepër nga këto dimensione në procesin e vendimmarrjes etike. Në përgjithësi, pjesa më e madhe e këtyre punimeve janë konsistente me studimet e mëparshme sipas të cilave komponentët e intensitetit moral kanë një ndikim të rëndësishëm në fazat e procesit të vendimmarrjes etike. Janë bërë pesë studime në lidhje me ndikimin e intensitetit të moralit në fazën e njohjes etike. Konkretisht madhësia e pasojave, sipas katër studimeve (Sweeney & Costello, 2009; Vitell & Patwardhan, 2008), rezulton të ketë një marrëdhënie të rëndësishme me njohjen etike. Konsensusi social është marrë në konsideratë nga tri studime, të cilat dëshmojnë se ky dimension ka një marrëdhënie pozitive me njohjen etike (Barnett & Valentine, 2004; Bernard & Sweeney, 2010; Leitsch, 2004). Shpejtësia e shfaqjes së pasojave sipas dy studimeve, të cilat e marrin në konsideratë këtë dimension ka një ndikim pozitiv te njohja etike (Leitsch, 2004; Sweeney & Costello, 2009), ndërsa një studim i vetëm nuk ka arritur në përfundime të rëndësishme në lidhje me ndikimin e këtij dimensionit te sjellja etike (Barnett & Valentine, 2004).

Gjetjet në lidhje me fazën e dytë të procesit të vendimmarrjes etike, gjykimin etik vijnë nga tetë punime të kryera në total. Katër prej këtyre punimeve i marrin në shqyrtimin e dimensioneve të intensitetit moral si një grup në tërësi dhe kanë arritur në përfundimin se këta komponentë kanë një ndikim të rëndësishëm në gjykimin etik (Cohen & Bennie, 2006; Leitsch, 2006; Ngyyen et al., 2008; Singh et al., 2007). Madhësia e pasojave ndikon fuqimisht në gjykimin etik sipas tri studimeve (Barnett & Valentine, 2004; McMahon & Harvey, 2007; Sweeney & Costello, 2009), ndërsa vetëm një studim pohon se nuk ka një ndikim të rëndësishëm të madhësisë së pasojave në fazën e gjykimit etik (Leitsch, 2004). Në këtë periudhë janë bërë gjithashtu edhe katër studime, të cilat marrin në konsideratë ndikimin e konsensusit social në fazën e gjykimit etik dhe që të katra kanë arritur në përfundimin se ekziston një lidhje e rëndësishme pozitive midis këtyre dy faktorëve (Leitsch, 2004). Shpejtësia e shfaqjes së pasojave ka ndikim të rëndësishëm në fazën e gjykimit etik sipas dy studimeve (McMahon & Harvey, 2007; Sweeney & Costello, 2009), ndërsa vetëm një studim nuk e pohon një lidhje të tillë (Barnett & Valentine, 2004).

Qëllimi etik është shqyrtuar nga tetë studime në total dhe tri prej tyre kanë arritur në përfundimin se kjo fazë ndikohet fuqimisht dhe pozitivisht nga komponentët e intensitetit moral të marra në konsideratë si një grup në tërësi (Leitsch, 2006; Ngyyen et al., 2008; Singh et al., 2007). Madhësia e pasojave, sipas tri studimeve, ka ndikim pozitiv në fazën e qëllimit etik (Barnett & Valentine, 2004; Sweeney & Costello, 2009; Vitell & Patwardhan, 2008), ndërsa një studim i vetëm nuk e pohon ekzistencën e kësaj lidhje (Leitsch, 2004). Rezultate mikse janë arritur në lidhje me ndikimin e konsensusit social dhe shpejtësinë e shfaqjes së pasojave. Janë bërë nga dy studime për secilin prej këtyre komponentëve, të

cilët pohojnë ekzistencën e një ndikimi pozitiv dhe të rëndësishëm të tyre në këtë fazë (Vitell & Patwardhan, 2008) dhe njëkohësisht dy studime, të cilat pohojnë se nuk ekziston asnjë lloj ndikimi i këtyre komponentëve në fazën e qëllimit etik (Barnett & Valentine, 2004).

Përgjithësisht, pjesa më e madhe e studimeve pohojnë një marrëdhënie të rëndësishme dhe pozitive midis komponentëve të intensitetit moral dhe procesit të vendimmarrjes etike. Madhësia e pasojave dhe konsensusi social kanë qenë dy dimensionet më të përdorura në kërkim dhe për të cilat është vërtetuar ekzistenca e një lidhjeje të rëndësishme dhe pozitive me tri fazat e para të procesit të vendimmarrjes etike. Edhe pse studimet e mëparshme kanë arritur në rezultate jokonsistente në lidhje me shpejtësinë e shfaqjes së pasojave, përmbledhja e Craft (2013) rezulton me studime të cilat e pohojnë ndikimin pozitiv të këtij dimensionit në tri fazat e para të procesit të vendimmarrjes etike.

3.5. Skeleti teorik i punimit

Modelet ekzistuese në literaturën e etikës së biznesit kanë arritur në përfundimin se pa marrë në konsideratë faktorët individualë, organizativë dhe karakteristikat e çështjes etike, procesi i vendimmarrjes etike nuk mund të kuptohet. Duke u mbështetur në përmbledhjen e literaturës, e cila analizuar hollësisht në këtë kapitull dhe duke u mbështetur veçanërisht në modelet e procesit të vendimmarrjes etike të ndërtuar nga (Ferrell & Gresham, 1985; Hunt & Vitell, 1986; Jones, 1991; Rest, 1986; Treviño, 1986) figura e mëposhtme paraqet skeletin teorik mbi të cilin ngrihet ky punim.

Ky skelet ilustron ndikimin e mundshëm të faktorëve individualë, organizativë dhe dimensioneve të intensitetit moral në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve.

Sikurse vihet re, ai është një gërshetim i modeleve të mëparshme. Ajo që duhet theksuar është që faza e katërt e procesit të vendimmarrjes etike nuk do të merret në konsideratë në këtë punim për arsyet e shprehura më parë në pjesën që i takon analizës së etapave të procesit të vendimmarrjes etike.

Pavarësisht faktit se studime të ndryshme empirike në lidhje me procesin e vendimmarrjes etike kanë vërtetuar që ekziston një gamë prej afërsisht dyzet faktorësh që ndikojnë në procesin e vendimmarrjes në fokus të këtij punimi do të jenë:

1. mosha, gjinia, niveli i edukimit, eksperiencia dhe filozofia personale e moralit nga grupi i faktorëve individualë.
2. kodi i etikës, klima etike e kompanisë, madhësia dhe lloji i kompanisë nga grupi i faktorëve organizativë.
3. madhësia e pasojave, konsensusi social dhe shpejtësia e shfaqjes së pasojave nga grupi i dimensioneve të intensitetit moral.

Njëkohësisht është e rëndësishme të theksohet se baza mbi të cilën ngrihet skeleti teorik i këtij punimi është modeli i Rest (1986). O' Fallon & Butterfield (2005) pohojnë se ky model ka shërbyer si bazë për zhvillimin e teorive dhe kërkimeve empirike të mëparshme. Këto studime kanë arritur në përfundime që pohojnë ndikimin e rëndësishëm midis tri fazave të para të procesit të vendimmarrjes etike dhe këtyre faktorëve.



Figura 3.1 Skeleti teorik i punimit

3.6. Kufizimet e studimeve të mëparshme

Studimet empirike në lidhje me procesin e vendimmarrjes etike i kanë fillesat e tyre që prej viteve 1980 (O'Fallon & Butterfield, 2005). Në përmbledhjen e cituar më sipër arrihet në përfundimin se pjesa më e madhe e këtyre punimeve janë bërë me qëllim që të shpjegohet dhe parashikohet procesi, nëpërmjet të cilit një individ merr një vendim etik. Pa dyshim që këto studime kanë patur edhe limitime dhe kufizime. Duke u mbështetur në katër përmbledhjet e literaturës, të cilave iu është referuar në këtë punim, në lidhje me studimet e mëparshme listohen disa kufizime:

- 1.** Vihet re se në të katër përmbledhjet e literaturës kritikohet metodologjia e përdorur në literaturën e etikës së biznesit. Pjesa më e madhe e këtyre kërkimeve kanë mungesë të fortë të sfondit teorik. Teoritë e psikologjisë sociale, ku bëjnë pjesë Teoria e Zhvillimit të Moralit

Njohës e Kohlberg (1969) dhe Teoria e Sjelljes së Planifikuar e Ajzen (1991) kanë qenë teoritë më tepër të përdorura nga kërkimet e etikës së biznesit. Sipas O'Fallon & Butterfield (2005) duhet t'i kushtohet më tepër rëndësi zhvillimit të teorive të reja, të cilat mundësojnë testimin dhe parashikimin më të thellë të ndikimit të faktorëve individualë, organizativë dhe karakteristikave që lidhen me çështjen etike me qëllim që të kuptohet më qartësisht procesi i vendimmarrjes etike. Kjo është arsyeja kryesore e përfshirjes në këtë studim e disa faktorëve nga secili grup dhe testimi i ndikimit të tyre në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve.

2. Kritika e dytë në lidhje me studimet e mëparshme në fushën e etikës së biznesit, e cila listohet në grupin e kufizimeve në të katër përmbledhjet e literatures, të cilat është mbështetur ky punim, ka të bëjë me marrjen në konsideratë të një faze të procesit të vendimmarrjes etike dhe mungesë të marrjes në studim të fazës së parë të procesit, e cila i përket njohjes etike. Në përgjigje të rekomandimeve të këtyre përmbledhjeve për të marrë në konsideratë të gjitha fazat e procesit dhe veçanërisht të fazës së njohjes etike, ky punim merr në konsideratë tri fazat e para të procesit duke përjashtuar fazën e fundit, sjelljen etike, e cila vlerësohet nga studiues të ndryshëm si një fazë e vështirë për t'u matur duke qenë se ende nuk ka një mendim të konsoliduar në lidhje me instrumentin e përshtatshëm për ta matur atë.

3. Pjesa më e madhe e studimeve të mëparshëm janë fokusuar kryesisht te ndikimi i faktorëve individual në procesin e vendimmarrjes etike dhe katër përmbledhjet e literaturës në lidhje me këtë proces rekomandojnë që në studimet e ardhshme të merren në konsideratë edhe faktorët organizativë dhe dimensionet e intensitetit moral. Në lidhje me dimensionet e intensitetit moral pjesa më e madhe e punimeve janë përqëndruar veçanërisht te madhësia e

pasojave dhe konsensusi social. Edhe për këtë grup faktorësh ka një hendek në literaturë përse i përket evidencave në lidhje me ndikimin e dimensioneve të intensitetit moral te procesi i vendimmarrjes etike. Me qëllim që të përmbushen këto dy mangësi të punimeve të mëparshme në këtë punim janë marrë në konsideratë një numër i konsiderueshëm faktorësh nga secili grup.

4. Skenarët janë përdorur gjerësisht në punimet e mëparshme për të matur fazat e procesit të vendimmarrjes etike duke qenë se ato janë pranuar nga pjesa më e madhe e studiuesve të fushës si instrumenti më i përshtatshëm për këtë çështje. Sasia e skenarëve të përdorur ka qenë një ndër çështjet më të debatuar nga studiuesit. Weber (1992) mendon se një ose dy skenarë janë të pamjaftueshëm, sepse ata mund të ndikojnë në numrin e faktorëve, të cilët studiuesi ka për qëllim që të masë dhe nga ana tjetër ai mendon se një numër i madh skenarësh është i lodhshëm për pjesëmarrësit në studim. Duke marrë shkas nga rekomandimet e studiuesve të fushës në punim janë përdorur katër skenarë, të cilët kanë për qëllim të masin tri fazat e procesit të vendimmarrjes etike dhe njëkohësisht edhe tri dimensionet e intensitetit moral të marra në konsideratë në këtë punim.

5. Edhe pse gjatë dekadës së fundit vihet re një rritje e konsiderueshme e studimeve në fushën e etikës së biznesit, të cilat janë të fokusuar në studimin dhe eksplorimin e procesit të vendimmarrjes etike, pjesa më e madhe e këtyre studimeve janë bërë në vende të zhvilluara. Në vendet në zhvillim kjo çështje është pothuajse e lënë në harresë pavarësisht rëndësisë që ka. Procesi i vendimmarrjes etike është një proces, i cili ka një rol shumë të madh në zhvillimin ekonomik të një vendi për vetë faktin se kontabilistët janë individët në duart e të cilëve qëndron i gjithë informacioni financiar mbi të cilin merren vendimet e rëndësishme ekonomike. Për më tepër, në vendet në zhvillim, etikës në kontabilitet i është

kushtuar një rëndësi minimale dhe një ndër këto vende është edhe Shqipëria. Çështjet e etikës në kontabilitet në vendin tonë janë fare pak, për të thënë aspak të studiuara. Për të përmbushur një prej rekomandimeve që autorët e të tri përmbledhjeve të literaturës që i përket procesit të vendimmarrjes etike, i lënë studiuesve të ardhshëm u vendos që të ndërmerrej një studim i tillë mbi etikën e kontabilistëve të vendit tonë.

3.7. Konkluzione

Në këtë kapitull u analizuan hollësisht si nga konteksti teorik ashtu edhe nga ai empirik i të gjithë faktorëve, të cilët do të merren në shqyrtim në këtë punim. Vihet re se përgjithësisht literatura e deritanishme sugjeron se këta faktorë kanë një ndikim pozitiv mbi procesin e vendimmarrjes etike, me përjashtim të madhësisë së organizatës dhe shpejtësisë së shfaqjes së pasojave. Përsa i përket madhësisë së kompanisë studimet e deritanishme mbështesin faktin se sa më e madhe të jetë kompania në të cilën punon një individ aq më të mëdha janë shanset për të marrë vendime joetike, sepse në këto lloj kompanish është më e lehtë që individëve vendimmarrës ti jepen rryshfete të ndryshme, të cilat i orientojnë ato drejt sjelljeve joetike. Njëkohësisht edhe shpejtësia e shfaqjes së pasojave mendohet se ndikon negativisht në vendimmarrjen etike të individëve, sepse sa më larg në kohë të shfaqen pasojat e një veprimi joetik aq më i vogël është dëmi i perceptuar që vjen si pasojë e këtij veprimi çka i bën individët më pak të ndjeshëm në lidhje me etikën e vendimeve të tyre. Gjithashtu në këtë kapitull u paraqitën edhe kufizimet e punimeve të mëparshme të përmbledhura dhe në fund të kapitullit u paraqit skeleti teorik, mbi të cilin ngrihet ky punim.

KAPITULLI IV: ETIKA NË PROFESIONIN KONTABËL DHE PROCESIN E VENDIMMARRJES NË SHQIPËRI

Në këtë kapitull bëhet një diskutim në lidhje me çështjet që i përkasin etikës në profesionin kontabël dhe procesin e vendimmarrjes etike. Kapitulli është organizuar në disa seksione. Në seksionin e parë diskutohet evoluimi i etikës në kontabilitet duke filluar diskutimin që prej fillesave të saj e deri në ditët e sotme. Në seksionin e dytë diskutohet rëndësia e etikës në praktikën profesionale të kontabilistëve dhe gjithashtu jepen argumente në lidhje me benefitet që merr shoqëria nga ushtrimi i profesionit prej kontabilistëve duke zbatuar parimet etike. Në seksionin e fundit shqyrtohet rregullimi i etikës në kontabilitet duke u ndaluar veçanërisht te kushtet për hyrjen në profesion dhe arsyet e nevojës për kualifikim të vijueshëm profesional.

4.1. Evoluimi i etikës në kontabilitet

Kontabiliteti është një prej profesioneve më të vjetra në botë. Në formën e tij më të hershme ai ka ekzistuar që shtatë mijë vjet më parë. Në atë kohë njerëzit nuk përdornin numra dhe formula.

Një hap i rëndësishëm në lidhje me këtë profesion ishte zbulimi i kontabilitetit. Së pari të gjitha transaksionet financiare, siç janë shitja dhe blerja, filluan të regjistroheshin në bazë të njësive të shkëmbyera. Disa vite më vonë, tregtarët filluan të përdornin dhe të mbanin rregjistrimet e tyre kontabël nëpërmjet numrave.

Në ditët e sotme gjendemi përballë një realiteti ekonomik krejt të ndryshëm. Duhet theksuar se kontabiliteti ende luan një rol shumë të rëndësishëm në jetën e përditshme të miliona njerëzve. Pa dyshim, që sistemi i kontabilitetit ka pësuar ndryshime të mëdha dhe sot ai nuk

ka të bëjë vetëm me matematikën dhe llogaritë por, si rezultat i teknologjive moderne, ai është shndërruar në një profesion komunikimi.

Është e qartë që të gjitha veprimet njerëzore udhëhiqen nga disa norma dhe rregulla etike dhe profesioni i kontabilistit nuk përjashtohet nga kjo ligjësi. Natyra e punës që bëjnë kontabilistët është tejet delikate duke qenë se ka të bëjë me ndershmërinë dhe drejtësinë. Në të njëjtën kohë duhet theksuar se problemet etike që shfaqen në këtë fushë variojnë nga njëri vit në tjetrin.

Në kohët e hershme sigurisht që etika e kontabilitetit nuk përbënte një fushë të studimit shkencor, por duhet theksuar se ajo ekzistonte në formën e saj më primitive dhe rregullonte procesin e tregtimit. Sipas disa rregullave morale, vlera dhe cilësia e produkteve të shkëmbyera në atë kohë duhej të ishte e njëjtë. Për më tepër mund të themi se sistemet e hershme të etikës së kontabilitetit aplikoheshin për zgjidhjen e konflikteve të borxhit dhe kredisë, ashtu sikurse edhe për problemet e tjera të shkëmbimit.

Etika e kontabilitetit si një fushë e etikës profesionale u afirmua për herë të parë nga matematicieni italian Luca Pacioli, i cili e përshkroi të kuptuarin e këtij problemi në punimin e tij të titulluar “Summa de arithmetica, geometrica, proportioni, et propornialita” të shkruar në vitin 1494 (Smith, 2008). Më vonë, normat etike të kontabilitetit u bënë të njohura midis kompanive dhe organizatave të ndryshme.

Një periudhë e rëndësishme në formimin e etikës profesionale të kontabilitetit është ajo e shekullit të nëntëmbëdhjetë. Gjatë kësaj kohe vihet re formimi i shumë organizatave që merreshin me parimet morale dhe rregullat e profesionit. Qëllimi i tyre ishte detyrimi i kontabilistëve për të ndjekur kodet e etikës gjatë ushtrimit të detyrës së tyre. Për më tepër,

organizata të tilla kishin për qëllim të ndihmonin kontabilistët të merrnin vendime gjithmonë etike dhe të zgjidhnin dilemat etike me të cilat përballeshin.

Një prej organizatave të para që u ngritën në Amerikë ishte Organizata Amerikane e Kontabilistëve Publikë në vitin 1887. Kjo organizatë ishte e para që u fokusua në çështjet e profesionalizmit dhe ndershmërisë në profesionin kontabël. Në vitin 1905 kjo organizatë jo vetëm që shënonte një numër të konsiderueshëm të anëtarëve të saj, por gjithashtu kishte hartuar edhe listën e parë të normave etike.

Në fund të shekullit XX etika e kontabilitetit u shndërrua në një nocion tashmë gjerësisht të afirmuar dhe pranuar nga publiku i gjerë. Lënda e etikës së biznesit u fut në kurrikulat e programeve universitare të studimit dhe pjesa më e madhe e kurseve të kontabilitetit përfshinin çështjet etike. Edhe pse një numër i madh kritikësh vënë në pikëpyetje të mësuarin e etikës në kolegje apo universtitete, pjesa dërrmuese e firmave të kontabilitetit dhe organizatave profesionale pranonin domosdoshmërinë e kurseve të tilla.

Në ditët e sotme çështja e etikës në profesionin e kontabilistit duket se ka marrë një rëndësi të veçantë. Ashtu sikurse shumë profesione të tjera, kontabiliteti është një lloj pune në të cilën mbështeten apo besojnë shumë njerëz. Për më tepër, kohët e fundit ai është shndërruar në një profesion me dilema të vazhdueshme. Falë paqëndrueshmërisë ekonomike, kontabilistët shpeshherë ballafaqohen me situata delikate. Nga njëra anë kontabilistëve i duhet të marrin në konsideratë interesin e publikut dhe të paraqesin informacion të vlefshëm. Nga ana tjetër, ata duhet të sigurojnë aftësinë financiare të kompanisë së tyre. Si rezultat, shpeshherë kontabilistët duhet ta ekspozojnë kompaninë për të cilën punojnë ndaj humbjeve të mëdha apo falimentimit.

Ashtu sikurse secili prej nesh është në dijeni, gjatë tridhjetë viteve të fundit ka ndodhur një numër i madh skandalesh financiare, ku ndër të tjera mund të përmendim WorldCom, Xerox, Enron, Parmalat etj. Shkaku kryesor i skandaleve të tilla besohet të ketë qenë analiza jo e drejtë financiare dhe kontabiliteti jo i ndershëm.

Njëri prej skandaleve më të bujshme ishte ai i kompanisë ndërkombëtare të Enron, i cili ndodhi në SHBA në vitin 2001. Shkaku kryesor i një falimentimi të përmasave të tilla ishte përdorimi i metodave joetike të kontabilitetit, në të cilin aksionerët e kompanisë humbën më tepër sesa njëzet e pesë bilion dollarë dhe prej mbylljes së saj tetëdhjetë e pesë mijë punonjës mbetën të papunë.

Me qëllim që të reduktoheshin mundësitë e kontabilitetit joetik rregulla të reja u hartuan dhe implementuan në lidhje me ushtrimin e profesionit. Në mënyrë të veçantë studimi i etikës profesionale u shndërrua në një detyrim në universitete. Në të njëjtën kohë disa kompani organizuan trajnime specifike për kontabilistët dhe auditët e tyre përpara se ato të merreshin në punë dhe në të njëjtën kohë u vendosën ura bashkëpunimi midis institucioneve edukuese me qëllim që të përgatiteshin kontabilistë tejet profesionistë dhe etikë në ushtrimin e profesionit të tyre.

Një hap i rëndësishëm në lidhje me përmirësimin e standardeve etike për profesionin u bë në Australi nga Corporate Law Economic Reform Program në vitin 2004 dhe ligji i Sarbanes-Oxley në SHBA në vitin 2002, i cili rregullonte aktivitetin e firmave të kontabilitetit dhe kufizonte tarifat e tyre. Në këtë mënyrë, të ardhurat e kompanisë nuk vareshin tërësisht nga një firmë konkrete dhe rreziku për sjellje joetike ishte më i vogël.

Pra, në përfundim mund të themi çdo periudhë historike ka sjellë realitete dhe sfida të veçanta në lidhje me evoluimin e etikës në profesionin e kontabilistit. Nuk mund të

mohohet se disa probleme e ndjekin shoqërinë tonë që prej kohëve të lashta e deri më sot. Tentativat për t'u pasuruar nëpërmjet sjelljeve jo të moralshme rradhitet si një ndër sfidat më kryesore të profesionit të kontabilistit. Si pasojë, normat etike luajnë një rol vital në zhvillimin e marrëdhënieve të biznesit të ndershme në këtë fushë.

Kontabiliteti është një fushë e biznesit në të cilën saktësia dhe interpretimi janë shumë të rëndësishme. Mospërputhjet e vogla mund të zhvendosin shuma të mëdha parash, veçanërisht në kompanitë e mëdha. Këto zhvendosje mund të bëhen qëllimisht, por nuk përjashtohen edhe rastet kur ato ndodhin aksidentalisht. Etika është ajo praktikë e sjelljes, e cila nuk lejon përdorimin e praktikave kontabël të pasakta qëllimisht. Kjo nënkupton jo vetëm ndjekjen e ligjit domosdoshmërisht, por edhe interpretim të të dhënave financiare në mënyrë sa më të qartë dhe të ndershme. Në biznes, individët përdorin informacionin e përpunuar nga kontabilistët për të marrë vendime shumë të rëndësishme, përfshirë këtu vendime që lidhen me mënyrën se si të strukturohet sistemi i përfitimit të kompanisë dhe nëse duhet apo jo të investohet në një biznes të caktuar. Qeveria gjithashtu përdor informacionin e përpunuar prej kontabilistëve për të marrë vendime në lidhje me ligjet dhe taksat. Duke qenë se ka shumë palë, të cilat bazohen në informacionin e mbledhur prej kontabilistëve, çështjet etike në këtë rast janë më të rëndësishme në këtë fushë krahasuar me llojet e tjera të industrisë.

4.2. Etika dhe praktika profesionale

Është jashtë mase e rëndësishme për profesionistët e kontabilitetit që të jenë etikë në praktikat e tyre për shkak të natyrës së profesionit të tyre. Natyra e punës së kontabilistëve

i vendos ato në një pozicion të veçantë besimi në lidhje me klientët e tyre dhe publikun e gjerë, të cilët besojnë në gjykimin e tyre profesional dhe udhëhiqen prej tyre në marrjen e vendimeve. Këto vendime nga ana tjetër ndikojnë procesin e shpërndarjes së burimeve në ekonomi. Arsyeja pse bazohemi te puna e këtyre kontabilistëve është statusi i tyre profesional dhe standardet etike. Pra, çelësi i ruajtjes së besimit të klientëve dhe të publikut është sjellja etike dhe profesionale.

Përvetësimi i standardeve më të larta etike është i rëndësishëm për kontabilistët publikë pasi ata janë personat, të cilët merren me shërbimet profesionale siç janë shërbimet e sigurisë ndaj klientëve kundrejt një pagese, por në të njëjtën kohë edhe për kontabilistët e bizneseve pasi ato përfaqësojnë personat, të cilët janë të punësuar nga kompanitë private kundrejt një page. Si kontabilisti publik, ashtu edhe ai i punësuar në sektorin privat janë në marrëdhënie besueshmërie si me klientët, ashtu edhe me punëdhënësit e tyre. Në këtë marrëdhënie ato kanë përgjegjësinë që të sigurojnë palët e tjera që po e ushtrojnë detyrën e tyre në përputhje me parimet etike të integritetit, objektivitetit, kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur, konfidencialitetit dhe sjelljes profesionale. Kështu, kontabilistët si profesionistë pritet të ruajnë një nivel të lartë të sjelljes etike, e cila shkon përtej rregullave të shoqërisë. Kjo i ka bërë shoqatat profesionale të kontabilistëve të hartojnë kodet e sjelljes profesionale, të cilët vendosin rregullat që përcaktojnë dhe dallojnë të drejtën nga e gabuara për të siguruar që sjellja e anëtarëve të tyre përputhet me pritshmëritë e perceptuara të publikut përse i përket standardeve etike. Këto rregulla janë hartuar në bazë të parimeve të sjelljes profesionale, e cila përbën bazën për etikën profesionale.

Gjithsesi përfshirja e kontabilistëve në skandalet e korporatave të mëdha gjatë kohëve të fundit dëshmon për moszbatueshmëri të standardeve etike prej tyre. Shpeshherë është theksuar se kontabilistët fokusohen shumë te çështjet teknike dhe shfaqin mungesë të ndjeshmërisë etike për të njohur dilemat etike, të cilat lidhen me punën e tyre dhe që nga ana tjetër i çojnë ata drejt marrjes së vendimeve të gabuara dhe joetike.

Kjo është arsyeja pse kontabilistët duhet të trajnohen vazhdimisht për të qenë në gjendje të identifikojnë dimensionet morale të të ashtuquajturave çështje teknike. Duhet theksuar se për arsyet e sipërpërmendura është e nevojshme përfshirja e edukimit etik si një element thelbësor i edukimit profesional të kontabilistëve në mënyrë që të përgatiten kontabilistët të përballen me dilema të ndryshme etike, me të cilat ato përballen gjatë ushtrimit të profesionit të tyre.

Kuadri i Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit të Kontabilistëve Profesionistë (2009) i publikuar nga IAESB identifikon që objektivi i përgjithshëm i edukimit kontabël duhet të zhvillojë kontabilistë profesionistë kompetentë, të cilët të zotërojnë njohuri profesionale, aftësi profesionale, vlera profesionale dhe etike.

4.3.Rëndësia e etikës në profesionin kontabël dhe procesin e vendimmarrjes

Etika e duhur dhe sjellja etike janë shumë të rëndësishme për kontabilitetin për një sërë arsyes. Kontabilistët shpesh kanë në duar informacionin e ndjeshëm që i përket klientëve të tyre. Kjo i jep kontabilistëve një fuqi të konsiderueshme përsa i përket klientëve të tyre

dhe është e rëndësishme që të mos abuzohet me besimin e krijuar midis tyre. Në të njëjtën kohë është e rëndësishme që edhe industria në vetvete të mos jetë e stigmatizuar si jo etike, gjë që mund të dëmtojë biznesin e të gjithë shoqërive kontabël.

Ruajtja e standardeve etike është një nevojë për çdo sipërmarrje biznesi që ka për qëllim t'i rezistojë në mënyrë të suksesshme në treg dhe të përmirësojë efencën dhe kompetencat e kompanisë në tërësi. Zhvillimi gjithnjë e më tepër i efikasitetit të punonjësve është një aspekt esencial për një organizatë biznesi dhe e ndihmon atë të ecë drejt suksesit në mënyrë të vazhdueshme. Kjo kërkon trajnim dhe drejtim të punonjësve në një mënyrë të tillë që të arrihet efikasiteti i performancës së tyre në të gjitha aspektet e biznesit, por njëkohësisht edhe duke e vënë theksin vazhdimisht te ruajtja e standardeve etike. Të kuptosh dhe të respektosh etikën në biznes është thelbësore për të gjitha aktivitetet e biznesit në përgjithësi.

Përderisa profesioni i kontabilistit lidhet me funksione të ndryshme të kontabilitetit, siç janë rregjistrimi i të gjitha ngjarjeve të biznesit, të cilat janë me karakter financiar, klasifikimin dhe përmbledhjen e tyre në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, bilancit kontabël dhe pasqyrën e të ardhurave rrjedhëse, mënyra e përmbushjes së këtyre funksioneve është shumë e rëndësishme dhe nevojitet një punë e madhe për të ruajtur etikën e kontabilistëve. Një prej gjërave më të rëndësishme që dëshmon për sjelljen etike të një kontabilisti është fakti që ai duhet të jetë i paanshëm dhe besnik ndaj organizatës së biznesit gjatë kohës kur performon aktivitetet në lidhje me të, me sinqeritet dhe me të gjithë ndershmërinë e tij. Pasqyrat financiare të përgatitura nga kontabilistët, të cilat bien në duart e palëve të interesit përdoren dhe kërkohen nga grupe interesi të rëndësishme në ekonomi për të marrë vendime

sa më të drejta në lidhje me investimet. Grupet e interesit bazohen në opinionin e kontabilistëve që merren me përgatitjen e këtyre pasqyrave ashtu sikurse edhe tek auditët, të cilët i verifikojnë ato, për të krijuar një pamje të drejtë në lidhje me kompaninë. Për këtë arsye kodet janë të rëndësishme për të siguruar besimin e investitorëve ndaj kompanive. Njohuritë në lidhje me etikën e kontabilitetit janë të rëndësishme për kontabilistin me qëllim që ai të kapërcejë dilemat etike me të cilat përballlet dhe të udhëhiqet drejt marrjes së vendimeve të drejta, të cilat përveç se i sjellin dobi kompanisë, do t'i sjellin përfitime gjithashtu edhe publikut, i cili bazohet fuqimisht në raportet dhe pasqyrat financiare të ndërtuara prej kontabilistëve.

Etika profesionale e kontabilistit është thelbësore në ruajtjen dhe rritjen e besimit për të rritur përgjegjësinë dhe ndjenjën e lartë të integritetit. Integriteti është cilësia prej së cilës varet besimi i publikut dhe shërben si njësi vlerësimi sipas të cilit vendimet testohen. Etika profesionale i mundëson kontabilistëve të zhvillojnë vlerat e reputacionit, integritetit dhe skepticizmit profesional. Ekzistenca e Kodeve të forta të etikës dhe zbatimi i rregullave dhe parimeve të tyre krijon siguri në lidhje me investimet, sigurimin e jetës, pensionet etj. Kontabilistët dhe audituesit duhet të zotërojnë një argumentim të fortë përse i përket gjyimit moral dhe etik si në lidhje me raportimet financiare që ata bëjnë përderisa këta të fundit kanë pasoja thelbësore si tek individët, ashtu edhe kompanitë duke ndikuar tërthorazi tregjet e kapitalit dhe humbjet e konsiderueshme të investitorëve të mëdhenj dhe të vegjël. Etika është mjaft e rëndësishme si për profesionin e kontabilistit, ashtu edhe gjatë procesit të vendimmarrjes etike. Duhet theksuar se ekziston një marrëdhënie e ndërsjelltë dhe pozitive midis këtyre aspekteve. Në qendër të kësaj marrëdhënieje qëndron roli i

profesionistëve të kontabilitetit duke qenë se ata janë personat, të cilët furnizojnë me informacion të gjitha palët e interesit të një kompanie. Nëse një profesionist kontabël është etik atëherë ai e ushtron profesionin e tij në përputhje me të gjitha parimet e Kodit të etikës dhe kjo siguron që informacioni që ata vënë në dispozicion të përdoruesve të tij është i besueshëm dhe transparent. Duke pasur në dorë një informacion të tillë dhe duke u udhëhequr nga parimet etike këta individë, në duart e të cilëve qëndron drejtimi i kompanisë, kanë të gjitha mundësitë për të ndërmarrë një proces vendimmarrjeje etik. Procesi i vendimmarrjes është një proces shumë i rëndësishëm për një kompani duke qenë se ai është faktori kryesor që e çon atë drejt suksesit për vetë faktin se marrja e vendimeve etike do të thotë performancë e lartë jo vetëm në terma afatshkurtër, por edhe afatgjatë. Sa më etikë të jenë kontabilistët e një kompanie në ushtrimin e kompetencave të tyre aq më i besueshëm, i saktë dhe relevant është informacioni i prodhuar prej tyre. Sa më e lartë të jetë cilësia e informacionit në duart e vendimmarrësve aq më të mëdha janë shanset për të marrë vendime etike. Sa më etike të jenë vendimet që merr një kompani aq më e lartë është performanca e saj.

4.4. Rregullimi i etikës së kontabilitetit në Shqipëri

Hyrja në profesion

Si në profesione të tjera, shoqatat profesionale të kontabilitetit janë zhvilluar për të siguruar klientët (njësitë ekonomike) që personat e certifikuar si kontabilistë plotësojnë nivelet minimale të arsimit, kompetencës dhe sjelljes etike. Sot, shoqatat profesionale të kontabilitetit nuk i licencojnë kontabilistët, sepse ky funksion është marrë përsipër nga

shteti nëpërmjet caktimit të një bordi kontabiliteti, por shoqëritë profesionale japin udhëzime për shumë çështje, nisur nga standardet teknike të kontabilitetit deri tek etika.

Profesioni i kontabilistit në Shqipëri rregullohet në bazë të Ligjit Nr. 10091 datë 5. 3. 2009 “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertëve Kontabël të Rregjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, si dhe nga kërkesat që burojnë nga detyrimet e anëtarësisë pranë shoqatave profesionale, si Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Instituti i Kontabilistëve të Miratuar (IKM) dhe Shoqata e Kontabilistëve dhe e Financierëve të Shqipërisë (SHKFSH).

Autoriteti i Certifikimit kërkon që kandidatët për titullin “Ekspert Kontabël të Rregjistruar” (EKR), që kanë fituar titullin “Kontabilist i Miratuar” (KM), pasi kanë kaluar dy provimet e para dhe kanë kryer me sukses stazhin profesional, të kalojnë drejtpërdrejt në testin e tretë të provimit të aftësisë profesionale që përmban pyetje për disiplinën e Kodit të etikës për profesionistët e kontabilitetit.

Pavarësisht se Kodi i etikës nuk është një provim i detyrueshëm për lincencimin e KM-së, por vetëm për atë të EKR-së, shteti kërkon përgjithësisht që aplikantët që në rregjistrimin e parë të paraqesin dëshminë e penalitetit për të përmbushur kërkesën për një figurë të pastër nga krimet dhe sjelljet joprofesionale.

Organizata profesionale e ekspertëve kontabël dhe organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar sigurojnë që anëtarët e tyre, përsa u takon etikës profesionale dhe papajtueshmërive, t’i nënshtrohen zbatimit të rregullave të parashikuara në kodin e etikës, i

cili hartohet në pajtim me kodin e etikës së Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC) dhe miratohet nga bordi.

Kualifikimi i vijueshëm profesional

Arritja e një kompetence të lartë profesionale nuk është vetëm përgjegjësi individuale e çdo kontabilisti, por ajo varet edhe nga puna në vijimësi e shoqatave profesionale që operojnë në Shqipëri, si IEKA, IKM-ja dhe SHKFSH-ja, duke ofruar programe trajnimi në përputhje me të rejat e profesionit.

Vëmendja e organizatave profesionale duhet të vazhdojë të fokusohet në garantimin e mbrojtjes së interesit publik, përmes dhënies së sigurisë se anëtarët do të përfshihen dhe do të kryejnë më shumë se deri më sot shërbime profesionale cilësore, do të njohin më mirë standardet teknike dhe ato etike dhe do të respektojnë në maksimum parimet kryesore etike të integritetit, objektivitetit, kompetencës profesionale, sjelljes profesionale dhe konfidencialitetit.

Për këtë qëllim anëtarët e organizatave profesionale duhet të plotësojnë detyrimin e kualifikimit profesional të vijueshëm në pajtim me programet e shpallura nga Këshilli drejtues i tyre, përmes pjesëmarrjes në seminarët e kualifikimit të vijueshëm. Ekspertët kontabël i nënshtrohen kualifikimit të vijueshëm profesional, i cili është i detyrueshëm dhe zgjat, të paktën, dyzet orë në vit. Dispozitat e Ligjit Nr. 10091, të parashikuara për kualifikimin e vijueshëm profesional të ekspertëve kontabël, duhet të zbatohen nga organizmat profesionalë edhe për kontabilistët e miratuar, për aq sa i takon fushës, për të cilën ata janë testuar, në çastin e hyrjes në profesion.

Organizatat profesionale duhet t'i pajisin anëtarët me një literaturë të aktualizuar për ta çuar më tej rolin e organizmit profesional të kontabilistëve. Për shembull, vënia në zbatim e Guidës së thjeshtëzuar të auditimit, të përgatitur nga IEKA për zbatimin proporcional të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), bëri të mundur që gjatë vitit 2014, të standardizohen më tej procedurat e auditimit, si edhe të rritet ndërgjegjësimi i anëtarëve për kryerjen e auditimeve sa më cilësore. Sfidat e 2015-ës janë jo vetëm të mëdha, por edhe të shumta në numër, për shembull duke filluar nga ky vit Guida e thjeshtëzuar bëhet e detyrueshme për auditimin e të gjitha shoqërive të vogla dhe të mesme dhe ky është vetëm minimumi në këtë drejtim.

Guida e thjeshtëzuar, rritja e njohurive dhe njohja sa më e mirë e kërkesave të SNA-ve, përmes një kualifikimi të vazhdueshëm dhe efektiv, janë esenciale për zbatimin e duhur të standardeve profesionale dhe atyre etike.

Megjithatë, nga profesionistët e kontabilitetit mbetet ende shumë për të bërë dhe çelësi i suksesit është edukimi i vijueshëm, pa të cilin nuk mund të ketë zbatim të standardeve cilësore dhe aq më pak, sjellje dhe etikë profesionale.

4.5. Roli i kontabilistëve në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë

Në përgjithësi zhvillimi ekonomik i një vendi ka të bëjë me aftësinë e një vendi për të rritur nivelin e mirëqenies ekonomike dhe sociale të popullsisë së tij. Zhvillimi ekonomik varet në një masë të konsiderueshme në aftësinë për të përdorur në mënyrë eficiente dhe efektive burimet ekonomike që ka në dispozicion.

Është e natyrshme që për të gjithë vendet në zhvillim objektivi dhe synimi kryesor të jetë zhvillimi ekonomik i tyre. Përfitimi kryesor nga zhvillimi ekonomik është ulja e varfërisë dhe e pabarazisë së shpërndarjes së të ardhurave.

Edhe Shqipëria bën pjesë në grupin e vendeve në zhvillim dhe pa dyshim që rritja dhe zhvillimi i vazhdueshëm ekonomik përbën një prej objektivave më të rëndësishme për të.

Shqipëria ishte vendi i fundit ndër vendet e Europës qendrore dhe perëndimore që nisi reformat demokratike dhe ato të tregut të lirë, rrugë të cilën e nisi nga një pozicion i pafavorshëm si pasojë e politikave ekonomike katastrofike të trashëguara nga regjimi komunist. Zgjedhjet demokratike të vitit 1992 sollën me vete një program ekonomik ambicioz në lidhje me zhvillimin e vrullshëm ekonomik dhe vendosjen e vendit në rrugën e duhur drejt ekonomisë së tregut. Nuk duhet lënë pa përmendur që kolapsi i skemave të famshme piramidale dhe destabiliteti që i pasoi ato ishte një hap prapa për zhvillimin ekonomik të vendit. Edhe pse Shqipëria e mori veten shpejt edhe në ditët e sotme si rezultat i të qenit një prej kandidatëve potencialë për t'u bërë pjesë e bashkimit European vazhdon ende me ndërmarrjen e reformave. Ekonomia e saj vazhdon të rritet dhe të rimëkëmbet, por gjithashtu edhe të mbetet një prej vendeve më të varfra në Europë.

Ekonomia informale dhe korrupsioni janë në nivele të larta, gjë që nuk lejon zbatimin e suksesshëm të reformave.

Kontabilistët mund të luajnë shumë funksione në zhvillimin ekonomik të çdo vendi. Rritja dhe zhvillimi i çdo ekonomie varet nga fakti se me sa ekzaktësi dhe rigorozitet shpërndahen burimet. Duke qenë se kontabiliteti në thelb merret me kalkulimin e kostove dhe reduktimin

e tyre mund të themi se ai përbën një prej shtyllave kryesore të rritjes dhe zhvillimit ekonomik.

Një kontabilist mund të luajë disa role në zhvillimin ekonomik të një vendi:

1. Funksioni i vlerësimit të investimeve

Të gjithë e dimë se pa investime, ekonomia nuk mund të rritet dhe zhvillohet. Vlerësimi i investimeve është një proces, i cili vlerëson mundësinë që ka një investim përkundrejt faktorëve financiarë dhe jo financiarë me qëllim që të përcaktohet vlefshmëria e një mundësie investimi. Kontabilistët janë ndër të paktët profesionistë, të cilët mund të performojnë në mënyrë efektive këtë funksion duke përdorur sasinë minimale të burimeve të nevojshme.

2. Përgatitës të pasqyrave financiare

Investitorët dhe pronarët e bizneseve tashmë nuk është e nevojshme të jenë prezente në bizneset e tyre me qëllim që ato të funksionojnë. Kjo është bërë e mundur nga konceptet bashkëkohore të sipërmarrjes në kontabilitet, të cilat i konsiderojnë bizneset dhe pronarët e tyre si të ndryshëm nga njëri-tjetri. E vetmja mënyrë që pronarët e tyre të mund t'i monitorojnë ato, është marrja e informacionit mbi gjendjen e biznesit të tyre nëpërmjet pasqyrave financiare të kompanisë. Këto pasqyra financiare hartohen nga ana e kontabilistëve dhe në këtë këndvështrim del në pah edhe një funksion tjetër shumë i rëndësishëm i këtyre individëve në zhvillimin ekonomik të një vendi. Nuk duhet lënë pa përmendur fakti se informacioni financiar i hartuar nga kontabilistët, ka një rol kyç në suksesin dhe performancën e njësive ekonomike përderisa mbi bazën e këtij informacioni

merren të gjitha vendimet ekonomike në lidhje me njësinë ekonomike. Pra, sa më të aftë të jenë kontabilistët dhe sa më etikë në ushtrimin e profesionit të tyre aq më i saktë dhe i besueshëm është informacioni që ata përgatisin dhe aq më të vogla shanset për të marrë vendime të gabuara dhe jo etike dhe aq më të mëdha shanset për arritjen e performancës së synuar.

3 . Kursyes të kostove

Ka një thënie të vjetër sipas së cilës anjëri prej nesh nuk mund të bëhet i pasur duke fituar e në të njëjtën kohë duke shpërdoruar atë që fiton, pra kursyer. E njëjta linjë logjike është e vlefshme edhe për zhvillimin ekonomik të një vendi e në këtë kontekst për të rritur dhe zhvilluar më tej një ekonomi duhet të luftohet për të minimizuar kostot.

Për këtë, një kontribut unik dhe mjaft të rëndësishëm japin kontabilistët e një ekonomie duke qenë se ato janë të vetmit profesionistë, të cilët kanë një bagazh të pasur dhe njëkohësisht një armë shumë të fortë në lidhje me kontabilitetin e kostos dhe të drejtimit. Duke qenë zotërues të njohurive të tilla, këta individë janë personat e vetëm, te të cilët mund të mbështeten manaxherët e njësive ekonomike në momentet e marrjes së vendimeve në lidhje me situata dhe probleme të ndryshme.

4. Luftues të mashtrimit

Të gjithë jemi dëshmitarë të skandaleve të shumta financiare në të gjithë botën, të cilat kanë ardhur si rezultat i mashtrimit dhe duhet pranuar fakti se gjatë dekadave të fundit ekonomia botërore ka humbur shumë si rezultat i veprimeve me natyrë mashtruese. Duhet të jemi të vetëdijshëm, se nëse nuk kufizohen dhe nuk vihen në kontroll veprimtari të tilla zhvillimi

ekonomik do të jetë i vagullt ose ndoshta nuk do të ketë fare në një mjedis, ku fragmentet e shpërdorimit dhe përvetësimit janë ata që dëgjojmë gjatë gjithë kohës. Në kohët e sotme kontabilistët po trajnohen gjithnjë e më intensivisht për të qenë në krye të luftës kundër mashtrimit dhe korrupsionit. Një proces i tillë pa dyshim që nuk është i lehtë përderisa për të kryer një funksion të tillë, një kontabilisti i duhen jo vetëm njohuri të thella mbi kontabilitetin, ligjin dhe teknologjinë e informacionit, por gjithashtu edhe një ndërgjegjësim i fortë në lidhje me etikën e ushtrimit të profesionit të tyre. Kontabilistët duhet të pajtohen dhe të inkurajojnë me kërkesat gjithnjë në rritje përsa i përket hartimit dhe implementimit të kontrolleve të brendshme në çdo njësi biznesi ku ata bëjnë pjesë. Përfundimisht mund të themi se përderisa bizneset janë stimuluesi kryesor i çdo ekonomie dhe përderisa kontabiliteti njihet si gjuha e bizneseve, roli që luajnë kontabilistët është jetësor duke qenë se në këtë këndvështrim detyrë e tyre është të mundësojnë që kjo gjuhë e biznesit të kuptohet qartë prej të gjithëve. Pra, në thelb kontabilistët përfaqësojnë profesionistët më të rëndësishëm që ndikojnë fuqimisht zhvillimin ekonomik të një vendi. Kontabilistët shqiptarë lënë shumë për të dëshiruar jo vetëm në lidhje me mënyrën e ushtrimit me dinjitet të profesionit të tyre, por gjithashtu edhe në lidhje me dhënien e kontributit maksimal në zhvillimin ekonomik të vendit. Duke qenë se ekziston mundësia që këta individë të shpien përpara zhvillimin dhe rritjen ekonomike të Shqipërisë, por vihet re se ka një mungesë të thellë dëshire për ta dhënë këtë kontribut si rezultat i orientimit gjithnjë e më tepër nga përfitimi dhe interesat vetjake në këtë punim janë paraqitur edhe disa rekomandime në lidhje me masat që duhen marrë për të riorientuar profesionistët e kontabilitetit drejt ndjekjes së parimeve etike në mënyrë që të japin kontributin maksimal në zhvillimin e vendit.

4.6. Konkluzione

Në këtë kapitull bëhet një diskutim në lidhje me çështjet që i përkasin etikës në profesionin kontabël dhe procesin e vendimmarrjes etike. Në ditët e sotme gjendemi përballë një realiteti ekonomik krejt të ndryshëm krahasuar me periudhat më të hershme, kur edhe ky profesion ka zanafillën e tij. Pra, mund të themi që çdo periudhë historike ka sjellë realitete dhe sfida të veçanta në lidhje me evoluimin e etikës në profesionin e kontabilistit. Nuk mund të mohohet se disa probleme e ndjekin shoqërinë tonë që prej kohëve të lashta e deri më sot. Kontabilistët duhet të trajnohen vazhdimisht për të qenë në gjendje të identifikojnë dimensionet morale të të ashtuquajturave çështje teknike për arsye, sepse ata fokusohen më shumë te këto çështje dhe shfaqin mungesë të ndjeshmërisë etike që lidhet me punën e tyre. Për këto arsye është e nevojshme përfshirja e edukimit etik si një element thelbësor i edukimit profesional të kontabilistëve. Ndër cilësitë që përfaqësojnë etikën e një kontabilisti janë edhe ruajtja e sekretit të të dhënave të ndjeshme të klientit, besnikëria, paanësia, ndershmëria dhe sinqeriteti, të cilat duhet të përmbliidhen në kode të posaçme në mënyrë që të rrisin besueshmërinë e klientit dhe të jenë transparente. Në dy çështjet e fundit trajtohen kushtet që duhen plotësuar për të hyrë në profesion dhe arsyet, pse është i nevojshëm kualifikimi i vijueshëm profesional.

KAPITULLI V: METODOLOGJIA

Gjithmonë në punimet shkencore është e nevojshme që fillimisht të bëhet përmbledhja e literaturës dhe njëkohësisht të jepet një tablo e mjedisit ekonomik në të cilin kryhet studimi. Vetëm pasi arrihet në ndërtimin e një skeleti teorik për punimin dhe pasi janë

ndërtuar gjithashtu edhe hipotezat, të cilat do të shoqërojnë punimin është radha e shkrimit të metodologjisë së cilës në këtë punim i është kushtuar një kapitull më vete.

Ky kapitull, ofron një përshkrim të përjasjes kërkimore dhe metodologjive, të cilat mund të aplikohen për këtë studim dhe për testimin empirik të hipotezave të kërkimit. Gjithashtu, ky kapitull përfshin argumente dhe diskutime në lidhje me metodën e mbledhjes së të dhënave, metodën e analizimit dhe përpunimit të të dhënave dhe strukturën e pyetësorit.

Qëllimi i këtij kapitulli është përshkrimi i hollësishëm i metodologjisë së kërkimit, e cila është huazuar dhe gjithashtu e metodave dhe procedurave të përdorura për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Ky kapitull është ndërtuar duke filluar së pari me sqarimin e boshtit teorik ku ai mbështetet për të vazhduar më pas me teknikat e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave dhe së fundi në këtë kapitull do të jepen disa kufizime të metodave të përzgjedhura për t'u përdorur.

5.1. Qëllimi i punimit dhe pyetjet kërkimore të tij

Ashtu sikurse është thënë edhe në pjesën e parë të këtij punimi qëllimi i këtij studimi është përcaktimi i çështjeve më të rëndësishme me të cilat hasen më shpesh kontabilistët shqiptarë dhe përcaktimi i ndikimit të faktorëve individualë, organizativë dhe dimensioneve të intensitetit moral të çështjes etike në procesin e vendimmarrjes etike. Duke qenë se procesi i vendimmarrjes etike sipas modelit të Rest (1986) është një proces që kalon në katër etapa, të cilat janë: **a) njohja etike, b) gjykimi etik, c) qëllimi etik, d) sjellja etike** dhe duke qenë se në qendër të studimit do të jenë vetëm tri fazat e para të tij duke

përfshijtur fazën e fundit që përkon me sjelljen etike, pyetjet kërkimore të punimit lidhen pikërisht me ndikimin e secilit grup faktorësh në procesin e vendimmarrjes etike.

Bazuar në sa më sipër pyetjet kërkimore që ngrihen për këtë punim janë si më poshtë:

- 1) Cilat janë çështjet etike më të rëndësishme me të cilat hasen më shpesh kontabilistët në Shqipëri?
- 2) A kanë faktorët individualë ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike?
- 3) A kanë faktorët organizativë ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike?
- 4) A kanë dimensionet e intensitetit moral të çështjes etike ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike?

Duke u mbështetur në skeletin teorik të punimit dhe në përputhje me pyetjet kërkimore të paraqitura më sipër, nënhipotezat e ngritura për t'ju dhënë përgjigje këtyre pyetjeve janë disa.

Për t'i dhënë përgjigje pyetjes së parë kërkimore pjesëmarrësve u është marrë mendimi në lidhje me disa çështje etike, të cilat janë përkufizuar si të rëndësishme në disa studime të bëra në vendet në zhvillim, siç është edhe Shqipëria.

Pyetja e dytë kërkimore kërkon përgjigje në lidhje me ndikimin e faktorëve individualë me procesin e vendimmarrjes etike.

Në grupin e faktorëve individualë merren në konsideratë mosha, gjinia, niveli i edukimit, eksperiencia dhe filozofia personale e moralit. Nënhipotezat e ngritura për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje janë:

H_0 : Gjinia nuk ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike. (1)

H_a : Gjinia ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike.

H_0 : Grupmosha nuk ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike. (2)

H_a : Grupmosha ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike.

H_0 : Niveli i edukimit nuk ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike. (3)

H_a : Niveli i edukimit ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike.

H_0 : Eksperiencia nuk ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike. (4)

H_a : Eksperiencia ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike.

H_0 : Filozofia personale e moralit nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike
(5)

H_a : Filozofia personale e moralit ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike.

Pyetja e dytë kërkimore kërkon përgjigje në lidhje me ndikimin e faktorëve organizativë në procesin e vendimmarrjes etike. Në grupin e faktorëve organizativë merren në konsideratë kodi i etikës, klima etike, madhësia e kompanisë dhe lloji i industrisë ku operon kompania në të cilën punon individi, i cili ndërmerr një proces vendimmarrjeje. Për këtë pyetje kërkimore janë ngritur nënhipotezat në vijim:

H_0 : Lloji i aktivitetit të kompanisë nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (6)

H_a : Lloji i aktivitetit të kompanisë ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike

H_0 : Madhësia e kompanisë nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (7)

H_a : Madhësia e kompanisë ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike

H_0 : Ekzistenca e kodit të etikës në kompani nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (8)

H_a : Ekzistenca e kodit të etikës në kompani ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike.

H_0 : Klima etike nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (9)

H_a : Klima etike ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike.

Pyetja e tretë kërkimore kërkon përgjigje në lidhje me ndikimin e dimensioneve të intensitetit moral në procesin e vendimmarrjes etike. Në grupin e dimensioneve të intensitetit moral nga gjashtë dimensionet të rekomanduara në total nga Jones (1991) në këtë punim janë marrë në konsideratë tri dimensionet: madhësia e pasojave, konsensusi social dhe shpejtësia e shfaqjes së pasojave. Nënhipotezat e ngritura në lidhje me këtë pyetje kërkimore janë:

H_0 : Madhësia e pasojave nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (10)

H_a : Madhësia e pasojave ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike

H_0 : Konsensusi social nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (11)

H_a : Konsensusi social ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike

H_0 : Shpejtësia e shfaqjes së pasojave nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (12)

H_a : Shpejtësia e shfaqjes së pasojave ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike.

5.2. Boshti teorik

Në zhargonin e përditshëm shpeshherë termat metodologji dhe metodë përdoren si sinonim të njëra-tjetrës. Në realitet kuptimi i tyre është i ndryshëm. Sipas (Collins & Hussey, 2009) metodologjia e përdorur në një punim shkencor përkufizohet si "qasja e përgjithshme e procesit të kërkimit duke filluar nga përmbledhja e literaturës e deri te mbledhja dhe analiza e të dhënave."

Nga ana tjetër metoda e kërkimit shkencor, sipas të njëjtit autor përkufizohet si "mënyra e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave."

Në vija të përgjithshme metodologjia lidhet me strategjinë e përdorur dhe me procesin e dizenjimit të punimit shkencor. Pra, ka të bëjë me çështje të tilla si arsyeja e mbledhjes së të dhënave, lloji i të dhënave dhe popullata prej së cilës duhen mbledhur të dhënat etj. Për të mbledhur dhe përpunuar të dhënat, sigurisht që ka disa metoda të ndryshme ku mund të përmendim pyetësorët, intervistat apo rastet studimore. Pa dyshim, që zgjedhja e metodës

dhe metodologjisë së kërkimit shkencor është e kushtëzuar dhe në varësi të filozofisë së kërkimit apo siç jemi mësuar ndryshe ta quajmë boshtit teorik të kërkimit. Sipas Creswell (2009) në shkencat sociale kërkuesit shkencorë kanë mundësi të zgjedhin midis dy filozofive të kërkimit. Filozofia e parë është ajo pozitiviste, ndërsa e dyta është filozofia post-pozitiviste. Ndryshimi midis të dyjave qëndron në faktin se në rastet kur ndiqet filozofia pozitiviste përdoren metodat deduktive, ndërsa kur ndiqet filozofia post-pozitiviste përdoren metodat induktive (Perry, 1998). Me metodë induktive do të kuptojmë nisjen nga një rast i veçantë për të përgjithësuar më pas fenomenin, ndërsa me metodë deduktive do të kuptojmë të kundërtën, pra nga e përgjithshme për të kaluar në një rast specifik apo të veçantë.



Figura 5.1. Dallimet midis qasjes pozitiviste dhe qasjes postpozitiviste

Në këtë punim do të përdoret qasja pozitiviste, pra një metodë dedukive me qëllim që të arrihen qëllimet e punimit dhe njëkohësisht të sigurohet një bazë e vlefshme për të përgjithësuar rezultatet e arritura për situata specifike. Sipas Hussey & Hussey (2003) në ndryshim nga filozofia post-pozitiviste, një filozofi pozitiviste së pari ka për qëllim të sigurojë të dhëna sasiore, së dyti një qasje e tillë përdor kampione të mëdha dhe të dhënat e marra nga këto kampione janë shumë specifike dhe precize, së treti në punime të cilat ndjekin një qasje të tillë ngrihen domosdoshmërisht disa hipoteza, të cilat duhen testuar në lidhje me vlefshmërinë e tyre dhe së katërti gjatë përdorimit të një qasjeje të tillë arrihet që nga kampioni të përgjithësohen rezultatet për të gjithë popullatën.

Ka disa arsye për zgjedhjen e kësaj filozofie: **a)** në kërkimet në fushën e etikës së biznesit, qasja pozitiviste është përdorur gjerësisht (Randall & Gibson, 1990; Trevino & Weaver, 1994); **b)** ka një sërë studimesh të mëparshme, të cilat sigurojnë një bazë të vlefshme, tek e cila mund të mbështetesh për të dizenuar një model dhe skelet të punimit, i cili mund të përdoret; **c)** këto metoda ofrojnë për përdoruesit jo vetëm mundësinë për të kursyer kohë, por njëkohësisht përpjekjet dhe burimet e nevojshme për t'i realizuar ato janë më të vogla në krahasim me metodat e tjera kërkimore.

5.3. Teknika e grumbullimit të të dhënave

Popullata e marrë në studim dhe zgjedhja e kampionit

Të gjithë jemi të vetëdijshëm që roli i profesionistëve të kontabilitetit në mjedisin ekonomik të një vendi është një rol kyç dhe mjaft i rëndësishëm. Gjatë dy dekadave të fundit rastet e mashtrimeve financiare dhe falimentimit të kompanive të mëdha të njohura në nivel global kanë qenë të panumërta. Pas analizave të thella financiare të bëra nga

ekspertët për të zbuluar shkaqet e rasteve të tilla është arritur në konkluzionin se përgjegjësia bie mbi kontabilistët, të cilët akuzohen për mungesë të thellë të ruajtjes së standardeve etike gjatë ushtrimit të detyrës së tyre. Duke e parë situatën në këtë këndvështrim është normale të pranojmë se kontabilistët janë profesionistët, të cilët duke ushtruar me rigorozytet profesionin e tyre mund të japin një kontribut shumë të madh në zhvillimin ekonomik të një vendi e sidomos në vendet në zhvillim, siç është edhe Shqipëria. Duhet theksuar se kontabilistët kanë një sërë përgjegjësish ndaj përdoruesve të informacionit financiar që ato përgatisin në lidhje me performancën e njësisë për të cilën punojnë. Bazuar në këtë informacion merren pjesa më e madhe e vendimeve, të cilat përcaktojnë ecurinë e njësisë ekonomike. Nga ana tjetër kontabilistët gjatë ushtrimit të profesionit të tyre përballen pothuajse çdo ditë me çështje etike, të cilat burojnë nga fakti që këta individë kanë një përgjegjësi të dyfishtë: ndaj punëdhënësve të tyre dhe profesionit të tyre (Etherington & Schulting, 1995).

Në vendin tonë në ndryshim nga vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim vihet re se nuk ka pothuajse asnjë studim empirik të bërë në lidhje me çështjet e etikës në kontabilitet dhe kjo është arsyeja kryesore e përzgjedhjes së një teme me një fokus të tillë. Etika e kontabilistëve tanë jemi të ndërgjegjshëm që le shumë për të dëshiruar dhe nëpërmjet këtij studimi synohet që duke u bazuar në informacionin e mbledhur të jepem disa rekomandime, të cilat të përmirësojnë sadopak situatën.

Duke u nisur nga arsyetimi i mësipërm del i qartë fakti se popullata në interes të arritjes së objektivave të punimit janë të gjithë kontabilistët, të cilët ushtrojnë profesionin e tyre në vendin tonë qofshin këta të punësuar në kompanitë shqiptare apo ushtrues të lirë të profesionit.

Pas diskutimeve të gjata u mendua që puna të niste me gjetjen e kontakteve për kompanitë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë dhe njëkohësisht e kontakteve për Kontabilistët e Miratuar dhe Ekspertët Kontabël të Autorizuar. Përsa i përket përzgjedhjes së kompanive kontabilistët e të cilave do të ishin pjesë e studimit, e pamë të arsyeshme që të përqëndroheshim te kompanitë VIP të vendit tonë për arsye se këto kompani përfaqësojnë tatimpaguesit e mëdhenj dhe për t'u klasifikuar si të tillë, kushti primar është realizimi i një qarkullimi vjetor më të madh se tetë milion lekë në vit. Duke u bazuar në këtë fakt u mendua se këto kompani do të jenë më të mirorganizuara, përsa i përket strukturës organizative veçanërisht të departamentit të financës. Për të gjetur mundësitë e kontaktit për secilën prej tyre, ndihma e parë iu kërkua Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj (VIP) të Republikës së Shqipërisë, e cila u tregua e gatshme që të na siguronte informacion duke na dhënë akses në Rregjistrin e Tatimpaguesve të Mëdhenj për vitin 2015. Me qëllim që kampioni të jetë gjithëpërfshirës dhe që rezultatet e arritura të jenë sa më të sakta, u vendos që pjesë e këtij kampioni të ishin të gjitha kompanitë që ishin pjesë e rregjistrit.

Përsa u përket Kontabilistëve të Miratuar dhe Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në rregjistrin elektronik me akses të hapur të këtyre dy grupeve gjendeshin numrat e telefonit dhe e-mail-et e secilit anëtar. Mirëpo ajo që u vu re duke kontaktuar nëpërmjet telefonit me secilin prej tyre ishte që: **a)** në lidhje me Kontabilistët e Miratuar pjesa më e madhe e tyre punonin në kompanitë VIP të vendit tonë dhe pjesa tjetër nuk e ushtronin profesionin e tyre, (për shembull, kishte anëtarë që e kishin titullin dhe punonin pedagogë në universitete të ndryshme të vendit tonë); **b)** në lidhje me Ekspertët Kontabël të Autorizuar pjesa më e madhe merreshin me auditim dhe pjesa tjetër, e cila merrej edhe me mbajtjen e

kontabilitetit të kompanive të ndryshme, ishte e përfshirë në listën e personave përgjegjës për financën e kompanive VIP.

Për arsyet e sipërpërmendura u vendos përfundimisht që kampioni i studimit të përbëhej nga kontabilistët e kompanive VIP të vendit tonë pavarësisht faktit nëse ato ishin kontabilistë të integruar në departamentet e financës së këtyre kompanive apo ushtrues të lirë të profesionit.

Metoda e mbledhjes së të dhënave

Sipas Zikmund (2003), të dhënat parësore mbledhen eskuzivisht për kërkimin mbi të cilin po punohet. Ka disa metoda për mbledhjen e të dhënave parësore. Por në këtë temë janë përzgjedhur si mjet kryesor pyetësorët, të cilat Van der Stede et al., 2007 i përcakton si metodat më të përdorura për kërkimet e bëra në fushën e kontabilitetit.

Duke u bazuar në katër përmbledhjet kryesore të literaturës në lidhje me procesin e vendimmarrjes etike dhe etikën e biznesit vihet re se metoda më e përdorur është anketimi. Ka disa studiues, të cilët e gjykojnë anketimin si një mënyrë me më tepër prioritet përkundrejt eksperimenteve apo intervistave. Sipas Robertson (1993) metoda të tjera si eksperimentet dhe intervistat duhet përdorur më shpesh në fushën e etikës së biznesit me qëllim që të zgjerohet baza metodologjike e kërkimit në këtë fushë. Sipas Liedtka (1992) edhe pse intervistat janë më të vështira për t'u realizuar, ata mundësojnë një informacion më të thellë në lidhje me çështjen që merret në studim.

Për të vendosur se çfarë metode do të përdoret në këtë studim janë marrë parasysh të gjitha opinionet pro dhe kundër secilës metode dhe pas një periudhe të gjatë reflektimi u vendos që në këtë punim të përdoren pyetësorët për të mbledhur informacionin e nevojshëm.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm që fusha e etikës së biznesit është disi delikate dhe e vështirë për t'u eksploruar. Sipas Dalton & Metzger (1992) "virtualisht çdo kërkim empirik për çështje të rëndësishme të etikës së biznesit përfshin bërjen e pyetjeve, të cilat janë të ndjeshme, të turpshme, kërcënuese, stigmatizuese ose inkriminuese".

Arsyet e zgjedhjes së kësaj metode për mbledhjen e të dhënave janë disa dhe do të shpjegohen në vijim: **a)** arritja e qëllimeve dhe të qenit në konsistencë me boshtin teorik të punimit; **b)** përmbushja e nevojës për të mbledhur një sasi të madhe informacioni në bazë të të cilit, do të arrihen objektivat e vendosura; **c)** fakti që kjo metodë është përdorur gjerësisht në fushën e etikës së biznesit dhe veçanërisht në studimet e bëra në lidhje me procesin e vendimmarrjes; **d)** koha e limituar dhe njëkohësisht burimet në dispozicion për të bërë një studim të tillë.

Pra, për arsyet e sipërpërmendura në këtë punim informacioni do të mblidhet nëpërmjet shpërndarjes së një pyetësoi në kampionet e përzgjedhura, i cili ka të integruar edhe katër skenarë që kanë të bëjnë me katër raste të çështjeve etike me të cilat përballen kontabilistët gjatë ushtrimit të profesionit të tyre.

Pyetësoi dhe përmbajtja e tij

Në fushën e etikës së biznesit pyetësoi është cilësuar si një instrument fleksibël për t'u përdorur në kërkimet mbi etikën e biznesit. Ai i ndihmon kërkuesit që të mbledhin informacion në lidhje me çështjet etike me të cilat përballen në vendin e tyre të punës, në lidhje me pikëpamjet individuale rreth këtyre çështjeve dhe jo vetëm. Nëpërmjet pyetësorëve mund të mblidhet gjithashtu informacion mbi karakteristikat e vendit të punës e gjithashtu edhe në lidhje me karakteristikat demografike, të cilat më pas mund të përdoren

për të analizuar lidhjet që ekzistojnë midis këtyre faktorëve dhe opinionet e secilit pjesëmarrës.

Përdorimi i pyetësorëve në kërkimet e etikës së biznesit është një traditë e hershme ndoshta për vetë avantazhet që ofron për studiuesit një instrument i tillë.

Sipas (Hussey & Hussey, 2003), edhe pse ekziston mundësia që përveç përdorimit të pyetësorit pikëpamjet e individëve në lidhje me çështje të caktuara që shqyrtohen duke përdorur intervista, në rastet kur kërkohet mbledhja e informacionit sasior për një popullatë të caktuar dhe kur opinionet individuale mbi sjelljen janë të nevojshme është i paevitueshëm përdorimi i pyetësorëve". Pyetësi është një listë pyetjesh të strukturuar me shumë kujdes, të përzgjedhura pas disa testimeve dhe që rezultojnë në marrjen e përgjigjeve të besueshme prej popullsisë së zgjedhur. Në rastet e përdorimit të pyetësorëve padyshim që një rëndësi e veçantë i duhet kushtuar ndërtimit apo dizenjimit të tij pasi një pyetësor i ndërtuar mirë ka një ndikim të konsiderueshëm në shumë aspekte të studimit.

Sipas Oppenheim (2003) një pyetësor i ndërtuar keq nuk arrin të sigurojë përgjigje të përshtatshme për pyetjet e përfshira në studim, si pasojë konkluzionet do të kenë shumë boshllëqe, mundësia për të përgjithësuar fenomenin do të jetë e vogël dhe do të prodhojë informacion të parëndësishëm, pra do të çojë dëm materialet dhe burimet e përdorura për ta realizuar atë.

Ka disa aspekte të cilat duhet të kihen parasysh kur ndërtohet një pyetësor si: paraqitja e përgjithshme, instruksionet e sakta, formulimi i pyetjeve, radhitja e tyre sipas një mënyre të caktuar, lloji i pyetjeve që do të përdoren, gjatësia e pyetjeve e të tjera si këto.

Për ndërtimin e pyetësorit të përdorur në këtë studim janë marrë në konsideratë të gjitha rekomandimet e mësipërme. Hapat e shpjeguara në literaturë që duhet të ndiqen për

hartimin dhe kryerjen e suksesshme të tij janë përgjithësisht shumë të ngjashëm, por në mënyrë të veçantë, ky punim i është përmbajtur skemës së propozuar nga Adams et al., 2007, Van der stede et al., 2007 dhe sugjerimeve të Jackson (2009).




Figura 5.2 Hapat e ndërtimit të pyetësorit

Puna për ndërtimin e një pyetësori fillon me përcaktimin e qartë të qëllimit pse po dizenjohet ky pyetësor dhe llojin e informacionit që do të përfitohet prej tij (Adams et al., 2007). Pyetësori i përdorur në këtë punim do të shërbejë për mbledhjen e të dhënave lidhur me tri grupet e faktorëve që ndikojnë në procesin e vendimmarrjes etike dhe konkretisht informacioni në lidhje me faktorët individualë, organizativë dhe dimensionet e intensitetit

moral të çështjes etike me të cilën përballen kontabilistët shpesh gjatë ushtrimit të profesionit të tyre.

Më pas është e nevojshme të përcaktohet kampioni përmes teknikës së duhur të përzgjedhjes në mënyrë që të jetë e mundshme të përcaktohen parametrat për të gjithë popullsinë (Adams et al., 2007). Kjo çështje u shtjellua dhe u diskutua në paragrafin e mësipërm.

Për të mundësuar mbledhjen e të gjithë informacionit të nevojshëm për të arritur objektivat e punimit pyetëtori u mendua të ndahet në katër pjesë:

1. Pjesa e parë, e cila synon të mbledhë informacion në lidhje me faktorët individualë të të anketuarve dhe gjithashtu në lidhje me ekzistencën e kodit të etikës, llojin e industrisë ku operon kompania e njëkohësisht edhe për madhësinë e saj. Pyetja e parë dhe e dytë e pyetëtorit është ndërtuar për të mbledhur informacion mbi moshën dhe gjininë e të anketuarve, ndërsa pyetja e tretë dhe e katërt mbledhin informacion në lidhje me eksperiencën dhe nivelin e edukimit të të anketuarve. Secili prej këtyre pjesëmarrësve duhet të zgjedhë kategorinë së cilës i përket. Pyetja e pestë dhe e gjashtë kanë të bëjnë me madhësinë e kompanisë dhe llojin e industrisë në të cilën ajo operon. Duhet theksuar se për të matur madhësinë e organizatës ashtu sikurse pjesa më e madhe e studimeve të mëparshme, në këtë studim është përdorur numri i punonjësve. Sa më shumë punonjës të ketë një kompani, aq më e madhe është ajo. Për të përcaktuar kategoritë në lidhje me këto dy pyetje është përdorur Rregjistri i Bizneseve për vitin 2014 i botuar nga INSTAT. Sipas këtij rregjistri ka katër kategori në lidhje me madhësinë e kompanisë duke u bazuar te

numri i punonjësve. Duke u bazuar tek i njëjti burim ka tetë kategori përsa u përket llojeve të industrisë. Pyetja e shtatë e pyetësorit lidhet me Kodin e Etikës. Të anketuarve iu kërkohet që fillimisht të pohojnë ekzistencën e Kodit të Etikës në kompanitë e tyre dhe nëse Kodi ekziston, më pas të mblidhet informacion në lidhje me përmbajtjen e tij duke renditur disa nga çështjet më të rëndësishme që duhet të përmbajë domosdoshmërisht një Kod etike.

Më pas të anketuarve nëpërmjet pyetjes së radhës iu kërkohet informacion nëse Kodi i Etikës së kompanisë së tyre i përmban apo jo çështjet etike më të zakonshme, të cilat duhet t'i përmbajë çdo Kod etike pavarësisht se kujt kompanie i përket. Për të përcaktuar se cilat çështje do të përfshiheshin në vlerësimin e Kodit të etikës së kompanive, janë marrë në konsideratë kërkimet e mëparshme në fushën e etikës së biznesit ku mund të përmendim Carasco & Singh (2003) apo O'Dwyer & Madden (2006); Singh et al., 2005 etj. Dhe së fundi pyetja e fundit e kësaj pjese ka për qëllim mbledhjen e informacionit në lidhje me klimën etike të kompanisë. Sipas studimeve të mëparshme të bëra nga Victor & Cullen, 1987 e në vijim ekzistojnë nëntë lloje të klimës etike në total, të cilat mund të gjenden në një kompani. Peterson (2002) pretendon se deri në atë kohë asnjë studim nuk ka provuar se të nëntë këto lloje ekzistojnë nëpër kompani. Ashtu sikurse është përmendur edhe më parë në këtë studim do të merren në konsideratë katër lloje të klimës etike, të cilat besohet se ashtu sikurse edhe në pjesën më të madhe të kompanive të vendeve në zhvillim do të gjenden edhe në kompanitë shqiptare. Për të matur dhe përcaktuar llojin e klimës etike të secilës kompani ku punojnë kontabilistët e marrë në studim është përdorur Pyetësori i Klimës Etike i ndërtuar nga Victor & Cullen (1987). Në këtë pyetje të anketuarve u kërkohet të japin mendimin e tyre në lidhje me masën me të cilën ata bien dakord në

lidhje me gjashtëmbëdhjetë pohime. Për të shprehur mendimin e tyre, të anketuarve, u është vënë në dispozicion një shkallë me gjashtë pikë vlerësimi duke filluar nga pesë, e cila nënkupton që pohimi është plotësisht i vërtetë për të përfunduar te zero, që nënkupton se pohimi është plotësisht i gabuar. Ky instrument është përdorur gjerësisht në studimet e mëparshme (Shafer, 2007, 2009; Deconinck, 2004; Fritzsche, 2000 etj.). Për këtë arsye nuk del e nevojshme që ky instrument të paratestohet në lidhje me vlefshmërinë e tij. Format i origjinal konsiston në tridhjetë e gjashtë pohime, pra katër për secilin lloj të klimës etike, por duke qenë se këtu merren në konsideratë vetëm katër prej tyre, atëherë numri i pohimeve të përfshira është reduktuar në gjashtëmbëdhjetë.

2. Pjesa e dytë ka për qëllim mbledhjen e informacionit në lidhje me klimën etike të kompanisë dhe filozofinë personale të moralit të individit që merr vendimin. Për të arritur këtë qëllim janë përdorur instrumente të ndërtuara më parë dhe konkretisht Pyetësi i Klimës Etike i ndërtuar nga Victor & Cullen (1987) dhe Pyetësi i Pozicionit të Etikës i ndërtuar nga Forsyth. Qëllimi i kësaj pjese është mbledhja e informacionit rreth filozofisë personale të moralit të të anketuarve. Për të arritur këtë qëllim, pra për të matur filozofinë e moralit të të anketuarve është përdorur Pyetësi i Pozicionit të Etikës, i ndërtuar nga Forsyth, 1980. Ky pyetësor do të përdoret për të matur dy dimensionet e moralit, të cilat janë në fokus të këtij studimi, idealizmin dhe relativizmin. Edhe pse një instrument i ndërtuar shumë vite më parë ai i ka rezistuar kohës dhe përdoret gjerësisht edhe nga studiues të viteve të fundit, ku mund të përmendim (Greenfield, Norman, & Wier, 2008; Chan & Leung, 2006; Marques & Azevedo-pereira, 2008 etj.). Ky instrument përbëhet nga dy dimensione. Dimensio i parë shërben për të matur idealizmin dhe përbëhet nga dhjetë

pika. Dimensioni i dytë shërben për të matur relativizmin dhe përbëhet gjithashtu nga dhjetë pika. Për të njëzet çështjet është hartuar një shkallë marrëveshjeje e bazuar në pesë shkallë vlerësuese duke filluar nga njëshi, (nuk pajtohem fuqimisht) për të përfunduar me pesë,(pajtohem fuqimisht).

3. Pjesa e tretë ka për qëllim mbledhjen e informacionit në lidhje me procesin e vendimmarrjes së individit dhe dimensioneve të intensitetit moral të çështjes etike. Për të arritur këtë qëllim janë përdorur katër skenarë, të cilët kanë të bëjnë secili me nga një çështje etike të ndryshme. Për të mbledhur informacion në lidhje me secilën fazë të procesit të vendimmarrjes dhe karakteristikat e çështjes etike me të cilën përballen të anketuarit, në pjesën e tretë të pyetësorit janë ndërthurur katër skenarë. Këta skenarë kanë të bëjnë me katër çështje të ndryshme etike, të cilat mendohet të jenë çështje me të cilat hasen më shpesh kontabilistët gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Sipas (Morris & McDonald, 1995; Vitell & Hunt, 1990; Weber, 1992) skenarët janë instrumente ideale për të matur procesin e vendimmarrjes etike. Sikurse është përmendur edhe më parë, këta skenarë janë përzgjedhur për t'u përdorur në këtë studim duke qenë se kanë gjetur një përdorim të gjerë edhe në një sërë studimesh të tjera (Leitsch, 2004, 2006; Sweeney & Costello, 2009).

Çështjet e përfshira në këta skenarë janë aprovimi i raporteve të shpenzimeve të pajustificuara, manipulimi i librave të kontabilitetit, anashkalimi i politikave të kompanisë, rritja e kredive të pajustificuara. Çështjet e përfshira në këta skenarë janë aprovimi i raporteve të shpenzimeve të pajustificuara, manipulimi i librave të kontabilitetit, anashkalimi i politikave të kompanisë, rritja e kredive të pajustificuara. Këta skenarë janë

diskutuar në pjesët e mësipërme të këtij kapitulli dhe përmbajtja e plotë e tyre gjendet në shtojcën një, ku është paraqitur edhe pyetësi i plotë.

Për të vlerësuar fazat e procesit të vendimmarrjes, pjesëmarrësve u është kërkuar të vlerësojnë veprimin hipotetik të individit vendimmarrës nëpërmjet një shkalle Likert. Shkalla e renditjes Likert është përdorur gjerësisht dhe me sukses në pjesën më të madhe të studimeve, të cilat masin fazat e procesit të vendimmarrjes.

Përsa i përket fazës së parë të procesit të vendimmarrjes, pra njohjes etike, kjo fazë është matur në mënyrë direkte duke u kërkuar pjesëmarrësve që nëpërmjet shkallës Likert me pesë kategori, të shprehin mendimin e tyre në lidhje me pohimin nëse "situata e mësipërme përfshin një problem etik" (Singhapaki et al., 1996).

Faza e gjykimit etik matet në mënyrë direkte duke u kërkuar pjesëmarrësve që nëpërmjet shkallës Likert me pesë kategori të shprehin masën me të cilën bien dakord me pohimin "(Vendimmarrësi) nuk duhet ta bënte këtë veprim" (May & Pauli, 2002).

Qëllimi etik matet në të njëjtën mënyrë duke u kërkuar pjesëmarrësve të shprehin masën me të cilën bien dakord me pohimin " Nëse do të isha vendimmarrësi, unë do të bëja të njëjtin veprim" (Singhapaki et al., 1996).

Në të njëjtën kohë, përdorimi i skenarëve ka pasur për qëllim edhe mbledhjen e informacionit në lidhje me dimensionet e intensitetit moral të çështjes etike që përfshihet në secilin skenar. Kërkimet empirike në lidhje me këto karakteristika kanë qenë të limituara për shkak të vështirësisë së matjes së këtyre dimensioneve (Barnett & Valentine, 2004).

Studiues të shumtë bien dakord me faktin që në lidhje me këtë çështje ka mungesë konsistence në instrumentet matëse të këtyre dimensioneve (Bernard & Sweney, 2010). Për

të matur këto tri dimensione që lidhen me intensitetin moral të secilës çështje etike të përfshirë në secilin skenar janë përdorur tri pohime, pra një pohim për secilin dimension. (Carlson et al., 2002) pohon se, pavarësisht faktit se një pjesë e konsiderueshme studiuesish nuk janë të mendimit se një pohim i vetëm është i mjaftueshëm për të matur një dimension të intensitetit të moralit, një pohim për secilin dimension është i mjaftueshëm në kërkimet me natyrë eksploruese. Tri pohimet e përdorura në këtë punim për të matur këto tri dimensione bazohen në punimin e John (1991) dhe janë përdorur gjithashtu edhe nga studiues të tjerë (May & Pauli, 2002; McMahon & Harvey, 2006; Singhapakdi et al., 1996). Madhësia e pasojave matet nëpërmjet pohimit "Dëmi i përgjithshëm (nëse ka) si rezultat i këtij veprimi do të jetë shumë i vogël". Konsensusi social matet nëpërmjet pohimit "Shumë njerëz do të ishin dakord që ky veprim është i gabuar". Shpejtësia e shfaqjes së pasojave matet nëpërmjet pohimit "Veprimi i vendimmarrësit nuk do të shkaktojë ndonjë dëm të menjëhershëm në të ardhmen".

4. Pjesa e katërt ka për qëllim që të mbledhë informacion në lidhje me çështjet etike më të rëndësishme me të cilat përballen më shpesh kontabilistët tanë. Qëllimi i kësaj pjese është të hetohen llojet e çështjeve etike me të cilat hasen më shpesh kontabilistët tanë gjatë ushtrimit të profesionit të tyre.

Duke u bazuar në studimet e mëparshme janë radhitur gjashtëmbëdhjetë çështje etike me të cilat mendohet se mund të përballen kontabilistët në pjesën më të madhe të vendeve në zhvillim, ku bën pjesë edhe Shqipëria.

Pjesëmarrësve u kërkohet të shprehin mendimin e tyre nëpërmjet Shkallës Likert në lidhje me rëndësinë e secilës çështje të paraqitur në këtë pjesë dhe njëkohësisht në lidhje me shpeshtësinë e përballjes së tyre me këto çështje.

Në pyetësor u përdorën pyetjet e mbyllura, pra pjesëmarrësit nuk kishin mundësi të jepnin përgjigje duke përdorur fjalët e tyre, por duhej të zgjidhnin njërën nga alternativat e vëna në dispozicion. Në fushën e etikës së biznesit përdorimi i këtyre pyetjeve ka një disavantazh kryesor, përdorimi i tyre nuk merr parasysh kushtet në të cilat merren vendimet etike. Sipas De Vaus (2002) zgjedhja e llojit të pyetjeve që do të përdoren duhet të marrë parasysh disa çështje, si përmbajtja e pyetjeve, motivimi i pjesëmarrësve, mënyra e administrimit, lloji i pjesëmarrësve etj.

Pyetjet e mbyllura janë disa llojesh: kategorike, pra që kërkojnë të zgjedhësh kategorinë që përket me përgjigjen e saktë, pyetjet vlerësuese në të cilat përgjigjja e saktë jepet duke zgjedhur njërën nga shkallët e vëna në dispozicion duke nisur nga përmbledhja e literaturës së shqyrtuar për bërjen e këtij punimi vihet re se shkalla Likert është përdorur masivisht në rastet kur janë ndërtuar pyetje të mbyllura vlerësuese duke qenë se një shkallë e tillë është më e lehtë dhe më e shpejtë në përgjigje. Sipas (Easterby-Smith et al.,2002) shkalla Likert është përdorur gjerësisht në fushën e etikës së biznesit, sepse ajo është e lehtë për t'u kuptuar, nuk kërkon shumë hapësirë dhe lejon përdorimin e një shumëllojshmërie teknikash.

Duhet theksuar se gjatë dizenjimit të pyetësorit është pasur parasysh që të shmanget sa më shumë të jetë e mundur dëshira apo pamundësia e të anketuarve për t'u përgjigjur.

Qëllimi i etikës së kërkimit shkencor është të sigurojë se asnjë person nuk do të vuajë pasoja negative nga realizimi i kërkimit. Në kërkimet të cilat përdorin pyetësin, çështja më e rëndësishme është ruajtja e privatësisë së të anketuarve. Së pari, në faqen e parë të tij, ku shpjegohen edhe objektivat dhe qëllimi i punimit është printuar edhe logo e Universitetit Europian të Tiranës në mënyrë që pjesëmarrësit të ishin të bindur se kishin në duar një pyetësor, i cili do të përdorej për qëllime akademike. Në faqen e parë të pyetësit pjesëmarrësit nëpërmjet një paragrafi hyrës sigurohen për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të mbledhur prej tyre dhe materializimin e tij në një raport përfundimtar. U synua të përdorej një gjuhë e thjeshtë dhe familjare për ta bërë atë të kuptueshme nga të gjithë pjesëmarrësit.

Skenarët e integruar në të u vendosën në fund për vetë faktin se ata kanë të bëjnë me çështje të nxehta dhe prezantimi i pjesëmarrësve që në fillim me to, do t'i bënte të ngurronin t'i përgjigjeshin pyetësit.

Për të bërë të mundur që pjesëmarrësit të ishin të sigurt në lidhje me këtë pjesë të pyetësit, iu shtua në fillim edhe një parathënie e shkurtër mbi qëllimin e tij, arsyet e mbarëvajtjes dhe njëkohësisht edhe instruksionet për plotësimin e tij. Pjesëmarrësit u informuan se çdo informacion do të ishte konfidencial dhe do të ruhej privatësia e tij në çdo rast.

Duke u nisur nga mënyra e shpërndarjes, pyetësit mund të klasifikohen në disa lloje duke filluar nga pyetësit on-line e për të vazhduar me pyetësit e shpërndarë me postë, ata të bërë nëpërmjet telefonit dhe pyetësit e shpërndarë personalisht.

Në këtë punim duke qenë se kampioni i marrë në shqyrtim është voluminoz, së pari u përjashtua mundësia e shpërndarjes së pyetësorëve, personalisht duke hequr dorë në këtë

mënyrë nga avantazhet që ata kanë, pra nga mundësia e shpjegimit gojarisht të qëllimit dhe objektivave të studimit dhe shkalla më e lartë e përgjigjeve.

Në këtë punim u përzgjodh mënyra e shpërndarjes së pyetësorëve nëpërmjet postës elektronike, sepse vendndodhja e njësive të marra në studim ishte në distanca të konsiderueshme, gjë që e vështirësonte së tepërmi shpërndarjen personalisht të tyre.

Nga ana tjetër është marrë në konsideratë shpërndarja e tyre nëpërmjet Postës Shqiptare, por kjo alternativë është përjashtuar për vetë faktin se ky institucion nuk siguron një shërbim cilësor e nga ana tjetër kostoja do të ishte e konsiderueshme. Shpërndarja e pyetësorëve nëpërmjet postës elektronike u gjykua se ishte mënyra më e volitshme për t'u përdorur në këtë studim. Shpërndarja e pyetësorëve me postë elektronike, padyshim sikurse çdo mënyrë tjetër shpërndarjeje ka avantazhet e veta.

Pyetësorët e shpërndarë me postë elektronike, së pari janë më pak të kushtueshëm veçanërisht kur bëhet fjalë për kampione të mëdha dhe së dyti, këto lloj pyetësorësh mund të përmbajnë pyetje më të gjata dhe më të komplikuar duke qenë se pjesëmarrësit mund ta shohin dhe rilexojnë pyetjen disa herë në mënyrë që të japin përgjigje më të sakta. Së fundi këta pyetësorë lejojnë që në ta të integrohen edhe figura si pjesë e pyetjeve të caktuara.

Në këtë këndvështrim duke qenë se madhësia e kampionit të përzgjedhur për t'u studiuar është e konsiderueshme dhe veçanërisht duke u nisur nga lloji i pyetjeve të përfshira në pyetësor dhe fakti që në ta ishin integruar edhe katër skenarë, u pa më e arsyeshme që ata të shpërndaheshin nëpërmjet postës elektronike. Një tjetër arsye, pse u përzgjodh kjo formë shpërndarjeje ishte disponimi i adresave elektronike të të gjitha kompanive VIP, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë. Nga ana tjetër disavantazhi kryesor i

pyetësorëve të shpërndarë në këtë formë është niveli i ulët i marrjes së përgjigjeve, pasi në këto raste individët e përfshirë në studim janë më pak të detyruar t'i plotësojnë ata. Për të rikuperuar deri në një farë mase këtë disavantazh pasi u bë shpërndarja e pyetësorëve në adresat e e-mail-it u kontaktuan të gjithë shefat e financës së kompanive për t'u vënë në dijeni në lidhje me qëllimin e punimit dhe rëndësisë që kishte plotësimi i pyetësorëve prej tyre për të arritur këtë qëllim.

Me qëllim që të rritej besueshmëria dhe vlefshmëria e matësve të përdorur në pyetësor dhe për t'u siguruar që gjuha e përdorur është e qartë dhe e kuptueshme nga pjesëmarrësit, pyetësori iu nënshtrua fazës së pilotimit.

Për të realizuar këtë fazë pyetësori iu shpërnda pesë Ekspertëve Kontabël të Rregjistruar që ushtronin profesionin e tyre në rrethin e Elbasanit dhe pesë kontabilistëve që punonin në kompanitë VIP në Elbasan.

Përveç disa sugjerimeve të vogla në lidhje me gjuhën e përdorur nuk u morën vërejtje përsa i përket gjatësisë së pyetësorit apo mënyrës së ndërtimit të tij.

Skenarët

Sipas Alexander & Becker (1978) skenarët përkufizohen si "përshkrime të shkurtra të një personi ose situatë shoqërore, e cila përmban referenca të sakta mbi ata që mendohet të jenë faktorët më të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes apo gjykimit të të anketuarve."

Përdorimi i skenarëve ndihmon në standardizimin e stimuljeve shoqërore midis të të anketuarve dhe në të njëjtën kohë e bëjnë situatën e vendimmarrjes më reale.

Skenarët janë përdorur gjerësisht në fushën e etikës së biznesit si pjesë e instrumenteve të kërkimit, por një përdorim më i gjerë i tyre vihet re veçanërisht në studimet mbi procesin e vendimmarrjes. Ka disa arsye pse skenarët kanë gjetur një përdorim të gjerë në studimet

empirike në lidhje me vendimmarrjen. Së pari, ata mundësojnë observimin e sjelljeve me interes në fusha ku observimi i drejtëpërdrejtë nuk është i mundur. Së dyti, evitojnë nevojën që pjesëmarrësit të tregojnë raste që lidhen me sjelljen joetike nga eksperiencia e tyre personale apo se çfarë do të bënin në situata të tilla.

Skenarët bëjnë të mundur që studiuesit t'i prezantojnë pjesëmarrësit me probleme aktuale, të cilat kërkojnë një përpjekje minimale për t'u përgjigjur.

Në këtë studim janë përdorur katër skenarë të përdorur edhe më parë në studime të këtij lloji. Këta skenarë janë hartuar fillimisht nga Instituti i Kontabilistëve të Drejtimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe janë përmbledhur më pas nga Flory et al., 1992 me qëllim për t'u përdorur në punimin e tyre.

Më pas këta skenarë janë përdorur në studime të ndryshme në fushën e kontabilitetit ku mund të përmenden Sweeney & Costello (2009), apo Leitsch, (2004).

Këta skenarë përmbajnë disa çështje etike praktike me të cilat kontabilistët përballen në vendin e tyre të punës. Njëkohësisht është gjykuar se ata janë të përshtatshëm edhe për studentët e kontabilitetit duke pasur parasysh që në universitet ata marrin njohuritë e nevojshme për të përballuar me sukses situata të tilla kur zenë vendet e tyre të punës. Në mënyrë që skenarët të jenë sa më të kuptueshëm dhe që pjesëmarrësit ta ndjejnë veten sa më të familjarizuar me ta, atyre iu bënë disa ndryshime të vogla në lidhje me emrat e përdorur.

Në vijim do të jepet një paraqitje e shkurtër mbi përmbajtjen e secilit prej tyre. Në skenarin e parë bëhet fjalë për një drejtues, i cili është përfshirë në bërjen e shpenzimeve të pajustificueshme, të cilat pretendon se duhet t'i aprovohen çdo herë nga drejtuesi i lartë i kompanisë. Në këtë rast në dilemë është kontabilisti, të cilit i duhet të aprovojë këto

shpenzime të pajustificuara, i detyruar nga presioni që ushtron te ky individ drejtuesi i tij duke i thënë se edhe nëse ai do të ankohet te drejtuesit e lartë të kompanisë nuk do të gjejë mbështetje tek ata individë. Në skenarin e dytë çështja etike që trajtohet është manipulimi i shifrave të kompanisë. Në dilemë në këtë skenar gjendet një kontrollor, të cilit i është thënë nga shefi i tij i financës që të bëjë çdo gjë që është e nevojshme që fitimet e kompanisë të jenë pozitive. Shefi i thotë kontrollorit që ai duhet të shtyjë disa transaksione deri në periudhën tjetër kontabël. Edhe pse kjo mund të jetë një praktikë e përdorur shpesh nga kompanitë e vendit tonë padyshim që është e gabuar.

Në skenarin e tretë një kontabilisti i kërkohet të blejë një sistem të ri kompjuterik gjë që mund të bëhet vetëm duke e klasifikuar shpenzimin e bërë për këtë sistem kompjuterik si një shpenzim operativ dhe si një shpenzim kapital.

Dhe skenari i katërt ka të bëjë me zgjatjen e pajustificuar të shpenzimeve për kredi dhe në thelb do të tregojë që rrethanat personale të kontabilistit luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e marrjes së vendimeve.

Sipas Flory et al.,1992 këta skenarë padyshim që lidhen me sigurinë në punë të kontabilistëve, por nga ana tjetër të gjithë kontabilistët e përfshirë në ta janë të shqetësuar më tepër për interesat e kompanisë së tyre. Vetëm në skenarin e fundit vihen më tepër në dukje rrethanat personale. Pas secilit skenar pjesëmarrësve u kërkohet që të japin mendimin e tyre në lidhje me gjashtë çështje nëpërmjet një shkalle pesë pikëshe.

5.4. Mënyra e shpërndarjes së pyetësorit

Ka disa mënyra përsa i përket shpërndarjes së pyetësorit duke filluar nga shpërndarja e tyre personalisht te pjesëmarrësit në studim, shpërndarja e tyre nëpërmjet postës apo shpërndarja e tyre nëpërmjet e-mail-it etj. Pyetësorët e hartuar për të arritur qëllimet e këtij punimi janë shpërndarë nëpërmjet e-mail-it. Ka disa arsye të cilat justifikojnë vendimin për zgjedhur këtë mënyrë shpërndarjeje. Sikurse u përmend më herët në këtë punim popullata në interes të këtij punimi është numri total i kontabilistëve të vendit tonë. Kjo popullatë në vetvete përbëhet nga Kontabilistët e Miratuar, Ekspertët Kontabël të Autorizuar dhe kontabilistët, të cilët punojnë në kompani private. Për arsyet e përmendura edhe në pjesën që diskuton popullatën dhe kampionin e këtij punimi janë shpjeguar hollësisht arsyet pse kampioni do të përfshinte vetëm kontabilistët, të cilët punonin në kompanitë VIP të vendit tonë. Në këto kushte për të shpërndarë pyetësorin ishin të nevojshme adresat elektronike të të gjitha kompanive VIP aktive të vendit tonë. Këto adresa u vunë në dispozicionin tonë nga ana e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj. Në total në Rregjistrin e Tatimpaguesve të Mëdhenj ishin listuar 787 kompani, prej të cilave 16 ishin çrregjistruar gjatë vitit 2015. Njëkohësisht në Rregjistër nuk kishte asnjë mundësi kontakti për 90 kompani. Këtu duhet përmendur që për këto kompani nuk kishte informacion as për adresat e e-mail-it dhe as numrat e telefonit të administratorëve të tyre. Në të gjitha rastet kur ishin të disponueshëm numrat e telefonit u kontaktuan administratorët për të marrë prej tyre adresat e e-mail-it. Gjithashtu u vu re se në rregjistër kishte 70 adresa e-mail-i të përsëritura. Arsyeja lidhet me faktin që ose i njëjti person X është administrator njëherësh i dy ose tri kompanive dhe për të trija këto është në dispozicion e njëjta adresë e-mail-i, ose që një zyrë kontabiliteti ose një adresë e-mail-i e një eksperti kontabël apo e një kontabli të miratuar përsëritet disa herë,

sepse ai mban njëherësh kontabilitetin e disa kompanive VIP. Në këto kushte nuk është e logjikshme që të njëjtit person t'i niset pyetësoni me e-mail për çdo kompani, të cilën ai e ka klient, sepse individi i cili merr vendimet etike është i njëjti. Për këtë arsye u përjashtuan të gjitha adresat e dubluara.

Tabela 5.1. Të dhëna mbi kampionin e marrë në studim

Numri i kompanive të listuara në rregjister	787 kompani
Kompani të çrregjistruara në vitin 2015	16 kompani
Kompani për të cilat nuk kishte informacion mbi mundësitë e kontaktit	90 kompani
Adresa të përsëritura	70 adresa
Kompani të marra në studim	571 kompani

Në përfundim nga 787 kompani që ishin në rregjister vetëm për 571 prej tyre ishte e mundur të merrnin pjesë në studim. Kampioni i këtij studimi përfshiu të gjitha këto kompani, pra secilës kompani iu nis pyetësoni me e-mail, nëpërmjet të cilit pjesëmarrësit informoheshin për qëllimin e studimit, konfidencialitetin e informacionit të mbledhur dhe ruajtjen e privatësisë. Sigurisht që zgjedhja e kësaj mënyre shpërndarjeje justifikohet nga disa arsye. Së pari, marrja në studim e një kampioni të tillë të kushtëzon në zgjedhjen e një mënyre të tillë shpërndarjeje. Kompanitë VIP kishin një shpërndarje gjeografike nëpër të gjithë Shqipërinë dhe kontaktimi i tyre personalisht për të shpërndarë pyetësonin ishte një proces i vështirë, me kosto të konsiderueshme dhe që kërkonte një periudhë kohore relativisht të gjatë. Njëkohësisht, në këtë studim u pa më e arsyeshme që të zgjidhej kjo mënyrë shpërndarjeje, sepse në fund të pyetësonit u integruan edhe katër skenarë, të cilët kishin për qëllim që të masnin tri fazat e procesit të vendimmarrjes etike dhe tri dimensionet e

intensitetit moral të çështjes etike me të cilën përballlet kontabilisti. Në të tilla raste shpërndarja e pyetësorëve nëpërmjet e-mail-it është më e përshtatshme, sepse pjesëmarrësit kanë mundësi që ta lexojnë disa herë skenarin dhe të japin përgjigje më të sakta. Për më tepër, studiues të ndryshëm pranojnë faktin se fusha e etikës së biznesit dhe veçanërisht çështjet e etikës në kontabilitet janë shumë delikate dhe kjo formë shpërndarjeje e bën më të lehtë dhe më pak të sikletshëm procesin e plotësimit të tij nga pjesëmarrësit. Pa dyshim, ashtu sikurse çdo formë tjetër shpërndarjeje kjo formë e zgjedhur për t'u përdorur në këtë punim ka edhe disavantazhet e veta. Kur pyetësorët shpërndahen nëpërmjet e-mail-it pjesëmarrësit privohen nga mundësia që atyre t'u shpjegohet gojarisht qëllimi i studimit, ruajtja e konfidencialitetit dhe t'u japin instruksionet e nevojshme në lidhje me plotësimin e pyetësorit në momentin që ata janë duke e plotësuar atë. Në rastet kur pyetësorët shpërndahen personalisht në një farë mënyre pjesëmarrësit janë të imponuar ta plotësojnë atë, ndërsa kur pyetësorët shpërndahen nëpërmjet e-mail-it pjesëmarrësit nuk janë aspak të imponuar ta plotësojnë pyetësorin dhe kjo e metë çon zakonisht në norma më të ulëta të kthimit të përgjigjeve të pyetësorëve të shpërndarë në këtë mënyrë. Nga 571 pyetësorët e shpërndarë u kthyen vetëm 230 të plotësuar. Shkalla e kthimit të përgjigjeve në këtë studim është :

Shkalla e kthimit të përgjigjeve = Numrin e përgjigjeve të kthyer / Numrin e pyetësorëve të shpërndarë = $230/571 = 0.403 = 40.3\%$

Ky është një rezultat shumë i kënaqshëm nëse marrim parasysh faktin se kjo formë e shpërndarjes së pyetësorëve zakonisht siguron një shkallë të ulët të kthimit të përgjigjeve.

5.5. Përpunimi i të dhënave

Pasi u mblodhën, të dhënat u koduan dhe u hodhën në një format të veçantë për t'u përpunuar në SPSS 20.0. Në përputhje me studimet e mëparshme në lidhje me procesin e vendimmarrjes etike, për analizimin e të dhënave u përdorën testet parametrike. Përdorimi i këtyre lloj testeve kërkon që të plotësohen disa kushte paraprake. Sikurse do të diskutohet në kapitullin në vijim këto kushte plotësohen dhe lejojnë përdorimin e këtyre lloj testeve. Për analizimin e të dhënave dhe arritjen e qëllimit të këtij punimi janë përdorur disa teknika statistikore. Frekuenca është përdorur për disa nga të dhënat demografike të studimit si mosha, gjinia, niveli i edukimit, eksperiencia, madhësia e organizatës dhe lloji i industrisë. Faktorët e marrë në konsideratë në këtë punim mund të ndahen në dy grupe: variabla kategorikë, ku bëjnë pjesë mosha, gjinia, niveli i edukimit, eksperiencia, madhësia e kompanisë, lloji i industrisë, etj dhe në variabla të vazhdueshëm, ku bëjnë pjesë filozofia personale e moralit, dimensionet e intensitetit moral apo klima etike e kompanisë. Në këto kushte për të bërë një testim të saktë të nënhipotezave që lidhen me këta faktorë është e nevojshme të zgjidhen testet e duhura. Në këtë punim për të testuar ndikimin e variablave kategorikë në procesin e vendimmarrjes etike janë përdorur One-way between-groups Analyses of Variance (ANOVA) dhe Independent Samples t-test. Për të testuar ndikimin e variablave të vazhdueshëm në procesin e vendimmarrjes etike është përdorur analiza regressive.

5.6. Konkluzione

Ky kapitull filloi me përshkrimin e debatit filozofik në lidhje me metodologjinë dhe përcaktimin e qasjes metodologjike që do të përdoret në këtë punim. Ashtu sikurse është pohuar në pjesën e parë të kapitullit në këtë punim përdoret qasja pozitiviste, e cila mundëson arritjen e qëllimit të punimit dhe përgjithësimit të rezultateve. Popullata e studimit dhe kampioni i përzgjedhur prej saj u përshkruan gjithashtu në këtë kapitull. Në fokus të këtij punimi janë të gjithë kontabilistët që ushtrojnë profesionin e tyre në Republikën e Shqipërisë. Nga kjo popullatë u përzgjedhën kontabilistët që ushtrojnë profesionin e tyre në kompanitë VIP të vendit tonë, të cilat klasifikohen në grupin e Tatimpaguesve të Mëdhenj. Mbledhja e të dhënave u realizua nëpërmjet shpërndarjes së një pyetëso, në të cilin ishin integruar edhe katër skenarë për katër çështje etike të ndryshme. Të dhënat e mbledhura u përpunuan nëpërmjet programit SPSS.

KAPITULLI VI: ANALIZA EMPIRIKE E TË DHËNAVE

Ky kapitull ka si fokus prezantimin e rezultateve të mbledhura nga shpërndarja e pyetësorëve dhe përqasjen e tyre me objektivat e kërkimit. Ai nis me analizën deskriptive të kampionit të marrë në studim në seksionin e parë. Në seksionin e dytë të kapitullit paraqiten rezultatet përsa u përket çështjeve etike, të cilat kanë rezultuar si më të rëndësishme për kontabilistët tanë. Në seksionin e tretë bëhet analiza ekonometrike e të gjitha evidencave të mbledhura dhe shpjegimi i ndikimit të tyre në procesin e vendimmarrjes. Në fund jepen konkluzionet e kapitullit.

6.1. Analiza deskriptive e faktorëve

Për të bërë analizën deskriptive të kampionit të përzgjedhur do të bazohemi te të gjithë faktorët demografikë të marrë në konsideratë në këtë punim. Këta faktorë janë mosha, gjinia, niveli i edukimit, eksperiencia, profesioni i pjesëmarrësve dhe ekzistenca e Kodit të Etikës në kompanitë në të cilat punojnë kontabilistët që morën pjesë në studim.

Sikurse vihet re edhe nga tabela 6.1 pjesa më e madhe e individëve, të cilët morën pjesë në studim janë të grupmoshës më shumë se dyzet vjeç, pra gati 40% e tyre. Kategoria e dytë që radhitet pas grupmoshës më tepër se dyzet vjeç është ajo 30-35 vjeç. Kjo kategori zë 30% të të gjithë kampionit.

Sikurse vihet re nga tabela 6.2 në studim rreth 60 % e të anketuarve kanë qenë femra dhe vetëm 40% kanë qenë meshkuj. Duke iu referuar tabelës 6.3, nga kryqëzimi i këtyre dy faktorëve vihet re se nga grupmosha më tepër se dyzet vjeç, pjesa dominuese janë femra (54 nga 90) 60% dhe ky fakt vihet re pothuajse për secilën kategori. Një shpërndarje e tillë tregon që në të kaluarën ka pasur një tendencë më të madhe të femrave për t'u arsimuar dhe punuar në fushën e kontabilitetit. Kjo tendencë ka ardhur duke u zbehur me kalimin e kohës dhe kjo duket edhe në treguesit që i përkasin grupmoshës më pak se 30 vjeç për të cilën shpërndarja midis meshkujve dhe femrave është e barabartë.

Përsa i përket nivelit të edukimit nga tabela 6.4 vihet re se pjesa më e madhe e pjesëmarrësve, 60 % e tyre janë me master profesional, por duhet përmendur gjithashtu se 31% e tyre janë me master shkencor. Përsa i përket eksperiencës nga tabela 6.5 shikojmë që

37.8% e të intervistuarve kanë eksperiencë nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe më pas renditet kategoria pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet eksperiencë dhe konkretisht me 30.4%. Gjithashtu nga kryqëzimi i treguesve për këta dy faktorë në tabelën 6.6 vihet re se femrat janë dominante në dy kategoritë e eksperiencës.

Nga tabela 6.7 vihet re se 33.5% e pjesëmarrësve në studim punojnë në kompani, të cilat nuk janë klasifikuar në asnjërën nga kategoritë konkrete. Duhet përmendur se klasifikimi i llojeve të kompanive është bërë në përputhje me kategoritë e përcaktuara nga INSTAT në Rregjistrin e Bizneseve (2014). Arsyeja e përqëndrimit të pjesës më të madhe të pjesëmarrësve në studim në kategorinë “Shërbime të tjera” lidhet me faktin që një pjesë e konsiderueshme e kompanive VIP në vendin tonë nuk kanë një strukturë organizative të mirëfilltë dhe si rezultat nuk kanë departament finance. Në këto kushte kontabiliteti i tyre mbahet nga kontabilistë apo ekspertë kontabël, të cilët janë ushtrues të lirë të profesionit (të licensuar). Dhe këta të fundit në momentin kur kanë plotësuar pyetësin domosdoshmërisht e kanë klasifikuar veten e tyre në kategorinë, shërbime të tjera. Vihet re se një pjesë e konsiderueshme e kontabilistëve pjesëmarrës në studim punojnë në kategorinë “Akomodim dhe shërbim ushqimor” dhe në kategorinë “Ndërtim”. Një shpërndarje e tillë është në përputhje me trendin në rritje që kanë pasur këta sektorë gjatë viteve të fundit.

Në lidhje me madhësinë e kompanisë, e cila është matur nëpërmjet numrit të punonjësve, nga tabela 6.9 vihet re se pjesa më e madhe e kontabilistëve punojnë në kompani relativisht të mëdha, rreth 47% e tyre.

6.2. Çështjet etike me të cilat përballen kontabilistët shqiptarë

Ashtu sikurse është përcaktuar edhe më parë qëllimi i këtij studimi, ishte jo vetëm përcaktimi i lidhjes së faktorëve individualë, organizativë dhe dimensioneve të intensitetit moral me procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve shqiptarë, por gjithashtu edhe identifikimi i çështjeve etike më të rëndësishme me të cilat hasen më shpesh kontabilistët e vendit tonë. Për të arritur këtë qëllim në pjesën e fundit të pyetësorit u listuan shtatëmbëdhjetë çështje etike të ndryshme, të cilat mendohej se do të ishin domethënëse për kontabilistët shqiptarë. Për të përcaktuar listën e këtyre çështjeve iu referuam literaturës së deritanishme dhe veçanërisht literaturës së vendeve në zhvillim. Duke iu referuar studimit të bërë nga Fisher & Lovell (2000) u pa e arsyeshme që në studim të përfshiheshin këto shtatëmbëdhjetë çështje. Pjesëmarrësve në studim iu kërkua të shprehnin mendimin e tyre në lidhje me rëndësinë e secilës çështje dhe njëkohësisht në lidhje me shpeshtësinë e ballafaqimit me secilën çështje. Nëpërmjet përpunimit të informacionit të mbledhur, i cili paraqitet në tabelën 6.10 dhe ilustron edhe nga grafiku 6.1 është arritur në përfundimin se çështja etike më e rëndësishme sipas mendimit të kontabilistëve shqiptarë është largimi i kontabilistëve nga puna, sepse ky individ ka parime etike të ndryshme nga ato të kompanisë. Pothuajse njëloj të rëndësishme shfaqen edhe manipulimi i treguesve kontabël (psh. nëpërmjet metodave të kostos) me qëllim që të arrihet fitimi i buxhetuar, shpërndarja e informacionit konfidencial tek individët jashtë kompanisë, kontabilistët thyejnë një rregull në rastet kur mendojnë se avantazhet e kompanisë janë më të mëdha sesa kosto etike, kontabilistët përdorin informacionin e brendshëm për përfitime personale. Këto çështje kanë përqindje vlerësimi si “shumë të rëndësishme” ose “të rëndësishme” nga

74.8% deri në 67% dhe renditet si pesë çështjet etike më të rëndësishme për kontabilistët shqiptarë.

Përqindjet e llogaritura për secilën çështje shprehin masën me të cilën secila nga këto çështje etike është vlerësuar si shumë e rëndësishme dhe e rëndësishme. Vihet re se maksimumi i vlerësimit si shumë e rëndësishme apo e rëndësishme është 74.8 %, ndërsa minimumi është 55.2%.

Njëkohësisht pjesëmarrësit kanë shprehur mendimin e tyre në lidhje me shpeshhtësinë e përballjes me këto lloj çështjesh. Sikurse vihet re edhe nga tabela 6.11, pesë çështjet me të cilat hasen më shpesh kontabilistët janë: përdorimi i pushtetit për të shtrembëruar apo parandaluar debatet e hapura apo diskutimet në lidhje me politikat edhe vendimet e kompanisë, një kontabilist detyrohet ta lërë kompaninë, sepse ka parime etike të ndryshme nga ato të kompanisë, kontabilistët thyejnë një rregull në rastet kur mendojnë se avantazhet e kompanisë janë më të mëdha sesa kosto etike, manipulimi i treguesve kontabël (psh. nëpërmjet metodave të koston) me qëllim që të arrihet fitimi i buxhetuar, rregullimi i informacionit ose thyerja e rregullave për të evituar keqtrajtimin nga konsumatorë. Përqindja e vlerësimit të këtyre çështjeve si çështje që hasen “shumë shpesh” ose “shpesh” variojnë nga 13% deri në 10.9%.

6.3. Analiza empirike e të dhënave

Ashtu siç u përmend edhe në kapitullin e mëparshëm, testet ANOVA dhe Independent Samples t-test janë testet që do të përdoren për të testuar ndikimin e disa faktorëve individualë dhe organizativë në procesin e vendimmarrjes etike. Arsyeja kryesore

e zgjedhjes së këtyre testeve lidhet me faktin se këta faktorë përfaqësojnë variabla të pavarur. Njëkohësisht, në përputhje me rekomandimet e disa autorëve (Field, 2009; Tabachnick & Fidell, 2007), janë kryer testet e nevojshme për të parë nëse plotësohen kushtet për përdorimin e këtyre testeve. Kushtet më të zakonshme që duhen plotësuar për kryerjen e tyre janë: **a)** ndryshorja e varur ka shpërndarje normale për çdo popullim, **b)** variancat e popullimeve janë të barabarta, **c)** vrojtimit janë të pavarura. Për të testuar plotësimin e këtyre kushteve janë përdorur teste ndihmëse si për shembull testi Levene për normalitetin apo testi Shapiro-Wilk. Për dimensionet e intensitetit moral të çështjes etike është bërë analiza regressive lineare. Arsyeja e përdorimit të kësaj teknike lidhet me faktin që tri dimensionet e marra në konsideratë janë variabla të pavarura jokategorike.

Ashtu sikurse është përcaktuar edhe në kapitullin e dytë të këtij punimi, pyetjet kërkimore të këtij punimi janë katër. Rezultatet e marra nga përpunimi i informacionit të mbledhur në lidhje me pyetjen e parë kërkimore i analizuan në seksionin e mëparshëm. Për t'i dhënë përgjigje tri pyetjeve të tjera, të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e indikimit të faktorëve individualë, organizativë dhe dimensioneve të intensitetit moral të çështjes etike në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve të vendit tonë janë ngritur disa nënhipoteza për secilën prej tyre.

Pyetja e parë kërkimore e ngritur në këtë punim është:

Çfarë ndikimi kanë faktorët individualë në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve shqiptarë? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje janë ngritur pesë nënhipoteza.

1. *Nënhipoteza e parë lidhet me gjininë.*

H_0 : Gjinia nuk ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike (1)

H_a : Gjinia ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike.

Për të bërë testimin e kësaj hipoteze, për të parë nëse ka dallime të rëndësishme mes meshkujve dhe femrave në procesin e vendimmarrjes etike, është përdorur Independent Samples t-test, duke supozuar variancat e popullimeve (meshkujve dhe femrave) të barabarta dhe popullimet normale. Kontrolli është bërë për nivelin e besimit prej 95 %, pra $\alpha = 5\%$.

Kontrollojmë së pari plotësimin e supozimeve të vetë modelit. Hetojmë, nëse ndryshorja e varur (vendimmarrja etike) ka shpërndarje normale.

H_0 : Ndryshorja e varur ka shpërndarje normale

H_a : Ndryshorja e varur nuk ka shpërndarje normale

Për të bërë kontrollin, është kryer testi Shapiro-Wilk dhe nga përpunimi i të dhënave, sikurse vihet re edhe në tabelën 6.12 sig. = .019 $\alpha = 0.05$. Konkludojmë se ndryshorja nuk ka shpërndarje normale.

Duke bërë standardizimin e vlerave të ndryshores, identifikohen vlerat e gabuara, të cilat shënohen te vlerat e munguara. Duke kontrolluar tani për kushtin e normalitetit, nga përpunimi kanë rezultuar tabelat 6.13; 6.14; 6.15.

Nga tabela 6.15, shohim se sig. = .085 $\alpha = .05$. Kjo do të thotë se H_0 nuk hidhet poshtë, pra ndryshorja ka shpërndarje normale.

Në këto kushte kryhet Independent Samples t-test për të hetuar hipotezën fillestare (1). Nga përpunimi në tabelën 6.16 rezulton se në studim morën pjesë 135 femra dhe 88 meshkuj.

Nga tabela 6.17 “Independent Samples Test”, te rreshti i parë, shohim se $\text{sig.} = .160 > \alpha = .05$. Kjo tregon se nuk ka diferenca të rëndësishme mes variancave të popullimeve (meshkujve dhe femrave). Po te ky rresht, meqë $\text{sig. (2-tailed)} = .642 > \alpha = .05$, konkludojmë se nuk mund të hedhim dot poshtë hipotezën bazë të (1). *Kjo do të thotë se na rezulton se nuk ka diferenca të rëndësishme mes meshkujve dhe femrave për sa i përket vendimmarrjes etike, pra gjinia nuk ka ndikim të rëndësishëm në tri fazat e para të procesit të vendimmarrjes etike të kontabilistëve.*

Ashtu sikurse është diskutuar edhe në kapitullin e dytë në të cilin është bërë një analizë e hollësishme e studimeve të mëparshme në lidhje me procesin e vendimmarrjes etike dhe faktorëve që e ndikojnë atë, rezultatet në lidhje me ndikimin e gjinisë në këtë proces janë ende të paqëndrueshme. Rezultati i arritur është në përputhje edhe me një numër të konsiderueshëm të rezultateve të arritura nga studimet e mëparshme. Këtu mund të përmendim studimet e Deshpande (1997); Roozen, De Pelsmacker, & Bostyn (2001); Smith & Oakley (1997); Barnett & Valentine (2004), Stedham, Yamamura, & Lai (2008), Nill & Schibrowsky (2005) etj. Gjithashtu rezultati i arritur është veçanërisht në përputhje me studimin e Sweeney & Costello (2009), të cilët përdorën skenarë të ngjashëm për të matur fazat e procesit të vendimmarrjes të studentëve të kontabilitetit dhe arritën në

përfundimin se midis meshkujve dhe femrave nuk kishte ndryshime në procesin e vendimmarrjes etike.

Ky rezultat mbështet teorinë strukturore, e cila sugjeron se mjedisi i punës, struktura e kostove dhe shpërblimeve në vendin e punës e tejkalojnë ndikimin e ndryshimeve gjinore, të cilat shkaktohen nga socializimi i hershëm (Betz et al., 1989). Si rezultat meshkujt edhe femrat do t'u përgjigjen në të njëjtën mënyrë çështjeve etike me të cilat do të përballen në vendin e tyre të punës (Comunale et al., 2006).

2. *Nënhipoteza e dytë lidhet me ndikim e moshës në procesin e vendimmarrjes etike.*

H_0 : Grupmosha nuk ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike (2)

H_a : Grupmosha ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike

Për të bërë testimin e hipotezës, për të parë nëse ka dallime të rëndësishme mes grupmoshave të ndryshme në procesin e vendimmarrjes etike, është përdorur one-way ANOVA, duke supozuar se:

1. Ndryshorja e varur (vendimmarrja etike) ka shpërndarje normale për çdo popullim
2. Variancat e popullimeve janë të barabarta
3. Vrojtimet e pavarura

Kontrolli është kryer për nivelin e besimit prej 95 %, pra $\alpha = 5\%$. Për të bërë krahasimet e shumëfishta, është përdorur LSD e Fisher-it. Nga përpunimi

kanë rezultuar tabela 6.18; 6.19; 6.20. Nga tabela 6.20 (ANOVA), meqë sig. = .001 α ,
konkludojmë se grupmosha ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike.

Nga Tabela 5.16, duke bërë krahasimet dyshe me LSD e Fisher-it, rezulton se grupmosha 30-35 vjeç ka dallime të rëndësishme nga grupmoshat e tjera përsa i përket vendimmarrjes etike. Rezultati i arritur është në përputhje me shumicën e studimeve të mëparshme. Nill & Schibrowsky (2005); Cagle & Baucus (2006); McMahon & Harvey (2007) kanë arritur në përfundimin se mosha ka ndikim pozitiv dhe të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike. Ky përfundim mbështetet nga Teoria e Zhvillimit të Moralit Njohës e Kohlberg. Sipas kësaj teorie mosha ka një ndikim pozitiv në zhvillimin e moralit dhe përgjithësisht individët lëvizin nga fazat e ulëta të gjykit moral drejt fazave më të larta me rritjen e moshës së tyre.

3. Nënhipoteza e tretë lidhet me ndikimin e nivelit të edukimit të individit në procesin e vendimmarrjes etike.

Ho: Niveli i edukimit nuk ka ndikim të rëndësishëm në tri fazat e para të procesit të vendimmarrjes etike (3)

H_a : Niveli i edukimit ka ndikim të rëndësishëm në tri fazat e para të procesit të vendimmarrjes etike

Për të bërë kontrollin, është kryer testi ANOVA dhe më pas përdor LSD Fisher-it për kontrollet e shumëfishta. Nga përpunimi kanë rezultuar tabelat 6.22; 6.23; 6.24.

Nga tabela 6.24 ,vihet re që $\text{sig.} = .541$ $\alpha = .05$. Në këto kushte, nuk mund të hedhim dot poshtë hipotezën bazë të (3). *Kjo do të thotë se na rezulton që niveli i edukimit nuk ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike.*

4. *Nëhipoteza e katërt lidhet me ndikimin e eksperiencës në procesin e vendimmarrjes etike.*

H_0 : Eksperienca nuk ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike (4)

H_a : Eksperienca ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike

Nga përpunimi i të dhënave kanë rezultuar tabelat 6.25; 6.26; 6.27 dhe 6.28.

Nga tabela 6.27, meqë $\text{sig.} = 0.01 < \alpha = .05$, hedhim poshtë hipotezën bazë (4) dhe pranojmë atë alternativë. *Kjo do të thotë se na rezulton që eksperienca ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike.* Nga tabela 6.28, shohim se nuk ka dallime të rëndësishme mes klasave “më pak se 5” me “15-25” si dhe klasave “5-15” me “më shumë se 25”. Ky rezultat është në përputhje me Teorinë e Kohlberg, e cila pretendon se ekziston një marrëdhënie midis eksperiencës dhe zhvillimit moral (Trevino, 1986). Kjo marrëdhënie siguron mundësi për marrjen e përgjegjësi dhe rolit të duhur për të zgjidhur çështjet etike, me të cilat përballet individi në vendin e punës. Sipas Glover et al. (2002) sa më shumë eksperiencë të ketë një individ, aq më i ndërgjegjshëm është ai në lidhje me atë që konsiderohet etikisht e pranueshme.

5. *Nëhipoteza e fundit lidhet me ndikimin e filozofisë personale të moralit në vendimmarrjen etike.*

H_0 :Filozofia personale e moralit nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike
(5)

H_a : Filozofia personale e moralit ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike

Nga përpunimi i të dhënave, duke kryer Independent Samples t-test, u përftuan tabelat 6.29 dhe 6.30. Sikurse vihet re nga tabela 6.29 në studim 194 prej pjesëmarrësve janë idealistë dhe 25 prej tyre ishin relativistë.

Nga tabela 6.30 Independent Samples Test, te rreshti i parë kemi që $\text{sig.} = .980 > \alpha = .$

05. Kjo do të thotë se plotësohet kushti i variancave të barabarta të dy

popullimeve. Gjithashtu, meqë $\text{sig.}(2\text{-tailed}) = .440 > \alpha = .05$, do të thotë se nuk mund

të hedhim poshtë hipotezën bazë të (5) . *Kjo do të thotë se na rezulton se filozofia personale e moralit, nuk ka ndikim të rëndësishëm te vendimmarrja etike .*

Kërkimet e mëparshme mbi etikën, të cilat kanë pasur si objektiv analizimin e ndikimit të filozofisë personale të moralit, te vendimmarrja etike kanë arritur në përfundime jo konsistente (Henle, Giacalone, & Jurkiewicz, 2005). Kjo do të thotë që kontabilistët shqiptarë nuk ndikohen nga filozofia e tyre personale gjatë marrjes së vendimeve në lidhje me çështjet etike me të cilat ata përballen çdo ditë. Në të njëjtin përfundim kanë arritur edhe Chan & Leung (2006); Shafer (2006); Singh et al. (2007).

Pra, sikurse vihet re nga pesë faktorët individualë të marrë në shqyrtim vetëm dy prej tyre kanë ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike. Këta dy faktorë janë mosha

dhe eksperiencia. Me rritjen e moshës rritet edhe aftësia e individit për të marrë vendime etike. Sa më e madhe eksperiencia e individit, aq më të mëdha janë shanset që ky individ të marrë vendime etike.

Pyetja e tretë kërkimore e ngritur në këtë punim lidhet me ndikimin e faktorëve organizativë në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve të vendit tonë. Për t'ju përgjigjur kësaj pyetjeje janë ngritur katër nënhipoteza.

1. *Nënhipoteza e parë lidhet me llojin e industrisë në të cilën operon kompania për të cilën punon individi (kontabilisti), i cili duhet të marrë vendimin.*

H_0 : Lloji i industrisë ku operon kompania nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (6)

H_a : Lloji i industrisë ku operon kompania ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike.

Duke kryer testin ANOVA nga përpunimi, u përfutuan tabelat 6.31; 6.32; 6.33; 6.34.

Nga Tabela 6.33 ANOVA, shohim se $\text{sig.} = .001 < \alpha = .05$. Kjo do të thotë se hedhim poshtë hipotezën bazë të (6) dhe pranojmë atë alternativë. *Kjo do të thotë se lloji i industrisë ku operon kompania ka ndikim të rëndësishëm te vendimmarrja etike.*

Nga tabela 6.34 Multiple Comparisons, mund të hetojmë se cilat lloje dallojnë në mënyrë të rëndësishme nga njëra-tjetra, bazuar në LSD e Fisher-it. Nga kjo tabelë rezulton se

Transporti dhe Magazinimi dallon në mënyrë të rëndësishme me Industrinë, Tregtinë, Akomodimin, Informacionin dhe Shërbime të tjera. Nga përpunimi i të dhënave arrihet në përfundimin se lloji i industrisë në të cilën operon kompania ka një ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike. Ky rezultat është në përputhje me një sërë studimesh të mëparshme ku mund të përmendim Ergenelei & Arikan (2002); Krambia-Kapardis & Zopiatis (2008); Shafer (2007), etj.

2. *Nënhipoteza e dytë lidhet me ndikimin e madhësisë së kompanisë në vendimmarrjen etike.*

H_0 : Madhësia e kompanisë nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (7)

H_a : Madhësia e kompanisë ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike

Duke kryer testin ANOVA, u përfatuan tabelat 6.35; 6.36; 6.37.

Nga Tabela 6.37 ANOVA, shohim se $\text{sig.} = .253 > \alpha = .05$. Kjo do të thotë se nuk mund të hedhim poshtë hipotezën bazë të (7). *Kjo do të thotë se madhësia e kompanisë nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike.* Pavarësisht mendimeve të ndryshme në lidhje me ndikimin e madhësisë së kompanisë në procesin e vendimmarrjes etike, në këtë studim është arritur në përfundimin se madhësia e kompanisë nuk ka ndikim të rëndësishëm në këtë proces. Një rezultat i tillë është arritur edhe nga disa studime të tjera, ku mund të përmendim Razzaque & Hwee (2002); Roozen et al. (2001); Paolillo & Vitell (2002), etj.

3. *Nënhipoteza e tretë lidhet me ndikimin e kodit të etikës.*

H_0 : Ekzistenca e kodit të etikës në kompani nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (8)

H_a : Ekzistenca e kodit të etikës në kompani ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike

Nga përpunimi i të dhënave, duke kryer Independent Samples t-test, janë përfshuar tabelat 6.38 dhe 6.39.

Nga tabela 6.38 Independent Samples Test, shohim që $\text{sig.} = .561 > \alpha = .05$. Kjo do të thotë se plotësohet kushti i variancave të barabarta të dy popullimeve.

Gjithashtu, meqë $\text{sig. (2-tailed)} = .003 < \alpha = .05$, do të thotë se hidhet poshtë hipoteza bazë te (8) dhe pranojmë atë alternativë. *Kjo do të thotë se kodi i etikës në një kompani ka ndikim të rëndësishëm te vendimmarrja etike.*

Ekzistenca e kodit të etikës ka një ndikim pozitiv në tri fazat e para të procesit të vendimmarrjes etike të individëve. Rezultati i arritur është në përputhje me disa studime të mëparshme, ku mund të përmendim Singh et al. (2005); Wotruba, Chonko & Loe (2001).

4. Nënhipoteza e katërt lidhet me ndikimin e klimës etike në vendimmarrjen etike.

H_0 : Klimaetike nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (9)

H_a : Klimaetike ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike.

Duke kryer testin ANOVA, u përfshuan tabelat 6.40; 6.41; 6.42; 6.43.

Nga Tabela 6.42 ANOVA, shohim se $\text{sig.} = .032 < \alpha = .05$. Kjo do të thotë se hedhim poshtë hipotezën bazë të (9). Prej këtui, *konkludojmë se Klima Etike ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike. Nga tabela 6.43 shohim se meqenëse nga tri llojet e klimës etike të marrë në konsideratë procesi i vendimmarrjes etike ndikohet më fort nga lloji “Ligji dhe Kodi Profesional”.*

Pra, në total nga katër faktorët organizativë të marrë në konsideratë vihet re se tri prej tyre kanë ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve tanë.

Pyetja e katërt kërkimore lidhet me ndikimin e dimensioneve të intensitetit moral të çështjes etike në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve tanë. Nga gjashtë dimensionet e intensitetit moral të propozuara nga Jones në 1991, në këtë punim u morën në konsideratë vetëm tri prej tyre.

Për t’ju përgjigjur kësaj pyetjeje janë ngritur disa nënhipoteza.

1.Nënhipoteza e parë ka të bëjë me ndikimin e tri dimensioneve të intensitetit moral në procesin e vendimmarrjes etike.

H_0 : Dimensionet e intensitetit moral nuk kanë ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike(9)

H_a : Dimensionet e intensitetit moral kanë ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike

Duke kryer analizën regressive, ku si ndryshore të varur kemi vendimmarrjen etike, ndërsa si ndryshore të pavarura kemi: Madhësinë e Pasojave, Konsensusin Social dhe Shpejtësinë e shfaqjes së pasojave, u përftuan tabelat 6.44; 6.45; 6.46; 6.47; 6.48 dhe 6.49.

Bazuar në paraqitjet grafike, nuk konstatohen shkelje të supozimeve të modelit të regresionit linear. Më konkretisht, vihet re se nga figura 5.9 Histograma e Mbetjeve të Standardizuara përafrohet me Këmbanën e Gaussit.

Nga tabela 6.49 Residuals Statistics, konstatohet se Mesatarja e Mbetjeve është 0, ndërsa prej figurës 6.10 grafikut Normal P-P Plot dhe figurës 6.11 Scatterplot konstatohet se nuk cënohet kushti i Homoscedasticitetit.

Nga tabela 6.47 ANOVA, meqë $\text{sig.} = .000 < \alpha = .05$, hedhim poshtë hipotezën bazë të (9) dhe pranojmë hipotezën alternative. Kjo do të thotë se në total, dimensionet e intensitetit moral, kanë ndikim të rëndësishëm të vendimmarrja etike.

Për të parë ndikimet individuale, bëjmë kontrollin e tri nënhipotezave të mëposhtme, të cilat lidhen me ndikimin e secilit dimension të intensitetit moral të çështjes etike në procesin e vendimmarrjes etike.

Nënhipoteza e parë lidhet me ndikimin që ka madhësia e pasojave të çështjes etike në procesin e vendimmarrjes etike.

H_0 : Madhësia e pasojave nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (10)

H_a : Madhësia e pasojave ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike.

Nga Tabela 6.48 Coefficients, meqë $\text{sig.} = .044 < \alpha = .05$, hedhim poshtë hipotezën bazë të (10) dhe pranojmë hipotezën alternative. Kjo do të thotë se Madhësia e Pasojave ka ndikim të rëndësishëm të vendimmarrja etike.

Nënhipoteza e dytë lidhet me ndikimin e konsensusit social në procesin e vendimmarrjes etike.

H_0 : Konsensusi social nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (11)

H_a : Konsensusi social ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike.

Nga Tabela 6.48 Coefficients, meqë sig. = .000 < α = .05, hedhim poshtë hipotezën bazë të (11) dhe pranojmë hipotezën alternative. Kjo do të thotë se Konsensusi Social, ka ndikim të rëndësishëm te vendimmarrja etike.

Nënhipoteza e tretë lidhet me ndikimin e shpejtësisë së shfaqjes së pasojave të çështjes etike në procesin e vendimmarrjes etike.

H_0 : Shpejtësia e shfaqjes së pasojave nuk ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike (12)

H_a : Shpejtësia e shfaqjes së pasojave ka ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen etike.

Nga tabela 6.48 rezulton gjithashtu se shpejtësia e shfaqjes së pasojave nuk ka ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike.

Po nga e njëjta tabelë, rezulton se Konsensusi Social ka ndikim më të madh se Madhësia e Pasojave meqë e ka sig. më të vogël.

6.4. Konkluzione

Në këtë kapitull u paraqit analiza deskriptive e kampionit të marrë në studim dhe analiza empirike e të dhënave. Nga përpunimi i informacionit të mbledhur vihet re nga faktorët individualë të marrë në konsideratë te kontabilistët shqiptarë gjatë vendimmarrjes etike kanë ndikim të rëndësishëm vetëm dy faktorë: mosha dhe eksperiencia. Përsa i përket faktorëve organizativë është arritur në përfundimin se lloji i industrisë në të cilën operon

kompania dhe klima etike e kompanisë kanë një ndikim të rëndësishëm te kontabilistët gjatë vendimmarrjes etike. Nga tri llojet e klimës etike të marra në konsideratë vihet re se lloji "Ligji dhe Kodi profesional" ka ndikim më të rëndësishëm në vendimmarrjen etike. Nga tri dimensionet e intensitetit moral të çështjes etike të marra në shqyrtim rezulton se vetëm madhësia e pasojave dhe konsensusi social kanë ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike. Midis këtyre dy dimensioneve është arritur në përfundimin se konsensusi ka ndikim më të madh te individët gjatë marrjes së vendimeve në lidhje me çështje të ndryshme etike.

KAPITULLI VII: KONKLuzionET

Qëllimi i këtij studimi ishte përcaktimi i lidhjes që ekzistonte midis faktorëve individualë, faktorëve organizativë dhe dimensioneve të intensitetit moral në procesin e vendimmarrjes etike në fushën e kontabilitetit. Që në fillim të punimit u përcaktuan katër objektivat kryesore të tij, të cilat ishin: 1. Identifikimi i çështjeve etike me të cilat përballen kontabilistët në kompanitë shqiptare, 2. Përcaktimi i marrëdhënies midis faktorëve individualë (mosha, gjinia, niveli i edukimit, eksperiencia dhe filozofia personale e morali) dhe procesit të vendimmarrjes së kontabilistëve shqiptarë, 3. Përcaktimi i marrëdhënies midis faktorëve organizativë (Kodi i Etikës, klima Etike, madhësia e organizatës dhe lloji i industrisë) dhe procesit të vendimmarrjes së kontabilistëve shqiptarë, 4. Përcaktimi i marrëdhënies midis dimensioneve të intensitetit moral (madhësia e pasojave, konsensusi social dhe shpejtësia e shfaqjes së pasojave) dhe procesit të vendimmarrjes së kontabilistëve shqiptarë.

Në këtë kapitull do të paraqiten konkluzionet e këtij studimi. Kapitulli fillon me diskutimin e gjetjeve kryesore duke identifikuar faktorët që ndikojnë në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve shqiptarë. Më pas do të bëhet një diskutim dhe arsyetim i konkluzioneve të punimit. Ashtu sikurse çdo punim tjetër shkencor edhe për këtë punim do të jepen disa rekomandime, të cilat duhet të merren parasysh si nga kompanitë ashtu edhe nga organet kompetente. Në përfundim të kapitullit do të jepen kufizimet e këtij studimi, të cilat sigurojnë disa orientime për studimet e ardhshme në lidhje me këtë çështje.

7.1. Gjetjet kryesore

Në përpjekje për të arritur qëllimet e këtij studimi, fillimisht u bë një analizim i hollësishëm i literaturës teorike dhe empirike (kapitulli II). Nga kjo analizë dalin në pah një sërë faktorësh, të cilët kanë ndikim në procesin e vendimmarrjes etike. Literatura e etikës, përgjatë përpjekjeve teorike dhe empirike, ka arritur në përfundimin që këta faktorë mund të grupohen në tri kategori të ndryshme: faktorët individualë, faktorët organizativë dhe dimensionet e intensitetit moral. Duke u mbështetur në kërkimet mbi etikën në kontabilitet dhe procesin e vendimmarrjes të bëra në vendet në zhvillim u pa e arsyeshme që në këtë studim të analizohej ndikimi i moshës, gjinisë, nivelit të edukimit, eksperiencës dhe filozofisë personale të moralit nga grupi i faktorëve individualë. Nga grupi i faktorëve organizativë u përzgjedhën Kodi i Etikës, klima etike e kompanisë, madhësia dhe lloji i industrisë ku operon kompania. Nga dimensionet e intensitetit moral të çështjes etike u morën në shqyrtim madhësia e pasojave, konsensusi social dhe shpejtësia e shfaqjes së pasojave. Për të mbledhur informacion në lidhje me këta tregues dhe procesin e vendimmarrjes u përdor një pyetësor në të cilin u integruan edhe katër skenarë (kapitulli

IV). Në studim u përdorën disa teknika statistikore, si: Independent Samples t- test, ANOVA dhe Regresioni Linear (kapitulli V).

Në grupin e faktorëve individualë të marrë në shqyrtim u analizuan pesë faktorë: gjinia, mosha, eksperiencia, niveli i edukimit dhe filozofia personale e moralit. Pas përpunimit të informacionit të mbledhur u vu re se nga ky grup faktorësh vetëm mosha dhe eksperiencia kishin një ndikim të rëndësishëm në tri fazat e para të procesit të vendimmarrjes etike të kontabilistëve shqiptarë. Pavarësisht gjinisë, nivelit të edukimit dhe filozofisë personale të moralit që një kontabilist kishte, qëllimi për të marrë ose jo një vendim etik do të ishte i njëjtë. Përsa i përket dy faktorëve të tjerë u vu re se mosha dhe veçanërisht grupmosha 30-35 vjeç dhe eksperiencia e kontabilistit kishin një ndikim të konsiderueshëm në tri fazat e para të procesit të vendimmarrjes etike. Midis këtyre dy faktorëve nuk mund të përcaktojmë, se cili prej tyre ka ndikim më të madh duke qenë se sig. e tyre është e njëjtë. Në grupin e faktorëve organizativë u morën në konsideratë: Kodi i Etikës, klima etike, madhësia e kompanisë dhe lloji i industrisë ku ajo operon. Nga përpunimi i të dhënave vërtetohet se, duke përjashtuar madhësinë e kompanisë, të tre faktorët e tjerë kanë një ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve shqiptarë. Ndër këto tre faktorë duket se ndikimin më të madh e ka lloji i industrisë ku operon kompania. Për këtë faktor sig. është .001. Më pas radhitet ndikimi i ekzistencës së Kodit të Etikës për të cilin sig. është .003. Për klimën etike të kompanisë sig. është .032. Pra, ky faktor ka ndikim më të vogël krahasuar me dy të tjerët. Në lidhje me hipotezën e tretë dimensionet e marra në konsideratë janë tri. Nga rezultatet e përpunimit shikojmë që madhësia e pasojave dhe konsensusi social kanë një ndikim të rëndësishëm në procesin

e vendimmarrjes etike. E kundërta ndodh për dimensionin e tretë të marrë në shqyrtim, shpejtësinë e shfaqjes së pasojave, për të cilën sig. është $.483 > \alpha = .05$. Pra, ky dimension nuk ka ndikim te procesi i vendimmarrjes etike. Meqenëse dy nga tre faktorët e marrë në konsideratë vërtetohet që ndikojnë procesin e vendimmarrjes, hipoteza e tretë vërtetohet.

Pra, në përfundim mund të themi se individët, në rastin tonë kontabilistët shqiptarë, ndikohen nga mosha dhe eksperiencia e tyre, nga lloji i industrisë ku operon kompania në të cilën ata punojnë, nga ekzistenca ose jo e Kodit të Etikës, nga klima etike e kompanisë. Gjithashtu individët influencohen edhe nga fakti se sa të mëdha janë pasojat e një çështjeje etike, për të cilën ata duhet të marrin një vendim e njëkohësisht edhe nga fakti se sa pranohet nga shoqëria një çështje e tillë gjatë vendimmarrjes së tyre.

7.2. Konkluzione kryesore

Në grupin e faktorëve individualë duket se mosha dhe eksperiencia kanë ndikim të konsiderueshëm në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve. Përsa i përket gjinisë, rezultatet e studimeve të mëparshme janë jo konsistente. Kjo do të thotë që ka mjaftueshëm studime, të cilat kanë arritur në përfundimin se gjinia është një faktor influencues i procesit të vendimmarrjes etike dhe njëkohësisht një numër të konsiderueshëm studimesh, të cilat e hedhin poshtë këtë marrëdhënie.

Përsa i përket kontabilistëve shqiptarë, nga ky studim u arrit në përfundimin se si meshkujt edhe femrat kur janë përballë një çështjeje etike, për të cilën duhet të marrin një vendim, ky vendim do të jetë i njëjtë pavarësisht gjinisë së tyre.

Ky rezultat mbështetet nga një sërë studiuesish ku mund të përmendim Barnett & Valentine (2004); Stedham, Yamamura & Lai (2008) e të tjerë. Përveç mbështetjes nga kërkimet empirike të deritanishme, ky rezultat gjen mbështetje edhe nga studimi i Betz, O'Connell & Shepard (1989). Sipas këtij studimi, mosekzistenca e ndryshimeve në vendimmarrjen e individëve duke u bazuar te gjinia shpjegohet nga Teoria Strukturore. Sipas kësaj qasjeje, ndryshimet midis femrave dhe meshkujve që vijnë si rezultat i socializimit të hershëm dhe kërkesave të rolit që individi ka (grua, nënë etj), do të zhduken nga shpërblimet dhe kostot që lidhen me pozicionet që ata kanë në vendin e tyre të punës. Sipas kësaj teorie, femrat do të sillen njësoj si meshkujt në rastet kur ato ndodhen në të njëjtat kushte pune.

Pra, meshkujt dhe femrat do të përgjigjen në të njëjtën mënyrë ndaj çështjeve etike, me të cilat ata hasen në vendin e tyre të punës (Comunale et al., 2006 ; Derry & Green, 1989 ; Reidenbach, Robin & Dawson, 1991).

Duke qenë se nga përpunimi i të dhënave është arritur në përfundimin se faktorët organizativë, me përjashtim të madhësisë së kompanisë, kanë ndikim në procesin e vendimmarrjes etike, kjo do të thotë që individët gjatë marrjes së vendimeve udhëhiqen nga këta faktorë, duke neglizhuar faktorët individualë.

Sipas Franke, Croen & Spake (1997) ka ndryshime midis meshkujve dhe femrave përsa i përket perceptimeve etike, por këto ndryshime zhduken me rritjen e eksperiencës. Kjo vërtetohet nga fakti që në këtë studim, eksperiencia ka rezultuar si një ndër faktorët individualë që ka një ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike.

Ka disa studime që e mbështesin një rezultat të tillë (O’Leary & Steward, 2007; Pflugrath, Martinov- Bennie & Chen, 2007; Bernard & Sweeney, 2010). Vihet re që lidhja pozitive midis eksperiencës dhe procesit të vendimmarrjes etike është provuar gjithnjë e më tepër në literaturën e etikës së biznesit gjatë dekadave të fundit. Ky rezultat mbështetet edhe nga Teoria e Zhvillimit të Moralit e Kohlberg dhe teoria e Trevinos (1986), sipas së cilës zhvillimi i të rriturve lidhet me edukimin dhe eksperiencën e punës.

Sipas teorisë së Kohlberg, pretendohet që mosha dhe niveli i edukimit, të ndërthurura së bashku, duhet të kishin një ndikim pozitiv te procesi i vendimmarrjes etike. Në rastin tonë, kjo teori mbështetet pjesërisht, sepse nga rezultatet e këtij punimi arrihet në konkluzionin se vetëm mosha ka ndikim pozitiv në procesin e vendimmarrjes etike, ndërsa niveli i edukimit nuk e ndikon këtë proces. Teoria e Trevinos pretendon se zhvillimi i të rriturve lidhet me edukimin dhe eksperiencën në punë. Pra, edhe kjo teori gjen mbështetje të pjesshme, sepse nga ky punim vërtetohet vetëm ndikimi pozitiv i eksperiencës në procesin e vendimmarrjes. Pra, niveli i edukimit nuk ka ndikim të rëndësishëm te procesi i vendimmarrjes etike.

Literatura e etikës së biznesit mbështet faktin që procesi i vendimmarrjes së individëve, në rastin tonë, kontabilistëve, varet nga një masë e konsiderueshme nga mjedisi i punës, nga i cili këta individë rrethohen. Ka disa faktorë organizativë si, klima etike, Kodi i Etikës, madhësia e kompanisë apo lloji i industrisë ku operon kompania, të cilët janë vërtetuar nga kërkimet e mëparshme empirike se ka një ndikim pozitiv tek individit, i cili merr një vendim etik. Këta faktorë u morën në shqyrtim edhe në këtë studim, nga i cili u arrit në përfundimin se përveç madhësisë së kompanisë, tre faktorët e tjerë kanë ndikim të rëndësishëm te

procesi i vendimmarrjes. Ndër këta faktorë vihet re se lloji i industrisë ka ndikim më të madh krahasuar me Kodin e Etikës dhe klimën etike. Midis dy faktorëve të fundit, Kodi i Etikës është më i rëndësishëm krahasuar me klimën etike. Rezultati i arritur lidhur me madhësinë e kompanisë është konsistent me disa studime, ku mund të përmendim Paolillo & Vitell (2002); Shafer et al. (2001). Megjithatë duhet theksuar se ka mendime të ndryshme në lidhje me ndikimin e madhësisë së kompanisë. Këtu mund të përmendim Clarke et al. (1996), i cili pretendon se sa më të mëdha të jenë kompanitë, aq më e madhe është mundësia që këto kompani të përfitojnë implementimin e mekanizmave të ndryshëm ndihmës, të cilët nuk mund të gjenden në kompanitë e vogla për të mbështetur vendimet etike që marrin individët e këtyre kompanive. Vitell & Festervant (1987) pretendojnë që kompanitë e vogla të detyruara që të konkurojnë kompanitë e mëdha, kanë më shumë shanse të përfshihen në çështje jo etike. Për kontabilistët shqiptarë madhësia e kompanisë nuk përbën një faktor influencues në momentin kur këta individë janë të detyruar të marrin vendime në lidhje me çështjet etike. Arsyeja kryesore e arritjes së një rezultati të tillë mund të lidhet me faktin që në studim u përfshinë të gjitha kompanitë VIP të vendit tonë. Për t'u klasifikuar në grupin e tatimpaguesve të mëdhenj, në vendin tonë, përdoret si kriter klasifikimi qarkullimi vjetor i këtyre kompanive. Kjo do të thotë që në grupin e tatimpaguesve të mëdhenj mund të ketë edhe kompani me katër ose pesë punonjës.

Në lidhje me ndikimin e llojit të industrisë ku operon kompania, ky faktor përbën faktorin me ndikim më të madh në procesin e vendimmarrjes etike. Oz (2001) pretendon se lloji i industrisë ka një ndikim të rëndësishëm në sjelljen etike të individëve. Sipas tij, individët të cilët punojnë në vende ku prodhohen produkte të rrezikshme, për shembull, barna,

janë më të ndjeshëm ndaj çështjeve etike se sa individët të cilët punojnë për kompani të cilat prodhojnë produkte të sigurt, siç mund të jenë mobilet. Në rastin tonë “Tregëtia” ka ndikim më të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike, krahasuar me llojet e tjera të industrisë. Për këtë arsye, këtij grupi kompanish që operon në këtë sektor i duhet kushtuar më tepër vëmendje në lidhje me etikën dhe rregullimin e saj.

Pas këtij faktori renditet ndikimi i Kodit të Etikës në procesin e vendimmarrjes etike, të kontabilistëve. Rezultati i arritur në këtë studim është në përputhje me disa studime, ku mund të përmendim Pater & Anita (2003); Adams, Tashchiang & Shore (2001); Granitz (2003) e të tjerë. Fakti që ky faktor ka ndikim të rëndësishëm dëshmon se kodet njihen dhe respektohen nga punonjësit e çdo kompanie. Në kompanitë shqiptare Kodet e Etikës nuk përfaqësojnë vetëm dokumente formale për të qenë në përputhje me ligjin.

Ka disa studiues, të cilët pohojnë që një Kod Etike i vetëm nuk është i mjaftueshëm për të ndikuar në mënyrë të rëndësishme procesin e vendimmarrjes etike (Cooper & Frak, 1997; Verschoor, 2002). Rottig & Heischmidt (2007) kanë arritur në përfundimin se Kodi i Etikës duhet të shqyrtohet në mënyrë sistematike dhe empirike së bashku me disa përcaktues të tjerë të vendimmarrjes etike, siç mund të jetë trajnimi etik. Të gjitha këto pretendime mbështeten nga fakti se nga ky studim Kodi i Etikës nuk është i vetmi faktor organizativ që ka ndikim në vendimmarrjen etike.

Gjithashtu një faktor tjetër influencues është edhe klima etike e kompanisë. Sipas Victor & Cullen (1988) klima etike përkufizohet si perceptimet dominuese të praktikave dhe procedurave tipike organizative që kanë përmbajtje etike. Sipas tyre, klima etike e një

kompanie është faktori kryesor, i cili ndihmon në informimin e punonjësve në lidhje me të drejtën dhe me veprimet etike brenda organizatës. Tri llojet e klimës etike të marra në konsideratë në këtë studim kanë ndikim të rëndësishëm te kontabilistët shqiptarë gjatë procesit të vendimmarrjes etike. Edhe pse një nocion i ri dhe i njohur vetëm gjatë viteve të fundit nga kompanitë shqiptare, mund të themi se klima etike ka zënë pozicionin që i takon për nga rëndësia. Kompanitë e vendit tonë, edhe pse me hapa të ngadalta, kanë arritur të implementojnë klimën etike, pavarësisht llojit të saj. Ky faktor ka ardhur duke u përmirësuar dhe një rol të rëndësishëm besohet se në këtë rast ka luajtur edhe fryma e re që kanë sjellë investitorët e huaj.

Arsyeja kryesore e arritjes së këtyre rezultateve në lidhje me faktorët organizativë mund të lidhet me faktin që kompanitë shqiptare operojnë në treg të lirë. Sipas Agareal & Malloy (1999) faktorët organizativë nuk përbëjnë përcaktues të procesit të vendimmarrjes në kompanitë në pronësi të shtetit, pra në kompanitë që operojnë në tregje të planifikuara sepse këto lloj kompanish kanë një kontroll relativisht të limituar te punonjësit e tyre. Fakti që kompanitë tona operojnë në një treg të lirë dhe konkures mbështet plotësisht rezultatet e arritura nga ky studim në lidhje me faktorët organizativë. Ka disa studime të mëparshme, të cilët vërtetojnë faktin se këta faktorë kanë një ndikim të rëndësishëm në fazat e procesit të vendimmarrjes etike te kompanitë që operojnë në një treg të lirë (Barnett et al., 1993; Granitz, 2003; Plugraht et al., 2007).

Dimensionet e intensitetit moral janë faktorë relativisht të rinj dhe ndikimi i tyre në procesin e vendimmarrjes etike ka filluar të studiohet pas vitit 1991. Sipas Jones (1991) këto dimensionet lidhen veçanërisht me karakteristikat e çështjes etike. Tri nga këto

dimensione janë marrë parasysh nga ky studim dhe ato janë: madhësia e pasojave, konsensusi social dhe shpejtësia e shfaqjes së pasojave.

Dimensionet e intensitetit moral u matën nëpërmjet katër skenarëve, të cilat u integruan në pyetësorin me anën e të cilit u bë e mundur të mblidhej informacioni i nevojshëm.

Në këtë studim u arrit në përfundimin se madhësia e pasojave dhe konsensusi social kishin një ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve. Shpejtësia e shfaqjes së pasojave rezultoi se nuk kishte ndikim te kontabilistët gjatë marrjes së vendimeve. Rezultatet janë në mbështetje të modelit të ndërtuar nga Jones (1991) dhe në përputhje me disa studime empirike (Sweeney & Costello, 2009; Leitsch, 2004, 2006).

Midis madhësisë së pasojave dhe konsensusit social rezulton se konsensusi social ka ndikim më të madh në procesin e vendimmarrjes etike. Rëndësia e konsensusit social tregon që perceptimet e kontabilistëve në lidhje me normat e shoqërisë ndaj një çështjeje të caktuar ndikojnë vendimet e tyre etike. Fakti që konsensusi social rezulton një faktor më i rëndësishëm sesa madhësia e pasojave të një çështjeje etike të caktuar, do të thotë që kontabilistët shqiptarë janë më tepër të ndjeshëm ndaj faktit sesa do t'i pranojë shoqëria si etike vendimet e tyre, sesa rreth faktit sesa të mëdha do të jenë pasojat e një vendimi joetik. Shpejtësia e shfaqjes së pasojave sipas Jones (1991) ka të bëjë me “kohën nga momenti i ndodhjes së veprimit deri në shfaqjen e pasojave të tij”. Pra, sa më e gjatë koha e shfaqjes së pasojave aq më të vogla perceptimet në lidhje me madhësinë e dëmit të pritshëm nga një veprim i caktuar. Rezultati i arritur në lidhje me shpejtësinë e shfaqjes së pasojave është në përputhje me studimin e Barnett & Valentine (2004). Duhet theksuar se ka një mungesë

studimesh, të cilat të kenë shqyrtuar këtë komponent, kështu që edhe krahasimi i rezultateve të arritura është i cunguar nga ky fakt. Si përfundim mund të themi se dimensionet e intensitetit moral ndikojnë në një masë të konsiderueshme procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve tanë. Këto rezultate dëshmojnë se individët që marrin vendime (kontabilistët) i perceptojnë disa situata të caktuara me një intensitet moral më të madh se sa ata kanë realisht dhe mbështesin teorinë e Jones (1991). Edhe pse ky studim arriti në përfundimin se këta faktorë kanë një ndikim të konsiderueshëm në procesin e vendimmarrjes së kontabilistëve shqiptarë, janë të nevojshme studime të vazhdueshme për të provuar sërish ekzistencën e kësaj lidhjeje. Për më tepër duhet theksuar dhe duhet pasur parasysh se ky ishte studimi i parë në lidhje me vendimmarrjen etike të kontabilistëve shqiptarë dhe faktorëve që i ndikojnë ata.

Gjithashtu në këtë punim u mor mendimi i kontabilistëve të vendit tonë në lidhje me rëndësinë dhe shpeshtësinë me të cilën hasen disa çështje etike, të cilat kanë rezultuar të rëndësishme edhe në studime të tjera të bëra në vendet në zhvillim. E para për nga rëndësia renditet largimi i kontabilistëve nga puna, sepse ky individ ka parime etike të ndryshme nga ato të kompanisë. Pothuajse njëloj të rëndësishme shfaqen edhe manipulimi i treguesve kontabël (për shembull nëpërmjet metodave të kostos) me qëllim që të arrihet fitimi i buxhetuar, shpërndarja e informacionit konfidencial tek individë jashtë kompanisë, kontabilistët thyejnë një rregull në rastet kur mendojnë se avantazhet e kompanisë janë më të mëdha se sa kosto etike, kontabilistët përdorin informacionin e brendshëm për përfitime personale. Këto çështje kanë përqindje vlerësimi si “shumë

të rëndësishme” ose “ të rëndësishme” nga 74.8% deri në 67% dhe renditen si pesë çështjet etike më të rëndësishme për kontabilistët shqiptarë.

Gjithashtu pjesëmarrësve në studim iu kërkua të vlerësonin këto çështje duke u nisur nga shpeshtësia me të cilën ato haseshin me këto situata. Sipas mendimit të tyre pesë çështjet me të cilat hasen më shpesh kontabilistët janë: përdorimi i pushtetit për të shtrembëruar apo parandaluar debatet e hapura apo diskutimet në lidhje me politikat edhe vendimet e kompanisë, një kontabilist detyrohet ta lërë kompaninë, sepse ka parime etike të ndryshme nga ato të kompanisë, kontabilistët thyejnë një rregull në rastet kur mendojnë se avantazhet e kompanisë janë më të mëdha, se sa kosto etike, manipulimi i treguesve kontabël (psh. nëpërmjet metodave të koston) me qëllim që të arrihet fitimi i buxhetuar, rregullimi i informacionit ose thyerja e rregullave për të evituar keqtrajtimin nga konsumatori. Përqindja e vlerësimit të këtyre çështjeve si çështje që hasen “shumë shpesh” ose “shpesh” variojnë nga 13% deri në 10.9%.

Shkelje që kanë të bëjnë me sjelljen jo etike nga kontabilistët e njësive ekonomike ndeshen shumë edhe në praktikën e biznesit shqiptar. Por, sigurisht që shumica e kontabilistëve e ushtrojnë profesionin në mënyrë të ndershme duke zbatuar rregullat e Kodit të Etikës. Në këtë të fundit janë përcaktuar qartë veprimtaritë etike dhe ato konsiderohen si të papajtueshme në lidhje me ushtrimin e profesionit të kontabilistit.

Kontabilisti e ka për detyrë të paraqesë një pamje të vërtetë të gjendjes financiare të njësisë ekonomike. Por, në kushtet e Shqipërisë, ku shkalla e informalitetit të ekonomisë është e lartë, paraqet probleme përgatitja e pasqyrave financiare pa anësi. Në praktikën e përditshme, në shumë raste, i shohim kontabilistët të vihen nën presion nga audituesit

apo administratorët e njësisë ekonomike, për të fshehur ose mbivlerësuar elementë të veçantë të pasqyrave financiare. Kjo trysni ushtrohet për t'i paraqitur këto pasqyra në banka për të përfituar kredi dhe në zyrat e tatim-taksave për të zvogëluar detyrimet fiskale. Etika në këtë profesion, kërkon që kontabilisti të mos tërhiqet para mashtrimeve edhe kur është nën presion.

Sistemi bankar është vetë fajtor për rritjen e kredive të këqija, sepse kërkon nga shoqëritë jo bilancin që dorëzohet në organin tatimor, por bilancin mashtrues. Shoqëritë të detyruara nga nevojat për likuiditet për vazhdimësinë e biznesit, detyrohen të mashtrojnë bankat me bilance fallso dhe bankat mbyllin sytë para kësaj gënjeshtre. Ky lloj pranimi lidhet me shpërblimet që përfitojnë drejtuesit e bankave për çdo kredi të dhënë.

Kjo praktikë të vepruari mund të vërë në rrezik aktivitetin e bankës dhe tërë sistemin financiar në Shqipëri. Prandaj, bankat e niveleve të dyta në rastet e dhënies së kredive, përveç garancive të detyrueshme që kërkohen, duhet të verifikojnë dhe bilancet dhe pasqyrat e tjera financiare që depozitohen pranë Zyrtarëve të Tatim-Taksave. Nevojitet që edhe Banka e Shqipërisë të bëjë ndërhyrjen e saj sa më shpejt për të shpëtuar sistemin nga prodhimi i bilanceve me shifra false.

Një koordinim i mirë mes të dhënave që dorëzojnë shoqëritë në zyrën e tatimeve dhe të atyre që ofrojnë në bankat e nivelit të dytë, do të bëjë atë që kompanitë të mos fshihen më, por të dalin me gjendjen e tyre financiare reale.

Në kuadër të Kodit etik, kontabilisti duhet të mbrojë interesat e klientit të tij duke përmbushur përgjegjësitë e tij. Të vepruarit me ndershmëri etike, është një e drejtë dhe detyrim i kontabilistit, ndaj besimit që i është dhënë për të pasqyruar me vërtetësi informacionin financiar në interes të publikut. Në këtë këndvështrim, përgjegjësia

e kontabilistit nuk shtrihet vetëm ndaj atij që e paguan, por edhe ndaj përdoruesve të informacionit kontabël: shtetit, bankat, tatimeve, gjykatave e të tjerë.

Siç ka ndodhur në disa raste në Shqipëri, të mbrosh interesat e njësisë së biznesit nuk do të thotë të hysh në pazare me inspektorët tatimorë për shkelje të paqena të ligjit tatimor, me interes të dyanshëm, ku janë penalizuar edhe inspektorët edhe kontabilistët, por të mbrosh klientin duke mos e rënduar atë me detyrime apo penalitete për tatime. Kjo është detyrë dhe e drejtë e çdo kontabilisti që të kërkojë në organet përkatëse ndryshimin e masës së taksave, kur besojnë se ato janë të padrejta.

Kohët e fundit në Shqipëri ka ndodhur që kontabilistë apo auditues bilanci, të jenë të motivuar vetëm nga interesi vetjak dhe t'i përdorin njohuritë e tyre për përfitime jo të drejta. Ata përgatisin bilance apo edhe i certifikojnë ato pa verifikuar dokumentet, si faturat, arkëtimet, pagesat, etj., pa bërë rakordime me klientët, furnitorët, bankat për kreditë e marra apo për interesat e paguara etj., por thjesht duke përdorur pasqyrat përmbledhëse të TVSH-së, të pagave, totalet e të hyrave e të dalave të bankës, të arkës, etj. Madje as gjendja e inventarit dhe i aktiveve afatgjata, nuk verifikohen nëse janë faktikisht apo jo.

Nga praktikat e hartimit të bilancit dhe auditimit të tyre, konstatohet se jo pak profesionistë të kontabilitetit nuk po tregojnë seriozitetin e duhur as në hartimin e bilancit, as në auditimin e tij. Aq më tepër në Shqipëri, që arrihet deri atje sa bilancet dhe pasqyrat financiare i hartojnë joprofesionistët, deri edhe inspektorët e tatimeve. Nga një vërtetim i kohëve të fundit, inspektorët e tatimeve sidomos në rrethe, por edhe në Tiranë, hartojnë rreth 60 % të bilanceve vetë apo me njerëz të tyre, që është hapur, konflikt interesash.

Pavarësia e profesionit të kontabilistit ruhet duke shmangur në çdo rast konfliktin e interesit. Nuk mund të bësh dy punë, njërën ta deklarojsh, siç mund të jetë auditimi dhe tjetrën, kontabilitetin, mbajtjen e kontabilitetit, nxjerrjen e bilancit, ta fshehësh, sikur këtë e ka bërë dikush tjetër, por që në fakt dikushi ka vënë vetëm firmën. Kështu ndodh rëndom në Shqipëri dhe nuk është e rastit, që për një periudhë 2-3 mujore, nga janari në mars (periudha e mbylljes së bilancit), një kontabilist harton 12ç-15ç bilance të bizneseve të ndryshme. Duket mjaft qartë, që thjesht duke analizuar termat kohorë të përmbushjes së këtij misioni edhe kontabilisti me më shumë eksperiencë nuk mund të ndërtojë pasqyra financiare cilësore dhe jo më të sigurojë se ka punuar me integritet.

Inspektorë të tillë tatimorë dhe kontabilistët që furnizohen me klientë nga ata duhen pezulluar nga ky shërbim, pasi çënojnë besimin në profesionin e kontabilitetit. Për të parandaluar këto fenomene negative, organet përkatëse ligjore duhet të godasin fort duke luftuar konkurrencën e pandershme dhe monopolizimin e këtij tregu nga një rreth i ngushtë personash. Gjithashtu ky fenomen mashtrues duhet të luftohet edhe nga organizatat profesionale që operojnë në Shqipëri, duke vendosur rregulla të forta loje që të sigurojnë në çdo kohë transparencën e këtij aktiviteti dhe mirëfunksionimin e ekonomisë së tregut.

Etika është mjaft e rëndësishme dhe në kontabilitetin e taksave, sidomos në kushtet e Shqipërisë ku sistemi ynë i taksave ka në thelb vetëdeklarimin. Në çdo legjislacion fiskal mund të thuhet se ka hapësira për t'u shfrytëzuar nga tatimpaguesit për të paguar më pak tatime e taksa, por në Shqipëri gjatë këtyre viteve është krijuar kultura e biznesit për t'u shmangur sa më shumë këtyre pagesave. Nga informacionet që ka Banka Botërore auditimet flasin për një evazion deri në 66% të të ardhurave të buxhetit. Prandaj, për të

funksionuar me efektivitet sistemi i vetëdeklarimit është e nevojshme që të gjithë tatimpaguesit të respektojnë Kodin e Etikës duke deklaruar me ndershmëri të ardhurat e tyre për të përcaktuar me korrektësi detyrimet tatimore.

Sidoqoftë, profesionistët kontabël nuk duhet të shfrytëzojnë avantazhet e ligjit tatimor për të vepruar në mënyrë jo etike duke u përfshirë në skema mashtrimi me taksat. Raste të tilla mashtrimi janë përdorimi i faturave fiktive nga bizneset për të paguar më pak TVSH dhe të rekomanduara nga disa kontabilistë, në mënyrë që këta të fundit të përfitojnë honoraret e tyre të paligjshme prej 10 % të shumës së TVSH-së së reduktuar.

Edhe pse tatimpaguesit shpesh për zgjedhin t'u shërbejnë kontabilistëve që u premtojnë se do të paguajnë më pak tatime e taksa, kjo konsiderohet si një rrugë zgjidhje afatshkurtër. Praktikant kanë dëshmuar se jo pak kontabilistë i kanë ndërprerë marrëdhëniet me biznesin brenda një kohe të shkurtër pasi shkeljet janë zbuluar nga kontrollet tatimore dhe biznesi është penalizuar me gjoka të mëdha. Prandaj është e nevojshme të zgjidhen kontabilistë që jo vetëm janë etikë, por që angazhohen të sigurojnë që klientët e tyre operojnë në mënyrë etike gjatë gjithë kohës.

7.3. Rekomandime

Pa dyshim që në fund të çdo punimi shkencor në lidhje me një problematikë të caktuar, duke u mbështetur te rezultatet e arritura jepen disa rekomandime, të cilat besohet se mund të çojnë në një përmirësim sado të vogël të situatës apo problemit, i cili studiohet. Është e rëndësishme të theksohet se ky studim përbën hapin e parë në literaturën e etikës në kontabilitet dhe si i tillë ai u projektua duke u mbështetur në studimet e mëparshme të kësaj fushe të bëra në vende të tjera. Për këtë arsye është normale që të ketë edhe

kufizimet e veta. Në këtë këndvështrim dalin natyrshëm disa rekomandime për kërkuesit shkencorë, të cilët do të eksplorojnë më tej në të ardhmen këtë disiplinë.

- Së pari, rekomandohet që studiuesit t'i kushtojnë më tepër rëndësi etikës së kontabilitetit për vetë faktin se ajo paraqet një çështje shumë të rëndësishme për një vend në zhvillim, siç është Shqipëria.

- Së dyti, rekomandohet që studimet e ardhshme të projektohen duke patur parasysh të gjitha kufizimet e këtij studimi me qëllim që rezultatet e arritura prej tyre në të ardhmen të jenë më gjithëpërfshirëse dhe konsistente.

Ky studim kishte si objektiv eksplorimin e etikës së kontabilistëve të vendit tonë dhe përcaktimin e ndikimit të disa faktorëve mbi vendimmarrjen etike të tyre sa herë që përballeshin me një situatë etike. Duke qenë se në këtë punim janë arritur konkluzione në lidhje me çështjet etike më të rëndësishme me të cilat hasen më shpesh kontabilistët tanë dhe me ndikimin e disa faktorëve në procesin e vendimmarrjes së kontabilistëve për secilin aspekt do të jepen disa rekomandime.

Fillimisht do të jepen rekomandimet në lidhje me mundësitë për të përmirësuar procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve duke ndërhyrë te faktorët që rezultojnë se kanë ndikim të rëndësishëm në këtë proces dhe njëkohësisht duke i kushtuar rëndësi disa faktorëve të tjerë, të cilët edhe pse sipas literaturës rezultojnë si faktorë me ndikim të konsiderueshëm në këtë proces kanë rezultuar jo domethënës për kontabilistët shqiptarë.

- Së pari, rekomandohet që, meqenëse grupi i faktorëve organizativë rezulton si grupi me ndikim më të madh në procesin e vendimmarrjes etike, të gjitha kompanitë të cilat duan

të kenë një performancë sa më të mirë dhe të jenë sa më të suksesshme në biznesin e tyre të marrin masa për të ndërhyrë te secili prej tyre në mënyrë që të mundësojnë sjelljen në mënyrë etike të kontabilistëve të tyre. Në këtë këndvështrim kompanive u rekomandohet që t'i kushtojnë një rëndësi të veçantë Kodit të Etikës dhe zbatimit të tij. Për kompanitë, të cilat nuk kanë Kod Etike sugjerohet hartimi i tij dhe njëkohësisht ndërgjegjësimi i punonjësve të kompanisë, ku bëjnë pjesë edhe kontabilistët, për rëndësinë e zbatimit të tij. Kodi i Etikës duhet të përditësohet vazhdimisht në lidhje me çështjet që ai trajton dhe në të njëjtën kohë disa studiues rekomandojnë se çdo shkelje e tij nga punonjësit e kompanisë duhet të sanksionohet me masa ndëshkimore. Gjithashtu edhe organet kompetente qeveritare duhet ta bëjnë të detyrueshme hartimin dhe zbatimin e Kodit të Etikës për të gjitha kompanitë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë. Një faktor tjetër shumë i rëndësishëm organizativ që rezulton me një ndikim të konsiderueshëm në procesin e vendimmarrjes etike është edhe klima etike e kompanisë. Në lidhje me këtë faktor meqenëse nga tri llojet e marra në shqyrtim rezulton se Ligjet dhe Kodi Profesional është lloji i klimës etike, i cili ka një ndikim më të madh në vendimmarrjen etike atëherë u rekomandohet kompanive që të implementojnë këtë lloj në kompanitë e tyre. Në thelb të këtij lloji qëndron ndërgjegjësimi i punonjësve të kompanisë në lidhje me rëndësinë dhe zbatimin me rigorozitet të ligjeve dhe kodeve profesionale. Duke implementuar një lloj të tillë klime etike, punonjësit e kompanisë do të arrijnë të kenë perceptime më të qarta përse u përket etikës në përgjithësi dhe rëndësisë së të sjellurit në mënyrë etike të secilit prej tyre.

- Së dyti, meqenëse është arritur në përfundimin se mosha dhe eksperiencia, të cilat bëjnë pjesë në grupin e faktorëve individualë kanë ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike të kontabilistëve tanë, u rekomandohet kompanive, të cilat ushtrojnë aktivitetin në vendin tonë dhe që njëkohësisht kanë si objektiv ushtrimin e një aktiviteti të ndershëm dhe të sukseshëm që të kenë parasysh këta dy faktorë gjatë procesit të punësimit të kontabilistëve të tyre. Grupmosha 30-35 vjeç rezulton që të ketë një ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv me procesin e vendimmarrjes etike. Gjithashtu sa më e madhe eksperiencia, aq më të aftë janë kontabilistët për të njohur dhe për të marrë një vendim etik në lidhje me një çështje etike me të cilën ai përballet.
- Së treti, meqenëse nga grupi i faktorëve individualë niveli i edukimit të kontabilistit nuk rezulton të ketë një ndikim të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes etike, atëherë u rekomandohet organeve kompetente për arsimimin e brezave të ardhshëm të kontabilistëve që t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë edukimit të tyre në lidhje me etikën në kontabilitet. Në momentin që përfundojnë studimet kontabilistët e rinj duhet të jenë të ndërgjegjshëm në lidhje me rëndësinë e ushtrimit të profesionit të tyre në përputhje me të gjitha standardet etike. Rekomandohet që studentët e kontabilitetit të marrin njohuri të posaçme në lidhje me etikën në kontabilitet.
- Së katërti, edhe pse rekomandimi i fundit në renditje, por i pari për nga vlefshmëria, u rekomandohet organeve qeveritare dhe njëkohësisht edhe kompanive ndërmarrja e një nisme të vështirë, por shumë e vlefshme për të implementuar në kompanitë tona funksionin e oficerit të etikës. Oficeri i Etikës ka lindur si profesion gjatë viteve të fundit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vihet re një tendencë gjithnjë e në rritje e kompanive për

të implementuar këtë funksion duke qenë se përfitimet janë shumë të mëdha. Roli i oficerit të etikës po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm në botën e sotme të biznesit dhe mund të thuhet se dalëngadalë ai po shndërrohet në një profesion më vete, i cili ka të drejtat e veta dhe njëkohësisht mbulon një gamë të gjerë përgjegjësish kundrejt kompanisë në të cilën operon. Kuptohet që duke qenë se funksioni i oficerit të etikës i ka fillesat e tij diku nga vitet '90 dhe origjina e tij janë SHBA. Normalisht ai përfaqëson një “zanat” relativisht të ri që kohët e fundit është promovuar edhe në vendet e zhvilluara të Europës. Mund të themi që edhe pse shumë i rëndësishëm për kompanitë ky funksion pothuajse nuk njihet në vendet në zhvillim ku bën pjesë edhe Shqipëria. Oficeri i etikës është një individ, i cili ka akses në drejtimin e lartë të një kompanie, dikush që ndihmon në inkurajimin e implementimit të standardeve dhe vlerave etike pozitive dhe asiston drejtuesit dhe punonjësit e një kompanie në ndjekjen e standardeve të tilla. Inkurajimi i implementimit të vlerave etike pozitive dhe praktikave të biznesit është padyshim një detyrë shumë e vështirë që shpeshherë nënvlerësohet nga pozicionet drejtuese. Një oficer etike mundëson që kompania t'i kushtojë një vëmendje të veçantë kulturës së organizatës duke e vënë theksin veçanërisht te praktikat etike të biznesit. Oficeri i etikës, jo vetëm që ndihmon kompaninë në vendosjen e standardeve etike, por njëkohësisht edhe në komunikimin e tyre dhe integrimin në kulturën e kompanisë dhe ndërgjegjësimin e individëve në lidhje me respektimin dhe rëndësinë që këto standarde kanë për kompaninë. Në terma më formalë mund të themi se oficeri i etikës ka për detyrë integrimin e vlerave etike të organizatës dhe praktikave të sjelljes së biznesit në procesin e vendimmarrjes në të gjitha nivelet e organizatës. Ka disa detyra të cilat janë të përbashkëta për çdo oficer etike pavarësisht

llojit të kompanisë për të cilën ai punon. Më poshtë paraqiten detyrat themelore të një oficeri etike.

1. Një oficer etike është përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e etikës së një kompanie duke u kujdesur për konformitetin dhe sjelljen etike të kompanisë në tërësi.
2. Oficeri i etikës duhet të sigurojë udhëheqje dhe këshillim cilësor për të mundësuar zhvillimin, shpjëgimin dhe ekzekutimin e etikës dhe njëkohësisht duhet të sigurojë edhe mbikqyrje të praktikave dhe programëve të kompanisë.
3. Një oficer etike duhet të bëjë investigime të bazuara mbi të gjitha akuzat dhe kundravajtjet, për të cilat ai informohet nga organizma të tjera brenda kompanisë. Ai ka për detyrë t'i udhëheqë punonjësit e tij në ndjekjen me përpikmëri të Kodit të etikës, i cili përbën një standard të artë për suksesin e tyre në çfarëdolloj pozicioni qofshin dhe njëkohësisht oficeri i etikës duhet të marrë masa ndëshkimore për të gjithë individët në rastet kur konstaton shkelje të Kodit.
4. Oficeri i etikës duhet ta imponojë ndjekjen e Kodit të etikës dhe ta përshtasë atë në varësi të standardeve të organizatës. Duke qenë se këta individë kanë për detyrë të vlerësojnë misionin, vizionin, qëllimet dhe vlerat e një kompanie, atëherë domosdoshmërisht duhet edhe që herë pas here të masin performancën e punës së tyre, pra të vlerësojnë nëse kompania po operon apo jo në përputhje me deklaratimet e mësipërme.
5. Së fundi është detyrë e të gjithë individëve që ushtrojnë profesionin e oficerit të etikës që të ushtrojnë profesionin e tyre në përputhje me standardet e sjelljes të vendosura për këtë profesion nga shoqatat profesionale, të cilat shërbejnë si mekanizma që rregullojnë profesionin e oficerit të etikës.

Një oficer etike i shton vlerë kompanisë për të cilën punon. Një sërë studimesh kanë arritur në përfundimin se kompanitë, të cilat kanë implementuar një funksion të tillë dhe që e vlerësojnë siç duhet sjelljen në mënyrë etike të bizneseve të tyre dhe që performojnë në një mënyrë të përgjegjshme arrijnë në rezultate më pozitive. Kjo është e vërtetë nëse kemi parasysh faktin se oficeri i etikës e mban kompaninë larg trazirave dhe çon përpara objektivat e biznesit. Në tregjet e kapitalit besimi i publikut është jetësor për të arritur suksesin e të bërit biznes dhe në të njëjtën kohë kompanitë mbështeten te reputacioni dhe marka që zotërojnë për të tërhequr jo vetëm konsumatorë besnikë, por edhe partnerë, investitorë dhe punonjës të tillë. Një aspekt i rëndësishëm që nuk duhet neglizhuar nga çdo kompani është fakti se me ndihmën e oficerit të etikës, i cili imponon vendosjen dhe respektimin e një klime etike në kompani, vetë kompania siguron një forcë punëtore më të besueshme. Sa më e besueshme të jetë forca punëtore e një kompanie, aq më të mëdha janë mundësitë që kompania të rrisë reputacionin e saj në treg, të ketë një produktivitet më të lartë dhe të arrijë një performancë të admirueshme nga konkurentët e saj. Pra, sa më shumë të investojë një kompani në implementimin dhe zhvillimin e funksionit të oficerit të etikës, aq më e lehtë dhe e sigurt është për të pasur një klimë etike në nivele maksimale, e cila mund të perceptohet lehtësisht nga punonjësit e saj dhe t'i orientojë ata gjithnjë e më tepër drejt sjelljes etike.

Së fundi, mund të themi se oficeri i etikës i shton vlerë kompanisë për vetë faktin se këto organizata do të kenë një lider të fuqishëm, i cili ka për detyrë të bëjë të mundur që standardet organizative të jenë një prioritet në kompani. Një kompani, e cila dëshiron që punonjësit e saj të veprojnë sipas standardeve më të larta etike, ajo duhet pa dyshim

të demonstrojë angazhimin e saj për të krijuar një aftësi të lartë etike dhe mbikqyrje të saj në nivele të larta.

Pra, çdo kompani e cila investon në implementimin e funksionit të oficerit të etikës dhe pozicionimin e tij në nivelet e larta drejtuese padyshim që do të marrë benefite shumë të vlefshme për suksesin e saj në treg dhe konkretisht këta profesionistë i sigurojnë kompanisë:

- vendosjen e një kulture etike
- parandalimin dhe manaxhimin e sjelljeve joetike
- mbështetje në angazhimin e organizatës drejt respektimit të integritetit
- mbrojtje dhe suport në rastet e vështirësive ligjore dhe rregullatore

Padyshim që këto benefite mund të merren nga kompania vetëm nëse ajo ia ngarkon këtë funksion një individi me njohuritë dhe përgatitjen e nevojshme, e pozicionon këtë funksion siç duhet dhe i jep fuqinë e duhur për të vepruar e njëkohësisht duke i siguruar burimet e nevojshme.

Implementimi i oficerit të etikës do të ishte tejet i nevojshëm dhe frytdhënës për kompanitë tona. Kjo për vetë faktin se ky person do t'i sillte kompanive tona të gjitha përfitimet e sipërpërmendura, të cilat do t'i orientonin padyshim kompanitë shqiptare drejt suksesit dhe praktikave etike të të bërit biznes.

Natyrshëm mund të lindë pyetja se, a është i mundur për kompanitë tona implementimi i këtyre profesionistëve dhe nëse po, sa i vështirë do të ishte ky proces? Përgjigjja e kësaj pyetjeje pa dyshim që është e vështirë të jepet, sepse është relative dhe në varësi të dëshirës për të ecur përpara të sipërmarrësve në vendin tonë, por në këtë rast nëpërmjet praktikave dhe sjelljeve të ndershme.

Por, nëse marrim të mirëqenë faktin se ekziston dëshira për t'u orientuar drejt sjelljes etike duke filluar nga individët e për të kaluar më pas te kompanitë, është normale të pohojmë se implementimi i oficerit është e mundur pa mohuar faktin se është një proces shumë i vështirë për kompanitë shqiptare.

Është një sfidë më vete dhe për ta përballuar duhet, jo vetëm angazhimi i kompanive, por njëkohësisht edhe i autoriteteve qeveritare dhe shoqatave profesionale. Autoritet qeveritare duhet të ndërhyjnë duke krijuar bazën ligjore që t'i imponojë kompanitë në nisjen e një procesi të tillë, por edhe t'i suportoje ato financiarisht në të njëjtën kohë. Shoqatat profesionale duhet të angazhohen në përgatitjen dhe trajnimin e kapitalit human për të ushtruar këtë profesion, pasi është e domosdoshme që në dispozicion të kompanive që e ndërmarrin këtë nismë të ketë individë të aftë për të përmbushur të gjitha funksionet që i takojnë këtij profesioni.

Në lidhje me investimin që duhet të bëjnë kompanitë për nisjen dhe përfundimin e një procesi të tillë nuk duhet mohuar që është një investim i kushtueshëm dhe për realizimin e të cilit duhet një kohë e caktuar, por nuk duhet lënë pa përmendur fakti që përfitimet e kompanisë në momentin që një nismë e tillë konsolidohet janë shumë herë më të mëdha sesa vlera e investimit. Implementimi i kulturës etike të kompanisë, parandalimi dhe manaxhimi i sjelljeve joetike bëjnë që kompania të ketë një performancë më të mirë si rezultat i vendimeve etike që ajo do të marrë. Performancë më e lartë përkethehet njëherazi në mirëqenie më të lartë të vendit ku operon kompania dhe njëherazi kontribuon në zhvillimin ekonomik të vendit.

Nismëtarët e një procesi të tillë duhet të jenë kompanitë, të cilat janë në pronësi të sipërmarrësve shqiptarë në bashkëpunim me sipërmarrësit e huaj duke qenë se ky fakt e bën më të lehtë këtë proces, si rezultat i eksperiencave më të mëdha që kanë sipërmarrësit e huaj në lidhje me çështje të tilla.

Ashtu sikurse u përmend edhe në fillim të kësaj pjese do të jepen edhe disa rekomandime në lidhje me çështjet etike, me të cilat përballen kontabilistët e vendit tonë.

- Së pari, rekomandohet që t'i kushtohet një vëmendje e veçantë edukimit të vijueshëm të kontabilistëve tanë, qofshin këta ushtrues të lirë të profesionit apo të punësuar në kompanitë e vendit tonë. Edukimi i vijueshëm i kontabilistëve është dhe mbetet kritik, prandaj shteti duhet të inkurajojë përfshirjen e më shumë çështjeve etike në trajnimet e detyrueshme si pjesë e kërkesave të Ligjit Nr.10091. Kjo do të rrisë vizibilitetin dhe do të promovojë një shpërndarje më të madhe të vetëdijes etike.

- Së dyti, rekomandohet që shoqatat profesioniste të marrin masa në lidhje me shmangien e konfliktit të interesit të ushtrimit të profesionit. Vihet re se shpeshherë për të shmangur formalisht konfliktin e interesit, audituesit e pasqyrave financiare e hartojnë bilancin dhe ia japin thjesht për firmë dikujt tjetër, një kontabilisti të miratuar. Pra, duhen marrë masa, audituesit nuk duhet të shfaqen si të pavarur, por të jenë vërtet të tillë në punën e tyre. Kriza financiare, falimentimi i njësive ekonomike dhe dështimi i kontabilistëve kanë treguar se shkelja e parimit të pavarësisë mund të ketë pasoja të mëdha jo vetëm në tregjet e kapitalit, por mund të shoqërohet dhe me krizë të besimit në profesionin e kontabilistit.

- Së treti, në zbatim të standardeve etike, profesionistet kontabël duhet të ndërgjegjësohen që t'u rekomandojnë njësive të biznesit rrugën e duhur për të mos u përfshirë në skema mashtrimi dhe abuzimi që do të ishin në dëm të të dyja palëve. Nëse gjatë angazhimit të tij ngrihen pyetje etike, një memo duhet t'i paraqitet klientit bashkangjitur me hollësi se si janë zgjidhur çështjet apo t'i parashtrohen të gjitha argumentet bindëse dhe pasojat e veprimeve joetike nëse ato do të ndërmerreshin. Nëse klienti nuk bindet atëherë sjellja më etike e kontabilistit do të jetë të tërhiqet nga misioni i tij.
- Së katërti, rregullatorëve duhet t'u jepet më shumë pushtet për të zhvilluar praktika etike në kontabilitet. Është e nevojshme të veprohet mbi baza të rregullta kundër shkelësve të standardeve të kontabilitetit për të siguruar transparencën në dërgimin dhe marrjen e informacionit financiar. Rregullatorët duhet të vënë në jetë shembuj të mbylljes së disa shoqërive të kontabilitetit për shkak të praktikave të tyre joetike, pasi është vështirë të gjendet ndonjë kontabilist i pandershëm që të ndëshkohet.

Adoptimi i rekomandimeve të mësipërme, do të përfaqësonte një hap drejt kthimit të besimit në një profesion që nuk mund të funksionojë pa besimin e publikut.

7.4. Kufizimet

Çdo punim shkencor, i kujtdo fushe qoftë, pa dyshim ka avantazhet dhe disavantazhet e tij. Duke qenë se në vendin tonë deri tani nuk është bërë asnjë punim shkencor në lidhje me etikën e kontabilistëve shqiptarë, është e natyrshme që ky punim të ketë disa kufizime të cilat renditen në vijim:

1. Në këtë punim marrëdhënia midis fazave të procesit të vendimmarrjes etike nuk është marrë në konsideratë. Sipas O'Fallon dhe Butterfield (2005) ekzistojnë marrëdhënie të rëndësishme midis fazave të procesit, të cilat mund të shpjegojnë disa ndryshime në procesin e vendimmarrjes etike. Kjo çështje sugjerohet të merret në konsideratë nga studiues të ndryshëm në studimet e tyre të mëvonshme.
2. Kontabilistët që morën pjesë në studim dhanë mendimin e tyre në lidhje me shtatëmbëdhjetë çështje etike, të cilat u menduan se do të ishin domethënëse edhe për kontabilistët e vendit tonë duke qenë se bëjnë pjesë në grupin e vendeve në zhvillim. Studimet e mëparshme i kanë listuar këto çështje si çështjet më të rëndësishme, të cilat hasen pothuajse në të gjitha vendet në zhvillim. Për të marrë mendimin e pjesëmarrësve në këtë studim u përdor pyetësi, por për studimet e ardhshme sugjerohet përdorimi i metodave të ndryshme, si për shembull intervista gjysmë të strukturuar, të cilat japin mundësinë e një investigimi më të thellë.
3. Në këtë studim u morën në konsideratë vetëm tre fazat e para të procesit të vendimmarrjes etike duke përjashtuar fazën e katërt, e cila përkon me sjelljen etike. Arsye e përjashtimit të kësaj faze lidhen me vështirësitë e hasura në matjen e saj dhe mosekzistencës së një matësi të përshtatshëm për këtë fazë, e cila vlerësohet si shumë relative. Nuk duhet mohuar fakti që faza e sjelljes etike është faza më e rëndësishme e procesit të vendimmarrjes etike dhe ka të bëjë me produktin përfundimtar të një procesi kompleks dhe të shumëfishtë.

4. Studimi dhe rezultatet e tij bazohen në të dhënat e mbledhura nëpërmjet një pyetësoi në të cilin u integruan katër skenarë në lidhje me katër çështje të ndryshme etike. Këta pyetësorë u shpërndanë nëpërmjet postës elektronike dhe kjo përbën një prej kufizimeve të këtij punimi. Kjo mënyrë shpërndarjeje, edhe pse e shpejtë dhe me kosto minimale rezulton përgjithësisht më pak efektive se sa shpërndarja e pyetësorit personalisht. Duke qenë se kampioni i marrë në shqyrtim kishte një shtrirje gjeografike në të gjithë Republikën e Shqipërisë, u pa e pamundur shpërndarja personalisht e pyetësorëve.

Ka disa disavantazhe, të cilat rrjedhin nga zgjedhja e një mënyre të tillë shpërndarjeje.

- Së pari, kjo formë shpërndarjeje nuk imponon pjesëmarrësit për të plotësuar pyetësoin dhe për këtë arsye në këto raste pritet një shkallë më e ulët e kthimit të përgjigjeve.
- Së dyti, duke përdorur këtë formë shpërndarjeje, edhe pse në fokus të studimit ishte marrja e mendimeve të të gjithë kontabilistëve që punonin në një kompani të caktuar, u vu re se për çdo kompani u mor vetëm një pyetësor i plotësuar. Ky fakt dëshmon se pyetësoi është plotësuar vetëm nga shefat e departamenteve përkatëse dhe nuk u është transmetuar kontabilistëve të tjerë të kompanisë. Arsyeja e këtij fakti lidhet me natyrën e ndjeshme dhe delikate të informacionit që na nevojitet. Të gjitha kufizimet e sipërpërmendura janë të vlefshme si rekomandime për studimet e ardhshme në fushën e etikës së kontabilistëve në Shqipëri.

BIBLIOGRAFIA

1. Adams, J. S., Tashchian, A., & Shore, T. H. (2001). Codes of ethics as signals for ethical behavior. *Journal of Business Ethics*, 29(3), 199-211.
2. Adams, J. Khan, H. T., Raeside, R., & White, D. (2007) Research methods for graduate business and social science students. New Delhi: SAGE Publications India Pvt Ltd. doi: <http://dx.org/10.4135/97881321084>
